

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРСИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKI I DYTË

TEZA :

***“LIRIMI ME KUSHT NË KODIN PENAL TË R.MAQEDONISË
ME VËSHTRIM TË VEÇANT NË TERRITORIN E GJYKATËS
THEMELORE TË GOSTIVARIT PËR PERIU DHËN KOHORE
2009-2013”***

KANDIDAT:

Vlersim Xhaferi

MENTOR:

Prof. D-r. Besa Arifi

Tetovë 2018

Përmbajtja

Hyrje	3
Kapitulli I	6
1.Nocioni i dënimit me burg (heqje lirie) dhe shqiptimi i këtij dënimi.	6
2.Qëllimi i dënimit me burg (heqje lirie)	11
3.Shqiptimi i dënimit me burg-heqje lirie (sistemi penitensiar)	12
4.Lirimi i personave të dënuar nga mbajtja e dënimit.....	13
5.Përgaditja për lirim nga enti penitensiar	14
6.Lirimi pas mbajtjes së dënimit	16
7.Lirimi nga falja e dënimit.....	17
7.1.Amnistia	17
7.2.Falja.....	19
8.Lirimi sipas lirit me kusht	21
9.Lirimi sipas vendimit të drejtorit të entit penitensiar	22
Kapitulli II	23
1.Historiku i lirit me kusht, zhvillimi dhe përkufizimi i tij.....	23
1.1.Historiku dhe prejardhja etimologjike e lirit me kusht	23
2.Natyra juridike dhe nocioni i lirit me kusht	33
2.1. Natyra juridike e lirit me kusht	33
2.2. Nocioni i lirit me kusht	36
3.Kushtet për aplikimin e lirit me kusht.....	38
4.Arsyeshmëria e lirit me kusht	41
5.Raporti i lirit me kusht me institutet e ngjajshme me të	44
6.Procedura e paraqitjes së kërkesës dhe vendimi për dhënien e lirit me kusht.....	48
7.Revokimi i lirit me kusht.....	55

Kapitulli III	58
1.Analiz komparative e liritimit me kusht në Kodin Penal të Maqedonisë dhe në disa Kode Penale të Rajonit.....	58
1.1.Lirimi me kusht dhe revokimi i liritimit me kusht sipas Kodit Penal të Shqipërisë.....	61
1.2.Lirimi me kusht dhe revokimi i liritimit me kusht sipas Kodit Penal të Kosovës.	64
Kapitulli IV	67
1.Aplikimi i liritimit me kusht në R.Maqedonisë dhe në Gjykatën Themelore të Gostivarit gjatë periudhës kohore 2009-2013.	67
2.Aplikimi i liritimit me kusht në territorin e Gjykatës Themelore të Gostivarit gjatë periudhës kohore 2009-2013.....	74
Kapitulli i V	95
1.Mbikëqyrja e personave të dënuar të liruar me kusht dhe pranimi i tyre në shoqëri pas liritimit nga dënimi me burgim.....	95
1.1.Mbikëqyrja e personave të dënuar të liruar me kusht	95
2.Obligimet gjatë mbikqyrjes së personave të liruar me kusht dhe pranimi tyre në shoqëri pas liritimit nga dënimi me burg.....	98
3.Roli i liritimit me kusht në procesin e risocializimit të personave të dënuar	102
Përfundimi dhe Rekomandime	105
Literatura e shfrytëzuar	108

Lirimi me kusht në Kodin Penal të R.Maqedonisë me vështrim të veçant në territorin e Gjykatës Themelore të Gostivarit për periudhën kohore 2009-2013.

Hyrje

Politikat udhëheqëse në zhvillimin e sistemit penitenciar në Republikën e Maqedonisë si një sferë e rëndësishme e sistemit ndëshkimoro-korrektues si intenc kryesore e kanë ndërtimin dhe funksionimin e mirëfillt të sistemit të shqiptimit të sanksioneve penale, i cili sistem mundëson dhe siguron risocializim dhe riedukim të suksesëshëm të personit të dënuar dhe kthimin e tij si anëtar i dobishëm i shoqërisë.

Definimin dhe mënyrën e shqiptimit të sanksioneve penale e parasheh Ligji për ekzekutimin e sanksioneve në R.Maqedonisë si akt kyç, ku dispozitat e këtij ligji janë ndërtuar dhe harmonizuar me standartet ndërkombëtare të shqiptimit të dënimit me burg, me Regullat Evropiane të Burgjeve, dhe ky ligj paraqet një dokument bashkëkohor i cili mbron edhe sferën e të drejtave dhe dinjitetin e të burgosurve. Ndryshimet dhe plotësimet në sistemin e sanksioneve penale orientohen drejt një dënimi human, individual dhe efikas.

Sistemi i drejtësis penale në R.Maqedonisë dënimin me burgim e parasheh dhe e zbaton si dënim kryesor për parandalimin e kriminalitetit, dhe rallë herë aplikimin e alternativave të dënimit me burg. Në literaturën juridiko-penale dhe penologjike të të gjitha shteteve bashkëkohore lirimi me kusht është një institut i njohur, që në mënyr të përshtatëshme dhe të ndërgjegjshme pretendon menjanimin e pasojave negative që i paraqet dënimi me heqje lirie.

Lirimi me kusht është institut relativisht i ri i së drejtës penale. Për herë të parë është paraqitur në Angli në gjysmën e shekullit XIX, e më pas edhe në Francë. Në fillim të shekullit XX ky institut është përvetësuar në legjislacionet dhe në praktikën e të gjitha vendeve të Evropës dhe në shumë vende të botës.

Natyra e lirit me kusht edhe në legjislacionin penal të Maqedonisë na paraqitet si masë humane me të cilën i dënuari lirohet para se ta vuaj dënimin e plotë të caktuar me vendim të formës së prer nga gjykata, dhe lirohet nëse i ka plotësuar kriteret konkrete dhe rrethanat individuale të personit të dënuar të përcaktuara në dispozitat pozitive ligjore në fuqi duke u aplikuar në përputhje me parimet e drejtësisë dhe paanshmërisë.

Lirimi me kusht në punimin konkret është temë kryesore dhe do të shtjellohet në mënyrë gjithëpërfshirëse me një strukturë të përbërë prej pesë kapituj, se si ky institut trajtohet në praktikën penitensiare.

Në kapitullin e parë të këtij punimi do të trajtohet dërimi me heqje lirie si dënim për të cilin është i lidhur lirimi me kusht, duke filluar nga nocioni, qëllimi dhe shqiptimi i dënimit me heqje lirie, pastaj lirimi i personave të dënuar nga mbajtja e dënimit, përgaditja e tij për lirim, më pas lirimi pas mbajtjes së dënimit, lirimi në bazë të amnistisë dhe faljes, lirimi në bazë të lirit me kusht dhe lirimi në bazë të vendimit të drejtorit të entit penitensiar.

Në kapitullin e dytë do të bëhet shtjellimi i historikut të lirit me kusht, në pikën e historikut të lirit me kusht do të ceket etapa historike e paraqitjes etimologjike të tij. Gjithashtu do të përmenden edhe natyra juridike e lirit me kusht, nocioni i lirit me kusht, kushtet ligjore për aplikimin e lirit me kusht, arsyeshmëria e tij, raporti i tij me institutet e ngjashme me të, procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe për vendosjen e tij, si dhe revokimi i tij.

Në kapitullin e tretë do të flitet për një analizë komparative të lirimit me kusht në Kodin Penal të R.Maqedonisë dhe në disa kode penale të rajonit, ku do të trajtohet dhe do të krahasohet lirimi me kusht sipas dispozitave të Kodit Penal të R.Shqipërisë dhe Kodit Penal të R.Kosovës.

Kapitulli i katërt përfshin lirimin me kusht në R.Maqedonisë dhe në territorin e Gjykatës Themelore të Gostivarit, gjegjësisht analizën dhe pasqyrimin e të dhënave zyrtare të mara nga Drejtoria mbi ekzekutimin e sanksioneve në R.Maqedonisë dhe gjykata në lidhje me miratimin dhe refuzimin e kërkesave për lirim me kusht gjatë periudhës kohore 2009-2013.

Kapitulli i pestë si përmbyllje e këtij punimi do të paraqes mbikqyrjen e personave të liruar me kusht, obligimet që dalin nga mbikëqyrja si dhe rolin e lirimit me kusht në procesin e risocializimit të personave të liruar me kusht.

Kapitulli I

1. Nocioni i dënimit me burg (heqje lirie) dhe shqiptimi i këtij dënimi.

Të gjitha shoqërit e organizuara në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre sjelljet kriminale i trajtojnë si të dëmshme për shoqërinë. Dhe në këtë kuptim ata reagojnë ndaj sjelljeve kriminale në mënyrë të përshtatshme për të penguar ose zvogëluar kriminalitetin.

Ata këtë reagim e kanë shprehur edhe nëpërmjet pranimit të dënimeve të ekzekutuara nga organet e specializuara shtetërore ku kryerësit të veprës penale të keqen që e ka shkaktuar ti kthehet me të keq, me kufizim të lirive, me vuajtje fizike dhe psiqike, dënimet trupore e fizike, dënimet me të holla, deportime dhe deri me pranimin e dënimit me vdekje dhe dënimeve tjera.

Dënimet e lartpërmendura janë shqiptuar në kohën e vjetër kur kanë dominuar botëkuptimet dhe pikpamjet që si qëllim kryesor të ndëshkimit ka qenë shpagimi dhe hakmarja, duke ju shkaktuar mundime dhe vuajtje personave të dënuar. Nga kritikrat e ashpra që janë paraqitur ndaj këtyre botëkuptimeve këto dënime janë cilësuar si mjetet më barbare që nuk kanë qenë efikase dhe nuk kanë ndikuar në pengimin dhe luftimin e kriminalitetit. Qysh në atë kohë ka pasur mendime dhe ideja për paraqitjen e masave të tjera, të cilat në atë kohë janë përdorur si masa preventive siç ka qenë paraburgu, burgu për endacakët, etj.

Nga pohimet historike kuptojmë se e drejta për liri dhe mbrojtja e lirisë personale janë të drejta themelore dhe të rëndësishme të njeriut, dhe shkelja e tyre nga arbitrariteti i aparatit shtetëror ka sjellë pasoja në shoqëri. Dhurata më e madhe që i është dhënë shoqërisë në mbar botën është Karta e Madhe Angleze

(Magna Carta 1215), prej së cilës buron demokracia dhe garantohen lirit dhe të drejtat e njeriut dhe po në këtë kartë hidhen themelet e shtetit të së drejtës. Njëri nga nenet e kartës që është përdorur në pafundësi rastesh lidhur me lirin thot: **“Asnjë njeri i lirë nuk mund të arrestohet apo burgoset, nuk mund t’i merren të drejtat apo posedimet, nuk mund të nxirret i jashtëligjshëm apo të internohet. Ne nuk do të përdorim forcën kundër tij, me përjashtim të rasteve kur ka një gjykim të ligjshëm nga të barabartët e tij ose nga ligji i tokës. Askujt ne nuk do t’ia shesim apo mohojmë, apo vonojmë të drejtën”**.¹ Karta ka shërbyer si frymëzim për shumë dokumente të tjera të rëndësishme që do të pasonin më vonë nga Deklarata e Pavarësis së SHBA-ve, ku edhe në këtë deklarat janë pohuar të drejtat natyrore dhe juridike dhe njihet liria dhe të drejtat e njeriut ku ceket: **“Ne i konsiderojmë këto të vërteta si të vetëkuptueshme, se të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë, se ata janë pajisur nga Krijuesi i tyre me të drejta të patjetërsueshme, se midis këtyre të drejtave janë Jeta, Liria dhe kërkimi i Lumturisë”**. Si akt tjetër i rëndësishëm në këtë fush mund të veçohet edhe **Ligji për të drejtat (Bill of Rights)** i vitit 1689 i cili përmban rregulla që e kufizojn pushtetin absolut dhe garantojnë një mbrojtje më të madhe të të drejtave të njeriut: **Ai shpall të paligjshëm pushtetin që synon ta pezullojë ligjin, ose të sundojë pa ligj, u jep të drejtë qytetarve që ti parashtrorin petition mbretit, i shpall të paligjshme urdhërat për burgim ose ndjekje të atyre personave që kanë parashtruar peticione, ndalon dënimet jonjerëzore ose të pazakonta**. Poashtu garantimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut i shtjellon edhe Deklarata Univerzale për të drejtat e Njeriut 1948 ; Pakti Ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike 1966; Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore 1950; edhe shumë dokumente dhe kushtetuta të shteteve të botës.

¹ <http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/09/30/magna-carta-themeli-i-lirise-ndoshta-i-mbivleresuar/>

Por liria si një e drejt e paprekshme dhe e vlefshme e njeriut mund të merret ose të kufizohet si një lloj sanksioni penal, si pasoj e shkeljes së ligjeve penale të vendit.

Egziston një numër i madh i definicioneve për të drejtën për liri, por kjo e drejt në thelbin e saj d.m.th. liri në lëvizje, liri në veprim, liri në sjellje, megjithatë kjo e drejt nuk ka natyrë absolute sepse është vërtetuar mundësia legjitime e kufizimit të saj në rast të egzistimit të bazave të lejuara.²

Heqja e lirisë në kuptimin e saj shumë dimensional kriminalo-politik lirisht mund të thuhet se e ka okupuar opinionin e gjërë pa përjashtim dhe ka gjetur një tretman dhe një rëndësi të posaçme në teorinë dhe praktikën e të drejtës penale dhe penologjisë. Interesi shkencorë i penologjisë heqjen e lirisë e konsideron si element kryesor ashtu që, ky dënim si i vetëm me pak a shumë elemente represive gjatë gjithë historisë së shoqëris njerëzore, është aplikuar si dënim me attribute të çrrënjësjes së kriminalitetit kështu që, edhe sot e kësaj dite shqiptimi i këtij dënimi përforëcon bindjen e shoqërisë se ka ngelur masa e vetme më efikase dhe e fuqishme në luftën kundër kriminalitetit. Poashtu interesi shkencor i penologjisë rritet kur paraqiten qëllimet kundërthënëse të heqjes së lirisë që nga periudha kur politika kriminale bazohej në hakmarje dhe frikësim, ndërsa sot bazohet në iden e risocializimit. Ky dënim zhvillohet në hap me zhvillimin e shoqëris në përgjithësi dhe i përshtatet kushteve të kohës dhe vendit ku theksohen elementet humane dhe përmirësuese të këtij dënimi në raport me dënimet tjera. Me evolucionin e ideve për dënim dhe ndëshkim edhe sistemi penal i Maqedonisë pëson ndryshime duke i reduktuar sanksionet penale dhe fokusohet në shqiptimin e dënimit me burg dhe dënimit me të holla si dënime kryesore.³

² Todorovski L., Sutska ocena na zakonitosta na lisuvaniето od sloboda, Makedonska Revija br.2, Ohrid 2007, fq.149

³ Marjanoviq Gj., Kanevçev M., Makedonsko krivično parvo, opst del, Shkup 2010, fq 301

Dënimi me burg si sanksion penal, sipas konstatimeve në literaturë për herë të parë është paraparë në Kodin Penal francez 1792. Kjo konsiderohet edhe si kohë e paraqitjes dhe aplikimit të dënimeve me burg në praktikën gjyqësore si sanksione penale për luftimin e kriminalitetit. Duhet theksuar se dënimet me burgim pas Kodit Penal të vitit 1792, e veçmas pas Kodit të Napoleonit të vitit 1810, aplikohet dhe parashikohen në të gjitha kodet penale të Evropës dhe SHBA-ve.⁴

Është e njohur se në Greqinë dhe Romën e vjetër kanë egzistuar burgjet. Por këto burgje me kushte qëndrimi shumë të rënda kanë shërbyer si masë preventive për mbajtjen e kryerësve të veprave penale para se ndaj tyre të shqiptohet dënimi kryesor që zakonisht është shqiptuar dënimi me vdekje, e jo si institucione në të cilat kryerësit do ta vuajn dënimin me heqje lirie.⁵ Si burg më i njohur në Romë ka qenë Tallianum, ku të dënuarit me vdekje e kanë pritur ekzekutimin e vdekjes së tyre. Ky lloj burgu ka egzistuar pothuajse deri në sh.XVI, dhe deri kur filloi ndërtimi i burgjeve në kuptimin e sotëm të burgut.⁶

Dënimi me burg apo heqja e lirisë si masë e vjetër ndëshkuese që nga paraqitja e saj nuk mund të thuhet se ka aritur përparim të madh në qëllimin dhe detyrën e saj kundër personit të dënuar. Por dënimi me burg gjeti mbështetje në iden e izolimit të kryerësit të veprës penale në ente të posaçme ndëshkimi e veçmas nëpërmjet angazhimit të personave të dënuar në punë në institucionet e ndëshkimit mund të vlerësohet si mundësi e përshtatshme me elemente represive dhe retributive në luftimin dhe pengimin e aktivitetit të tijë kriminal. Përkundër kritikave të shumta të dënimin me burg që shqiptohet si dënim kryesor dhe nga idea hakmarëse e qëllimit të këtij dënimi ku burgu në kushtet bashkëkohore mos të ngelet vetëm dënim, por në mënyr permanente të shkon drejt përsosjes dhe

⁴ Halili R., Penologjia, Prishtinë 2010, fq 98

⁵ Ibid, fq.93.

⁶ Krstanovski M., Uslovniot otpust kako penoloski institut (stdentski zbor), Shkup 1996, fq.41.

modernizimit të tij. Idet transformuese lidhur me qëllimin e dënimit me burg gjatë historisë shtrojnë nevojën e një qasjeje të re për aritjen e qëllimit të dënimit ku në sistemin modern ndëshkues dominojnë pikëpamjet e reja humaniste se qëllimi i dënimit nuk është hakmarje por riedukim që ata të aftësohen për jetë dhe punë në liri.

Dënimi me burg ose me heqje lirie është pranuar si masë më e aplikuar në shoqërinë bashkëkohore në luftën kundër kriminalitetit, njëherit edhe si dënim më i shqiptuar edhe në praktikën gjyqësore. Ky dënim hyri në sistemin e shqiptimit të sanksioneve penale si dënim progresiv, dënim që i zëvendësoi dënimet e deriatëhershme që si të tilla përfshiheshin dënimet me vuajtje fizike dhe psikike, dënimet trupore e fizike - sakatimet, deportime dhe dënimi me vdekje⁷, gjithashtu kohëzgjatja e panevojshme e mbajtjes së dënimit e humb qëllimin e dënimit apo efektet pozitive të tij që priten në raport me riedukimin, riintegrimin dhe risocializimin e personit të dënuar.

Me nocionin **riedukim**, **riintegrim** dhe **risocializim** duhet të kuptohet një gjendje tjetër kualitative, sipas së cilës personi i dënuar gjatë qëndrimit në entin ndëshkues dhe në bazë të tretmanit të zbatuar në të, ka ndryshuar esencialisht. Ai tani si personalitet ka pësuar transformim si në sjelljet e tij ashtu edhe në bindjet lidhur me veprën të cilën e ka kryer dhe raportet të cilat ai i ka patur lidhur me normat dhe regullat e ndryshme shoqërore. Riedukimi, riintegrimi dhe risocializimi siç po shihet kërkojnë një ndryshim rrënjësor të qëndrimeve dhe të sjelljeve të personalitetit të të dënuarit.⁸

Personat e dënuar që gjenden nëpër institucionet penitensiare apo korektuese ju nënshtrohen këtyre proceseve sepse nga veprimet apo sjelljet e tyre nuk i kanë

⁷ Buzharovska L.G., Alternativi za zatvorot, Shkup 2003, fq29.

⁸ Halili R., Penologjia, Prishtinë 2010, fq 146.

respektuar apo i kanë shkelur regullat ligjore dhe kjo shkelje ose mosrespektim i regullave ligjore konsiston në vepër kriminale. Termi institucion penitensiar apo korektues është një term tradicional që në literaturë përdoret si term i përgjithshëm për të gjitha organet në të cilat mbahet dënimi me heqje lirie.

2. Qëllimi i dënimit me burg (heqje lirie)

Konkretisht kur bëhet fjalë për dënimin me burg (heqje lirie), në pajtim me Ligjin për ekzekutimin e sanksione, qëllimi i ekzekutimit të dënimit me burg është aftësimi i personave të gjykuar që të kyçen në shoqëri me gjasa më të mira për jetë dhe të pavarur në pajtim me ligjin.⁹

Në fakt, në Kodin Penal të Republikës së Maqedonisë potencohet se përpos realizimit të drejtësis, qëllimi i ndëshkimit është:

- pengimi kryerësit të kryej vepër penale dhe riedukimi i tij, dhe
- në mënyr edukative të ndikoj ndaj të tjerëve të mos kryejn vepra penale¹⁰

Pra, qëllimi final i dënimit realizohet nëpërmjet frikësimit individual të kryerësit që ka të bëjë me sjelljet e tij kriminale në të ardhmen, dhe neutralizimin përmes izolimit të kryerësit që të realizohet mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti. Kurse ndikimi edukativ realizohet me shqiptimin e dënimeve të drejta dhe ekzemplare¹¹ dhe ky frikësim edukativo-moral është orientuar drejt qytetarëve që të zmbropsen nga kryerja e veprave penale dhe tu hiqet guximi kryerësve potencial.

⁹ Ligji për ekzekutimin e sanksioneve (Gazeta zyrtare e RM-së nr.2/2006,57/2010,170/2013,neni 37).

¹⁰ Kodi Penal i RM-së (Gazeta zyrtare e RM-së nr.37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 7/2008, 114/2009, 51/2011, 142/2012, 82/2013, neni 32).

¹¹ Kamboski V.,E Drejta Penale- pjesa e përgjithshme,Shkup 2007, fq 461.

3. Shqiptimi i dënimit me burg-heqje lirie (sistemi penitensiar)

Kur shtrohet çështja e ekzekutimit të dënimit me burg (privim nga liria), lind pyetja ku do të ekzekutohet ky dënim, ku do të transferohen dhe izolohen personat e gjykuar që shoqëria të mbrohet nga këto persona.

Si nevoj për regullimin e kësaj çështje u paraqitën sistemet penitensiare, që do të meren me mënyrën e regullimit, organizimit dhe funksionimit të entit ndëshkues. Me fjalë të tjera termin sistem penitensiar e kuptojm si formë apo mënyrë e planit ose organizimit spontan të jetës dhe qëndrimit në institucionet penitensiare pa marr parasysh motivet e shqiptimit të burgimit¹² të cilat sisteme që nga paraqitja e tyre janë zhvilluar në hapa me kohën dhe me praktikën penitensiare.

Si në të gjitha legjislacionet ashtu edhe në legjislacionin e Maqedonisë sistemi penitensiar kategorizohet në dy lloje: në kategorizim horizontal, entet ndëshkuese-përmirësuese që bazohen në kriteret objektive, dhe kategorizim vertikal, që bazohet në kriterin subjektiv për tretmanin e personave të dënuar. Përveç këtyre kriterëve janë të njohura edhe kriteret tjera: sipas llojit të dënimit me burg, kohëzgjatjes dhe lartësisë së dënimit, personave të dënuar, sipas moshës dhe gjinisë, dhe sipas shkallës së sigurisë, entet klasifikohen në: entet ndëshkuese-përmirësuese të tipit të mbyllur të sigurisë së lartë, entet ndëshkuese-përmirësuese gjysëm të hapur të sigurisë së mesme, entet ndëshkuese-përmirësuese të tipit të hapur, të sigurisë së ulët.¹³

Praktika dhe legjislacioni penitensiar bashkëkohor si në të gjithë botën ashtu edhe tek ne ka tendencën e punës dhe jetës së përbashkët të personave të dënuar në

¹² Sulejmanov Z., Penologija, Shkup 2005, fq 161.

¹³ Beqiri M., Organizimi dhe gjendja e institucioneve penitensiare në Republikën e Maqedonisë, Tetovë 2007, fq 48.

entet ndëshkuese-përmirësuese që ta organizojn në atë mënyr sa që të mundësohet riedukim i mirëfilltë dhe pa pengesë.

Sipas ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale në Republikë e Maqedonisë egzistojn këto lloje të institucioneve: institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe institucionet edukuese-korrektuese.

Si intitucione ndëshkimore-korrektuese mund të jenë: shtëpi ndëshkimore-korrektuese dhe burgje. Institucionet ndëshkimore-korrektuese janë: Shtëpia ndëshkimore-korrektuese Idrizovë me Repart të hapur në Veles, Shtëpia ndëshkimore-korrektuese Shtip, Shtëpia ndëshkimore-korrektuese e llojit të hapur në Strugë, Burgu i Manastirit, Burgu i Gjevgjelisë, Burgu i Kumanovës me Repart të hapur në Kriva Pallankë, Burgu i Ohrit, Burgu i Prilepit, Burgu i Shkupit, Burgu i Strumicës, dhe Burgu i Tetovës. Si institucione edukuese-korrektuese mund të jenë: Shtëpia edukuese-korrektuese në Tetovë dhe Shtëpia edukuese-korrektuese në Shkup.¹⁴

4. Lirimi i personave të dënuar nga mbajtja e dënimit

Çdo fillimi i vjen edhe fundi. Poashtu edhe personat e dënuar gjatë vuajtjes së dënimit mund të lëshohen nga institucioni penitensiar dhe t'i kthehen jetës së lirë, por që ta përjetojn këtë moment personat e dënuar dhe të lirohen para kohe nga dënimi duhet të plotësohen disa kriteriume gjatë qëndrimit në institucionin penitensiar siç janë : a) personi i dënuar nga momenti i fillimit të vuajtjes së dënimit të bashkëpunoj me personat adekuat për risocializim në kuadër të institucionit penitensiar, dhe ta pranoj me vetëdije procesin e risocializimit; b) në pajtim me regullat e rendit shtëpiak të institucionit penitensiar të ketë sjellje dhe

¹⁴ Ligji për ekzekutiminn e sanksioneve (Gazeta zyrtare e RM-së nr.2/2006,57/2010,170/2013, neni 19)

qasje pozitive në mjedisin e të dënuarve brenda institucionit; c) në mënyr të diciplinar dhe kualitative ti kryej detyrimet e parapara në punë gjatë periudhës së angazhuar me punë në institucionin penitensiar ; ç) të ketë raport pozitiv me të punsuarit në institucion, e posaçërisht me edukatorin dhe instruktorin dhe d) të mos i keqpërdor benifitet apo lehtësimet e dhëna nga ana e institucionit penitensiar gjatë vuajtjes së dënimit.¹⁵

Të gjithë personat e dënuar përfitojn nga planet që i ndihmojnë ata për t'u kthyer në jetën e lirë të tyre pas lirimit nga dënimi. Të gjithë personat e burgosur lirohen pa vones kur skadojnë urdhërat e dënimit ose në rast se gjykata kompetente ose një autoritet tjetër përkatës urdhëron lirimin e tyre.

Sipas dispozitave të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve, personat e dënuar lëshohen nga vuajtja e dënimit pas vuajtjes së plotë të dënimit, pas faljes së dënimit të mbetur me aktin e organit kompetent, vendimit për lirimin me kusht ose me vendimin e drejtorit të institucionit për lirimin e parakohshëm nga vuajtja e dënimit.¹⁶

5. Përgaditja për lirim nga enti penitensiar

Para se të lirohen nga institucioni ndëshkimor personat e dënuar ato paraprakisht përgaditen për lirim nga ana e institucionit. Kjo përgaditje fillon që me ardhjen e personave të dënuar në institucionin ndëshkimor, sepse me personat e dënuar duhet punuar me seriozitet dhe profesionalizëm nga ana e personelit të institucionit për arsye se edhe vetë qëllimi i dënimit është që personat e dënuar (të burgosurit) sa më shpejt ti kthehen jetës së tyre në liri si më parë, pranë familjes

¹⁵ Pravilnik za utvrduvanje na kriteriumite za predvremeno otpustanje na osudenoto lice pred istek na kaznata (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.123/2007, neni 2).

¹⁶ Arnaudovski L., Drakulevski A.G., Zakon za izvrshvanje na sankciite, (integralen tekst so predgovor, kratki objasnvanja i registar na poimite), Shkup 2011, fq 112.

dhe rethit shoqëror të tyre, gjithashtu gjatë vuajtjes së dënimit nuk duhet që të kenë kufizime të lirive, përveç në raste të veçanta, të mos j'u ndërpriten kontaktet e jashtme, zhvillimi personal, t'u jepen këshilla për mos përsëritjen e veprës penale, të informohen me pasojat nga kryerja e veprave tjera penale, pas daljes nga institucioni të inkuadrohen në punë, etj. Ashtu që kushtet e jetës në liri të mos jenë të barabarta me kushtet e jetës në burg, por bilansi i këtyre kushteve të jetë sa më i vogël që personat e dënuar të mundën sa më lehtë ti përshtaten dhe ta normalizojn jetën me kushtet e burgut. Për këtë arsye nëpër institucionet ndëshkimore realizohet programi i tretmanit ndaj personave të dënuar, i cili mund të jetë tretman penal përkatësisht institucional dhe postpenal përkatësisht postinstitucional¹⁷ që nënkupton një sistem dinamik i masave, metodave dhe procedurave ndaj personave të dënuar në institucion në kohën e vuajtjes së dënimit me burg dhe periudhë postinstitucionale në drejtim të zhvillimit dhe realizimit të cilësive pozitive personale dhe aftësimin si qëllim të fundit, risocializimin e tij dhe adaptimin social në shoqëri pas vuajtjes së dënimit.

Gjithashtu edhe Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale e parasheh në disa nene procesin e përgatitjes së personave të dënuar nga institucioni. Kështu që neni 193 po i këtij ligji parasheh se personi i dënuar përgatitet për lirim nga vuajtja e dënimit, nga fillimi i vuajtjes së dënimit në institucion. Aktivitetet e përgatitjes intensifikohen në tre muajt e fundit para skadimit të dënimit, përkatësisht para ditës kur supozohet se do të lëshohet. Këta persona të dënuar dërgohen në repartin për lëshim, në të cilin aktivitetet për përgatitje realizohen sipas programit të veçantë për përgatitje për lëshimin e personave të dënuar. Personat e dënuar gjatë përgatitjes për lëshim, këshillohen për pasojat e dënimit nga përsëritja e veprës penale, për mundësit për menjanimin e këtyre pasojave dhe shmangien nga përsëritja e veprës. Personit të dënuar mund t'i lejohet që sipas nevojës gjatë kohës

¹⁷ Upatsvtvo za vidovite i nacinite na tretman na osudenite lica, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.123/2007, neni 3).

që është në repartin e lëshimit, të dalë nga institucioni për të kërkuar punë ose për vendosje. Dy ditë para lëshimit, personi i dënuar lirohet nga puna që të mund të përgatitet për dalje.

Në nenet pasuese po të këtij ligji lirimi i personit të dënuar bëhet në hapsira të veçanta ku zhvishet nga sendet që ka qenë i obliguar t'i mbaj nga ana e institucionit, më pas kontrollohet nga mjeku i institucionit dhe konstatohet gjendja shëndetësore e personit të dënuar, ku në nenet 194 dhe 195 thuhet: Para lëshimit personin e dënuar e kontrollon mjeku i institucionit, i cili me shkrim do ta konstatoj gjendjen e tij shëndetësore në momentin e lëshimit. Nëse personi i dënuar në kohën e lëshimit nga vuajtja e dënimit është i sëmurë rëndë, institucioni do ta vendos në institucionin më të afërt shëndetësor. Nëse personi i dënuar nuk ka mjete që t'i paguajë shpenzimet e mjekimit për muajin e parë të mjekimit ato do të bien në llogari të institucionit, ndërsa për mjekim të mëtejshëm do të vepohet sipas dispozitave të përgjithshme. Gjithashtu institucioni i bartë shpenzimet e transportit për personin e dënuar, nga institucioni deri te vendbanimi përkatësisht vendqëndrimi, nëse personi që lëshohet nuk ka mjete për këtë dedikim.

6. Lirimi pas mbajtjes së dënimit

Sipas nenit 197 të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve, lirimi i personave të dënuar pas vuajtjes së dënimit bëhet sa më shpejt dhe më herët, në orët e parapara të ditës së skadimit të dënimit dhe në qoftë se dita e fundit e vuajtjes së dënimit qëllon ditën e diell apo në ditë feste, atëher personi i dënuar do të lëshohet në ditën që i paraprin asaj dite.

7. Lirimi nga falja e dënimit

Personat e dënuar përveç rasteve tjera mund të lirohen nga vuajtja e mëtejme e dënimit nga institucioni edhe me aktin e amnistisë dhe të faljes, ku sipas nenit 198 të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve këtë akt e miraton organi kompetent.

7.1. Amnistia

Amnistia konsiston në faljen e dënimit të kryerësit të veprës penale që jepet me anë të akteve të organeve më të larta të pushtetit. Aplikimi i saj është përjashtim nga parimi se është e drejtë që çdo kryerës i veprës penale të marrë dënimin e merituar. Në këtë mënyrë ajo paraqitet dhe vepron më fuqishëm se vetë ligji i cili përcakton dënimin për veprën penale të kryer edhe nga vetë vendimi gjyqësor me të cilën është shqiptuar ky dënim. Amnistia është institucion i vjetër që ka një zhvillim të pasur historik dhe është e njohur qysh në të drejtën romake dhe të mesjetës.

Nocioni *Amnestia* (fjalë greke – *haresë*) është akt i organit legjislativ në formë të ligjit me të cilin rrethit të papërcaktuar njerëzish, në mënyrë nominale u jepet liria nga ndjekja, liri të plotë ose të pjesërishtme prej kryerjes së dënimit, u ndryshohet dënimi i shqiptuar me dënim më të butë, u përcaktohet shlyerje e dënimit apo u hiqet pasoja e përcaktuar juridike e dënimit,¹⁸ me ligjin për amnisti mund të parashihet lirim prej ndjekjes edhe për ato vepra të cilat me ligjin e ri më të butë janë të dekriminalizuara.

¹⁸ Kambovski V., E drejta penale- pjesa e përgjithshme, Shkup 2007, fq 588.

Akti i amnistisë i dhënë nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë,¹⁹ me veprimin e tij nuk godet autoritetin e vendimeve gjyqsore, por ai vendim edhe më tutje konsiderohet si i plotëfuqishëm dhe i ligjshëm.

Nga ajo që u pasqyrua më lartë kuptojm se :

- amnistinë e jep Parlamenti i Republikës së Maqedonisë në formë të ligjit, dhe atë në procedur të njejt si të gjitha ligjet tjera.
- është akt me karakter publik, dhe nuk mund të refuzohet nga ana e personave ndaj të cilëve është sjellur, dhe nuk mund të rëndohet pozita e personave të interesuar nga amnestia.
- amnistia mund të veproj edhe në formë të *abolacionit* – si pengesë absolute procedurale²⁰ për ndërprerjen e çdo lloj veprimi në çdo fazë të procedur penale kundë kryerësve të veprave penale.
- është akt i bazuar në raste individuale dhe për rreth të papërcaktuar njerëzish.

Me dhënien e amnistisë nuk cënohen të drejtat e personave të tretë që mbështeten në gjykim. Personat e dëmtuar me veprën penale kanë të drejtë të kërkojnë kompensim të dëmit (realizim të kërkesës juridiko-pasurore) të shkaktuar nga vepra penale e gjykuar, apo kthimin e gjësendit që i është marrë, këtu mendohet për procedurë civile.

Ligji i amnistisë është pjesë e zgjidhjes së problemit të fenomenit të mbipopullimit të panevojshëm të burgjeve i cili e zbehë procesin e risocializimit dhe rahabilitimit.

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, neni 68.

²⁰ Sulejmanov Z., Krivichno parvo- opst del, Shkup 2005, fq 507

Ky institut me rëndësi të shumëfishtë mundëson përmirësimin e gabimve gjyqësore që janë konstatuar pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve juridike gjatë procedurës penale, mundëson përmirësimin e rasteve për risocializim të të dënuarit, d.m.th mundëson zgjedhjen e situatave të llojllojshme që mund të shfaqen pas plotëfuqishmëris së vendimit gjyqësorë.

Ky institut është i inkorporuar dhe parashihet në Ligjin për amnisti.²¹

7.2. Falja

Edhe falja është një mënyrë e lirimit të personit të dënuar nga vuajtja e mëtejme e dënimit.

Falja është institut që ka veprim të njejtë si edhe amnistia, me dallime të vogla që nuk e ndrihojnë bazën e saj në *akt të faljes* me të cilën personave të caktuar, në mënyrën nominale u jepet lirim prej ndjekjes ose lirim i pjesërishëm ose i plotë prej kryerjes së dënimit, i zëvendësohet dënimi i shqiptuar me dënim më të butë, ose me masë alternative, ose i përcaktohet shlyerje të dënimit, ose i hiqet gjegjësisht i përcaktohet afat më i shkurt i pasojës së përcaktuar juridike. Përveç kësaj me faljen mund të përcaktohet heqje ose afat më i shkurt i dënimit, ndalesë për të kryer profesion ose detyrë, ndalesë për të drejtuar automjete, kryerësve të cilët janë vozitës me profesion dhe dëbimin e të huajt nga vendi.²²

Falja u jepet personave të caktuar në mënyrë nominale me vendim, kurse kompetent për falje është Presidenti i Republikës së Maqedonisë,²³ dhe procedura për falje është e rregulluar me Ligjin për falje²⁴ i cili dallon në bazë të kërkesës së

²¹ Ligji për amnisti (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.6/99,18/02).

²² Kambovski V.,E drejta penale- pjesa e përgjithshme, Shkup 2007, fq 589.

²³ Ibid, fq 589.

²⁴ Ligji për falje, (Gazeta zyrtare e RM-së nr.20/1993, 39/1993, 136/06, 98/2008, 12/2009, 170/2010, 103/2011, 182/2012, 85/2012, 90/2012, 95/2012).

kryerësit dhe sipas detyrës zyrtare kur Presidenti i shtetit do të vlerësoj se për këtë egzistojn shkaqe të caktuara.

Me ndryshimet dhe plotësimet e reja në Ligjin për falje,²⁵ falja nuk mund t'u jepet personave të dënuar për vepra penale *kundër zgjedhjeve dhe votimeve*, për vepra penale *kundër lirisë dhe moralit gjinor*, veprat penale *të kryera ndaj fëmijëve dhe personave të mitur*, për vepra penale *kundër shëndetit të njerëzve*, për vepra penale *prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike supstancave psikotrope dhe prekursorëve*, për vepra penale *mundësim i përdorimit të lëndëve narkotike*, dhe për vepra penale *kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare*. Gjithashtu nuk mund t'i jepet falja personit shtetas të R.Maqedonisë i cili vuan dënim në R.Maqedonisë por është dënuar me aktgjykim të Gjykatës penale ndërkombëtare.

Procedura për falje mund të filloj me paraqitjen e kërkesës me shkrim nga personi i dënuar, ose në emër të personit të dënuar kërkesa mund të bëhet edhe nga bashkëshorti, bashkëshortja, prindërit, fëmija, vëllai, motra ose nga ndonjë person tjetër i autorizuar nga personi i dënuar, ose sipas detyrës zyrtare nga ana e Ministrit të drejtësisë.

Kërkesa për falje përsëri mund të parashtrohet në afatet e para në Ligjin për falje,²⁶ që mund të jenë:

- pas skadimit të 3 muajve nga dita kur është marrë vendimi për kërkesën e parë, kur shqiptimi i dënimit me burg ose burg për të mitur është me kohëzgjatje deri 1 vjet; pas skadimit të 6 muajve kur shqiptimi i dënimit me burg është me kohëzgjatje deri 3 vjet; pas skadimit të 1 viti kur është shqiptuar dënim më i lartë prej 3 vjet.

²⁵ Ligji për falje, (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 12/2009).

²⁶ Ibid , neni 6.

- pas skadimit të 5 vjet kur është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm.
- Nëse procedura për falje është inicuar sipas detyrës zyrtare afati për parashtrimin e sërishëm të kërkesës rrjedh nga dita e marjes së vendimit për dhënjen e faljes me detyrë zyrtare.

Kërkesa për procedurën e faljes deri te Presidenti i Republikës së Maqedonisë parashtrohet nëpërmjet gjykatës së shkallës së parë që e ka shqiptuar dënimin, dhe procedura për falje fillon menjëher. Kërkesa paraqitet pas plotëfuqishmërisë së vendimit gjyqsorë.²⁷ Me dhënjen e faljes sikurse edhe te amnistija nuk preket në të drejtën e personave të tretë të bazuar në dënim.²⁸

8. Lirimi sipas lirimimit me kusht

Ndryshe nga tre mënyrat e lirimimit të personave të dënuar nga vuajtja e mëtejme e dënimit, lirimi me kusht është me një natyrë krejt ndryshe të lirimimit të parakohëshëm të personave të dënuar nga vuajtja e mëtejme e dënimit, i cili ka një rëndësi dhe pozitë të veçant në praktikën penitensiare.

Në tekstin e mëtutjeshëm interesi ynë do të fokusohet drejt një studimi me të thelluar të lirimimit me kusht si një institut me përmbajtje dhe qëllim më esencial të shqiptimit të dënimit me burg. Ky institut i përfshirë në Kodin Penal të R.Maqedonisë dhe në Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve modifikon dënimin me burg dhe konsiston në lirimimin e parakohshëm të personit të dënuar me burg ose me burg të përjetshëm, që ka për qëllim nxitjen e sjelljes së mirë të të dënuarit në burg.

²⁷ Ibid, neni 4, neni 5.

²⁸ Kambovski V., E drejta penale- pjesa e përgjithshme, Shkup 2007, fq 590.

9. Lirimi sipas vendimit të drejtorit të entit penitensiar

Si mënyr e fundit e lirimit të personit të dënuar nga lirimi i mëtutjeshëm është edhe lirimi me vendim të drejtorit të institucionit. Përveç gjyqit si organ kompetent për institutin e lirimit me kusht po ashtu kompetent për lirimin e personit të dënuar është edhe drejtori i institucionit ndëshkimor-korrektues.

Sipas nenit 206 të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve drejtori i institucionit mund ta lëshoj personin e dënuar edhe para skadimit të dënimit, nëse ka vuajtur së paku tre të katërtat (3/4) e dënimit me burg, dhe nëse personi i dënuar nuk ka marr lirim me kusht, edhe atë deri më 30 ditë për dënim me burgim deri një (1) vjet, deri më 90 ditë për dënim me burgim deri pesë (5) vjet dhe deri 120 ditë për dënim me burgim mbi pesë (5) vjet.

Drejtori i Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve me akt të përgjithshëm përcakton kriteret për lirimin e parakohëshëm të personit të dënuar para skadimit të dënimit, nëse plotësohen këto kriteret²⁹ : a) personi i dënuar nga momenti i fillimit të vuajtjes së dënimit të bashkëpunoj me personat adekuat për risocializim në kuadër të institucionit penitensiar, dhe ta pranoj me vetëdije procesin e risocializimit; b) në pajtim me regullat e rendit shtëpiak të institucionit penitensiar të ketë sjellje dhe qasje pozitive në mjedisin e të dënuarve brenda institucionit; c) në mënyr të diciplinar dhe kualitative t'i kryej detyrimet e parapara në punë gjatë periudhës së angazhuar me punë në institucionin penitensiar; ç) të ketë raport pozitiv me të punsuarit në institucion, e posaçërisht me edukatorin dhe instruktorin dhe d) të mos i keqpërdor benifitet apo lehtësimet e dhëna nga ana e institucionit penitensiar gjatë vuajtjes së dënimit.

²⁹ Pravilnik za utvrduvanje na kriteriumite za predvremeno otpustanje na osudenoto lice pred istek na kaznata (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.123/2007, neni 2).

Kapitulli II

1. Historiku i lirit me kusht, zhvillimi dhe përkufizimi i tij

1.1. Historiku dhe prejardhja etimologjike e lirit me kusht

Heqja e lirisë apo dënimi me burg nëpër etapat e zhvillimit historik të saj dërgoi deri te paraqitja e më shumë sistemeve penitensiare, kurse me zhvillimin e penologjisë u shtrua nevoja e paraqitjes së karakteristikave themelore dhe mënyrës bashkëkohore të shqiptimit të këtij dënimi. Dënimet me burgim janë sanksione penale të cilat, në shtetet bashkëkohore aplikohen më së shumti në praktikën gjyqësore. Këto dënime zënë vend qëndror në sistemin e sanksioneve penale. Trajtimi dhe studimi i dënimeve me burgim bëhet lëndë kryesore e penologjisë bashkëkohore.

Paraqitja e dënimit me burgim ka qenë një hap i madh drejt humanizmit të reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit e sidomos të tretmanit ndaj personave të dënuar. Nëse shikohet me kujdes rruga e zhvillimit të dënimeve me burgim që nga burgjet e para e deri te entet bashkëkohore, do të vërehet se nëpërmes mënyrës së ekzekutimit të dënimit me burg dhe trajtimit të personave të dënuar është shprehur filozofia e përmisimit dhe e riintegrit. Në fillim dënimet me burgim shikuar për nga numri, llojet, dhe mënyra e ekzekutimit kishin kryekëput qëllimin e hakmarjes, shpagimit dhe shkaktimit të vuajtjeve personave të dënuar, dhe shumë pak kanë pasuar qëllime të tjera. Ndërsa më vonë, me depërtimin e ideve humaniste shkencore dënimi me burgim synon përmirësimin dhe riintegrimin e personave të dënuar. Mirëpo kjo rrugë e transformimit të ideve dhe pikëpamjeve të këtilla ka qenë e gjatë dhe me plotë kontradikta. Procesi i transformimit të këtyre ideve dhe mendimeve vazhdon edhe sot e kësaj dite. Për ta pasqyruar këtë rrugë në mënyrë më të qartë në vazhdim do të paraqiten sisteme dhe metoda kryesore të ekzekutimit

të dënimit me burgim. Megjithatë këto sisteme penitensiare nuk u paraqitën në të gjitha shtetet dhe as në të njëjtën kohë. Lidhur me karakterin dhe llojin e këtyre sistemeve në literaturën penologjike ka mendime të ndryshme. Disa autorë mendojnë se egzistojnë shumë sisteme kurse disa të tjerë përqëndrohen vetëm në tri apo katër, mirëpo si do që të jetë do të paraqiten të gjitha ato sisteme dhe metoda të ekzekutimit të dënimit me burgim të cilat në mënyrë kronologjike, historike janë lajmëruar prej momentit të paraqitjes të dënimit me burgim deri në ditët e sotme.

Nga këto arsye menduam se të gjitha sistemet penitensiare që u paraqitën në fillim të sh. XX deri në paraqitjen e sistemit bashkëkohor të ekzekutimit të dënimit me burgim (heqje lirije) të përmenden si më poshtë:³⁰

- a) sistemi i burgut kolektiv : Ky është sistemi i parë i organizimit të ekzekutimit të dënimit me burgim, dhe është aplikuar që nga momenti i parë i paraqitjes së dënimeve me burgim dhe ka egzistuar deri sa janë bërë reformat të dukshme të burgjeve në sh.XIX. Sipas këtij sistemi, nuk ka klasifikim të të dënuarve ndodh që, të dënuarit për krime të rënda, recidivistët, personat me karrierë të gjatë kriminale, personat e vjetër dhe të miturit, kryerësit primar dhe sekundar etj, dënimin ta vuajn bashkarisht. Si lokalitete për ekzekutimin e dënimeve me burgim gjatë këtij sistemi fillimisht përdorëshin: bodrumet dhe lokalet e braktisura të fortesave, kështjellave, dhe objekteve të vjetra ku kushtet e jetës ato higjienike dhe shëndetësore ishin të mjerueshme. Disa autorë me të drejtë theksojnë se burgjet e këtilla kolektive ishin një “Universitet i krimeve” sepse këtu të dënuarit primar kishin rastin që të shoqëroheshin me recidivistët, me personat me karrierë të gjatë kriminale, personave të mitur u

³⁰ Sulejmanov Z., Penologjia, Shkup 2005, fq 161

mundësohet të shoqëroheshin me persona të rritur dhe me përvojë kriminale nga të cilët mësonin mënyra dhe metoda të kryerjes së krimeve.

b) sistemi i izolimit ose i qelisë, që në literaturën penologjike përmenden dy variante të këtij sistemi : sistemi klasik i qelisë (pencilvanik apo filadelfik) dhe sistemi i heshtjes apo i Obernit (Auburn-it): Sistemi klasik i qelisë për herë të parë është paraqitur në qytetin Filadelfia të shtetit të Pensilvanisë në SHBA në vitin 1790, sipas këtij sistemi të gjithë të dënuarit duhet të vendosen nëpër qeli të veçanta të qëndrojnë të izoluar dhe të vetmuar dhe të mos kenë kontakt me botën e jashtme një kohë të caktuar, dhe në këtë mënyrë të pendohen për krimin që kanë bërë. Sistemi i heshtjes apo i Obernit (Auburn-it) u paraqit në qytetin e Obernit të shtetit të Nju Jorkut dhe sipas këtij sistemi personat e dënuar natën qëndrojnë të ndarë nga njëri-tjetri dhe plotësisht të izoluar, ndërsa gjatë ditës dërgoheshin në punë dhe aty u jepej mundësia të dalin nga izolimi dhe të punojnë së bashku me të dënuarit tjerë. Mirëpo gjatë kohës së punës ata e kanë pasur të ndaluar çdo komunikim.

c) sistemi progresiv me tri variantet e tij : sistemi progresiv anglez, sistemi progresiv irlandez dhe sistemi i pikëve ose i Makonakut: ***Sistemi progresiv anglez*** për herë të parë u paraqitet në Angli në vitin 1853. Sipas këtij sistemi gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim të dënuarit duhet të kalojnë nëpër tri faza kryesore: faza e parë është faza e qëndrimit të personit të dënuar në qeli, faza e izolimit të personit të dënuar duke mos pasur asnjë kontakt me të burgosurit tjerë e as me botën e jashtme. Në fazën e dytë të këtij sistemi personat e dënuar gjatë ditës punojnë së bashku me personat e tjerë të dënuar, dhe të

dënuarit mund të komunikojn lirshëm dhe gjatë angazhimit në punë ata kanë mundësi të aftësohen në mjeshtëri dhe zanate të caktuara, ndërsa natën qëndrojnë të izoluar në qeli. Poashtu në këtë fazë personat e dënuar klasifikohen sipas moshës, motiveve të kryerjes së veprës penale, peshës së veprës penale, lartësisë së dënimit etj. Faza e tret e sistemit progresiv anglez qëndron në lëshimin me kusht të personit të dënuar, që do të thotë se personat e dënuar lirohen para kohe dhe dalin në liri pa e mbajtur tërë dënimin e parapar sipas vendimit gjyqësor. Ata konsiderohen si të dënuar dhe se në liri janë duke u sprovuar dhe nëse nuk sillen mirë apo kryejn ndonjë vepër tjetër penale përsëri kthehen në ent dhe lirimi me kusht revokohet. ***Sistemi progresiv Irlandez*** u themelua në vitin 1854 nga Walter Grofton anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e institucioneve Ndëshkimore në Irlandë. Edhe ky sistem e përkrah parimin e shkallëzimit të ekzekutimit të dënimit me burgim nëpër disa faza: fazën e qelisë, fazën e burgut të përbashkët, fazën e qëndrimit në paralele për të lirë, dhe fazën e lëshimit me kusht në liri. Në këtë sistem personat e dënuar para se të lirohen me kusht duhet të vendosen në një objekt të veçant ku kushtet e jetës dhe të punës janë krejtësisht tjera nga ata të personave që gjenden në fazën e burgut të përbashkët. Sistemi progresiv irlandez i ka edhe fazat e tjera të ngjashme me ato të sistemit progresiv anglez. ***Sistemi i pikëve ose i Makonakut*** këtë sistem të ekzekutimit të dënimit me burgim për herë të parë e ka aplikuar drejtorin i entit ndërkimor në ujdhesën Norfolk Aleksander Makonak në vitin 1840. Në këtë sistem, dënimi për secilin është shprehur me një shumë të poenave dhe të pikëve. Sipas sistemit të pikëve apo të poenave në fazën e parë personat e dënuar i nënshtrohen një disipline të rreptë, në

këtë fazë ata kanë qenë të detyruar të punojnë, por puna ka qenë shumë e rëndë dhe detyrimet lidhur me respektimin e rendit shtëpiak kanë qenë rigoroze dhe shpesh herë janë ndëshkuar në mënyrë të ashpër për shkeljet e këtyre detyrimeve. Në fazën të këtij sistemi personat e dënuar ndaheshin në grupe dhe për secilin grup të të dënuarve caktohej numri i poenave ose i pikëve që duhet të përmbushnin, vetë të dënuarit i'a caktonin pikët njëri-tjetrit ku për caktimin e pikëve për secilin anëtar të grupit merreshin parasysh aftësit fizike shëndetësore. Në fazën e tretë grupi i të dënuarve shpërndahej dhe secili person i dënuar tani fitonte një shtëpiz të veten me një sipërfaqe të caktuar të tokës, ku ai mund të mirej me punë bujqësore duke kultivuar prodhime të ndryshme. Personat e dënuar duhej t'i përmbushnin një sasi të poenave ose pikëve dhe obligimeve për të arritur lirin e tyre të plotë.

Lirimi me kusht është një institut i njohur në praktikën penitensiare të të gjitha shteteve bashkëkohore, i cili ka një traditë të gjatë dhe të pasur në praktikën e ekzekutimit të dënimit me burg. Ai prej momentit kur është paraqitur e deri në ditët e sotme, ka pësuar transformime dhe risi mjaftë të rëndësishme. Sipas të dhënave nga literatura dhe nga ajo që u ekzagjërue më lartë nga sistemet penitensiare ky institut për herë të parë paraqitet në sistemin progresiv anglez të ekzekutimit të dënimit me burgim. Sipas këtij sistemi lirimi me kusht cilësohet si faza e tretë e mbajtjes së dënimit me burgim, personat e dënuar liroheshin para kohe dhe dilnin në liri pa mbajtur tërë dënimin e paraparë sipas vendimit gjyqësorë. Lirimi me kusht është një nga format e vjetra të lirit të personave të dënuar si rezultat i sjelljeve të mira në institucionin ndëshkimor si dhe plotësimin e kushteve objektive që t'a lëshoj burgun para se t'a vuaj deri në fund dënimin e shqiptuar me burg. Këtu bëhet fjalë për modifikimin e pjesës së fundit të vuajtjes së dënimit të

shqiptuar me burg. Prej këtu lirimi me kusht paraqitet si institut i rëndësishëm juridiko-penal dhe penologjik.

Mirëpo, lirimi me kusht u jepej vetëm atyre personave të dënuar të cilët me sjelljet e tyre, me rezultatat e arritura në punë, kishin treguar suksese të veçanta pasi që personat e dënuar gjatë fazës së qëndrimit në burgun e përbashkët kanë pasur mundësi që me angazhimin e vet të përparojn të ecin në mënyr progresive prej një grupi në grupin tjetër, prej një nëngrupi në nënrupin tjetër dhe të fitojn beneficione të caktuara dhe në këtë mënyr ata kanë krijuar para kushte që të lirohen dhe të dalin prej burgu para kohe. Mirëpo, sipas këtij sistemi personat e dënuar edhe pse janë liruar para kohe prej burgu kanë pasur edhe më tej obligime dhe detyrime për mirësjellje dhe respektim të ligjit.

Ata faktikisht konsideroheshin si të dënuar pasi që në liri ishin duke u sprovuar dhe në qoftë se nuk silleshin mirë ose kryenin ndonjë krim, mund të ktheheshin përsëri në ent dhe lirimi me kusht të revokohej. Për këtë arsye në Angli personat e liruar me kusht vihen në sprovë.³¹

Padyshim se, lirimi me kusht për personat e dënuar që kanë vuajtuar një pjesë të dënimit me burgim dhe të cilët me sjelljet e tyre kanë treguar se mund të kthehen në mjediset sociale paraqet një mundësi të një lloji “risocializim të lehtë” me mundësi që të arrihen qëllimet e dënimit gjatë periudhës së zgjatjes së tij.

Ashtu si shumë institute tjera të cilët kanë historikun dhe gjenezën e vetë edhe ky institut nuk u paraqit si në kuptimin e sotëm. Në fushën e shkecave juridike është e paparashikuar që një term të kaloj pa mos u theksuar prejardhja etimologjike e tij dhe të jepet definicioni dhe kuptimi origjinal gjatë zhvillimit historik të tij, funksionet e tij, nga paraqitja e parë e deri më sot. Ashtu është edhe

³¹Halili R., Penologjia, Prishtinë 2010, fq 112.

me termin e lirimit me kusht që në këtë kuptim do ta sqarojm zhvillimin dhe prejardhjen e tij, zbatimin teorik dhe praktik të tij si dhe kushtet që kushtëzuan prejardhjen e tij.

Termi lirim me kusht rrjedh nga fjala franceze **palore** që në kuptimin tekstual d.t.th. *fjalë, premtim*. Domethënja e lirimit me kusht përdoret në kuptimin **palore d'honneur** që d.m.th. **fjalë e dhënë ose e premtuar**. Kjo në thelb nënkupton garancionin që e jep personi i dënuar me dënim me burgim, se më tutje do të veproj në pajtim me kushtet nën të cilat është liruar nga burgju para mbajtjes së plotë të dënimit të shqiptuar me burgim, dhe se në të ardhmen do të sillet mirë dhe nuk do të kryej vepër të re penale.

Patjetër duhet të theksohet se këtu bëhet fjalë për një kuptim simbolik të institutit të lirimit me kusht e jo thjeshtë mbajtja e **fjalës së dhënë** e aq më pak për vullnetin e njëanshëm të personit të dënuar që pjesën e mbetur të dënimit ta kaloj në liri.

Lirimi me kusht nisët nga ajo se personi i dënuar me dënim me burgim të ngarkohet edhe me një lloj besimi se ai mund të përmisohet dhe se do të veçoj përvoja nga pjesa e vuajtjes së dënimit dhe në bazë të kësaj të formoj një model të ri të sjelljeve dhe mendimeve, të formoj një sistem të ri vlerash ose të kthehet në gjendjen që e ka pasur para se të kryej vepër penale, që do të mundësonte në të ardhmen të veproj në pajtim me rregullat pozitive dhe vlerat morale shoqërore.

Megjithatë, kjo mënyrë nuk do të ishte e plotë dhe e besueshme pa personin e dënuar i cili gjatë mbajtjes së një pjese të dënimit të bëhet testimi dhe verifikimi në mënyrë të përshtatëshme se deri ku ka arritur përmirësimi i tij, sa ka përparuar personi i dënuar në të vërtetë, se a ka ndryshuar personi i dënuar deri në atë masë që të kthehet në liri, dhe në liri ta mbaj pjesën e mbetur nga dënimi. Vërtetimi i këtyre

fakteve bëhet në bazë të një analize apo studimi të personalitetit të personit të dënuar, me qëllim që të vërtetohet harmonizimi ndërmjet fjalëve dhe veprimeve të personit të dënuar. Nga kjo analizë dhe studim i bërë për personalitetin e të dënuarit është e nevojshme që të arrihet deri te vlerësimi se qëndrimi i personit të dënuar në entin ndëshkues nuk është e nevojshme dhe mbajtja e mëtutjeshme mund të ketë ndikim dhe efekte negative në raport me atë që u paraqit si efekt pozitiv nga pjesa e mbajtjes së dënimit me burgim.

Sipas të dhënave nga literatura idenë e lirimimit me kusht për herë të parë e hasim në gjysmën e dytë të sh. XVIII , pothuajse njëkohësisht me pranimin e dënimit me heqje lirie si sanksion penal më dominant. Ashtu siç theksuam dënimi me burgim nga inkorporimi i tij në legjislacionet penale si dënim kryesor, i cili dënim me një përfshirje të gjërë është pranuar edhe nga gjykatat që masovikisht filluan ta aplikojn në gjysmën e dytë të sh. XVIII, njëkohësisht u ballafaqua me kritika të ashpra. Një nga kritikantët e ashpra që i drejtohej dënimit me burgim është rritja e kriminalitetit.

Ideja për lirimimin me kusht nuk do të ishte plotësisht e shpjeguar nëse nuk do të përmendim themeluesit e saj. Ndër themeluesit e parë të kësaj ideje në literaturë përmendet **Xhon Huard**,³² i cili lidhur me problemin dhe pozitën e vështirë të burgjeve ka shkruar veprën e tij të njohur **“Gjendja e burgjeve në Angli dhe në Uells” (State of prison in England and Wales 1777 vit)**, i cili nga vizita që u ka bërë burgjeve në Angli dhe në Uells ka kërkuar ndryshimin dhe transformimin rrënjësor të tyre. Ai vërteton se kushtet e vuajtjes së dënimit me burgim nëpër këto burgje janë shumë të vështira dhe të mjerueshme dhe se dënimin e vuajnë së bashku të dënuarit e rinj dhe të moshuar, të dënuarit e sëmure dhe të shëndoshë, kriminelët primar dhe kriminelët e rrezikshëm dhe recidivistët, me personat që për

³² Krstanovski M., Uslovniot otpust kako penoloski institut (studentski zbor), Shkup 1996, fq.97

herë të parë kanë ardhur në burgjet e tilla. Për këtë arsye Xhon Huard propozon që këto burgje të transformohen dhe të bëhet përmirësimi i kushteve të jetesës dhe të punës.

Lirimi me kusht për herë të parë ka filluar të aplikohet në kolonitë angleze në Australi në sh. XIX, ndërsa juridikisht me rregullore të posaçme është rregulluar në vitin 1929. Vënia në zbatim të këtij kishte për qëllim humanizmin e sistemit të ekzekutimit të dënimit me burgim ose me heqje lirie, sistem ky që gjatë asaj kohe siç dihet ishte mjaft jo human dhe represiv.

Ndërkaq në Angli lirimi me kusht aplikohet në vitin 1843, kur u themelua edhe enti për ekzekutimin e dënimit me heqje të lirisë në Pentovil afër Londrës. Në vitin 1853 nxiren rregulla të reja mbi lirimimin me kusht të personave të dënuar, ndërsa në vitin 1857 definitivisht shënon institucionalizimin me ligj **Penal law** të institucionit të lirimimit me kusht në Angli. Lirimi me kusht konsiderohet si faza e fundit e procesit në ekzekutimin e dënimit me heqje lirie. Supozimet formale të lëshimit me kusht ishin 3/4 nga vuajtje e dënimit për meshkujt dhe 2/3 për femrat si persona të dënuar, ndërsa si supozim material ishte sjellja shembullore e personave të dënuar.

Në kontinentin evropian lirimi me kusht filloj të aplikohet në gjysmën e parë të sh. XIX. Si institut ligjor lirimi me kusht në Europë për herë të parë u paraqit në Mbretërin Gjermane në vitin 1871 kur u kodifikua Kodi Penali Mbretëris Gjermane. Më vonë instituti i lirimimit me kusht parashihet edhe nga legjislacionet penale të shteteve tjera si: Itali 1889, Belgji 1888, Rusi 1875, Francë 1885, Sërbi 1869, Portugali 1893, etj.

Po ashtu kjo masë paraqet një lloj korigjimi të vendimit gjyqësor në pjesën mbi dënimin dhe ndihmon në masë të madhe në realizimin konsekuent të individualizimit të dënimit.

Por edhe përkundër përvojës së gjatë dhe të pasur të tij në literaturën juridike- penale dhe penologjike ende janë të pranishme mendimet e ndryshme rreth natyrës juridike dhe penologjike të tij. Në legjislacionin bashkëkohorë të ekzekutimit të dënimit me burgim lirimi me kusht paraqet mjet të rëndësishëm për nxitjen dhe stimulimin e të dënuarve në procesin e risocializimit dhe të riedukimit të tyre.

2. Natyra juridike dhe nocioni i lirimit me kusht

2.1. Natyra juridike e lirimit me kusht

Para se të thuhet diçka më tepër për lirimin me kusht, më parë duhet të përcaktohet nocioni i tij që nuk është punë e lehtë duke u nisur nga kjo që bëhet fjalë për një institut juridiko – penal i cili duke e pasur parasysh qëllimin e vetë është i lidhur ngusht me institutet tjera të kësaj fushe, poashtu edhe me ekzekutimin e sanksioneve penale.

Instituti i lirimit me kusht parashihet në të gjithë legjislacionet penale bashkëkohore por vendi i tij në këto legjislacione dallohet nga njëri në tjetrin, kështu që në legjislacionin penal të Maqedonisë lirimi me kusht është institut i pjesës së përgjithëshme të së drejtës penale, për dallim nga legjislacionet tjera në të cilat lirimi me kusht parashihet në kornizë të masave alternative.

Lirimi me kusht i personave të dënuar në sistemin penitenciar të Maqedonisë është një institut i rëndësishëm i cili ka për qëllim nxitjen dhe stimulim për pjesëmarrjen e të dënuarve në riedukim dhe risocializim ashtu që më herët dhe para mbajtjes së plotë të dënimit të del nga enti ndëshkues.³³ Ky institut është një lloj korrigjimi i vendimit gjyqësor në pjesën mbi dënimin, dhe ndihmon shumë në zbatimin konsekuent të individualizimit të dënimit.³⁴ Lirimi me kusht mund të vlerësohet nga aspekti juridiko – penal dhe penologjik. Elementet kryesore të lirimit me kusht përcaktohen në nenin 36 të Kodit Penal të Maqedonisë sipas të cilit personi i dënuar mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit me burg që të mos kryej vepër të re penale deri sa të kaloj koha për të cilën është shqiptuar dënimi,

³³Arnaudovski L.,Drakulevski A.G.,Penologija: nauka za izvrsuvanje na sankciite so izvrsno kazneno pravo na Republika Makedonija, Shkup 2013, fq 233.

³⁴Gashi R., Ekzekutimi i dënimit me burgim në Shqipëri, Prishtinë 2001, fq 361.

nëse është përmirësuar ashtu që thellësisht mund të pritët se në liri do të sillet mirë, e veçanërisht se nuk do të kryej vepra penale. Gjatë vlerësimit se a do të lirohet i dënuari me kusht, do të merret parasysh sjellja e tij gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, zbatimi i detyrave të punës duke pasur parasysh aftësinë e tij të punës dhe rrethanat e tjera që tregojn se është arritur qëllimi i ndëshkimit.³⁵ Sipas kësaj dispozite mund të konstatojm se personit të dënuar i jepet mundësia që para skadimit dënimit të lirohet me kusht nga enti ndëshkues-përmirësues nën kushtet e parapara me këtë dispozit. Përveç Kodit Penal, lirim me kusht e parasheh edhe Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve.

Gjatë definimit të nocionit të lirim me kusht egzistojn dallime të konsiderueshme të mendimeve nga autorë të ndryshëm, por të gjithë egzistojn pajtueshmëri për çështjet thelbësore të këtij instituti. Sipas disave lirim me kusht paraqet masë të posaçme kriminale-politike që ka për qëllim nxitjen e sjelljes së mirë të të dënuarit në burg. Sipas të tjerëve ai është institut me të cilin modifikohet dënimi me burg. Për disa të tjerë bëhet fjalë për institut penologjik që i përket fazës më të lartë në sistemin progresiv të vuajtjes së dënimit me burgim.

Të përmendim vetëm disa definicione të lirim me kusht, ku sipas kriminologut të njohur amerikan njëherit edhe njohës i mirë i sistemit penitensiar amerikan M.A. Elliot lirim me kusht përkufizohet si lirim me kusht i të dënuarit nga burg, apo enti edukues para se ta mbaj dënimin sipas rekomandimit të organit kompetent për lirim me kusht.

Ndërsa, sipas D-r. Toma Zhivanoviq lirim me kusht është masë kriminale-politike e nxitur si shkak për stimulimin për përmirësim të personit të dënuar. Për D-r. Janko Tahoviq lirim me kusht paraqet fazë të posaçme në ekzekutimin e

³⁵Osmani A., Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Shkup 2010, neni 36, alinea 1.

dënimit edhe atë në sistemin progresiv është faza e tretë, ndërsa sipas sistemit irlandez është faza e katërt. Kjo në thelbë është faza e posaçme e ekzekutimit të dënimit me heqje lirie dhe përbëhet nga ajo që personi i dënuar një pjesë të dënimit e vuan në liri në lirim me kusht. D-r. Nikolla Srzentiq thotë se lirim me kusht përbëhet nga ajo që personi që është në vuajtje të dënimit me heqje lirie lëshohet në liri para se ta vuaj dënimin, me kusht që gjatë rrjedhjes së kohës që i është shqiptuar dënimi të mos kryej vepër të re penale.³⁶

Për Lupço Arnaudovskin lirim me kusht është institut penologjik me bazë juridiko- penale që i mundëson personit të dënuar të lëshohet nga enti ndëshkues-përmirësues para skadimit të kohëzgjatjes së dënimit nëse janë plotësuar kushtet ligjore.³⁷ Derisa lirim me kusht nuk nënkupton ulje të dënimit ajo njëkohësisht do të thotë se nuk merret dhe nuk bën asnjë ndryshim të vendimit gjyqësor me të cilën është përcaktuar dënimi me burgim në rastin konkret. Lirim me kusht do të thotë ndryshim të kushteve nën të cilat personi i dënuar vuan pjesën e mbetur të dënimit që është e kushtëzuar. Ka edhe përkufizime të tjera të autorëve tjerë që kryesisht mbështeten në përkufizimet ligjore pozitive.³⁸

Mendimi ynë dhe mendimi i më tepër autorve në teorin dhe praktikën penale të Maqedonisë është se lirim me kusht nuk është as mëshirë, e as falje gjyqësore dhe administrative e personit të dënuar. Është e drejtë të thuhet se lirim me kusht ka karakter të një instituti të posaçëm , sepse egzistimi i tij është i regulluar me ligj, dhe ky institut më së shpeshti ballafaqohet me dënimin me burgim.

³⁶ Krstanovski M., Uslovniot otpust kako penoloski institut (studentski zbor), Shkup 1996, fq.25.

³⁷ Arnaudovski L., Penologija, Praven Fakultet Shkup 1988, fq 455.

³⁸ Gashi R., Lirim me kusht i personave të dënuar në legjislacionin dhe praktikën Kosovare, E drejta, Prishtinë, nr.2/2004, fq 40.

2.2. Nocioni i lirit me kusht

Nga definimet e paraqitura më lartë mund të vijm në përfundim se vetë nocioni i lirit me kusht përbëhet nga më shumë elemente të natyrës formale-juridike, materialo – juridike, dhe procedurale–juridike . Duke i pasur parasysh këto elemente mund t'a përcaktojm nocionin juridik të lirit me kusht si më poshtë :³⁹

- a) Lirimi me kusht është e drejt e personit të dënuar me dënim me heqje lirie që të kërkoj dhe të lëshohet nga vuajtja e dënimit me burgim para skadimit të dënimit që i është shqiptuar pasi të ketë mbajtur 1 vit, derisa është i dënuar me dënim me heqje lirie prej 3 vjetësh, pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit derisa është i dënuar me dënim me heqje lirie mbi 3 vjet, pas mbajtjes së 3/4 të dënimit derisa është recidivist, ose pas mbajtjes së 15 vjet të dënimit me heqje lirie derisa është i dënuar me dënim me heqje lirie me mbi 20 vjet.
- b) Gjyqi do ta lëshoj me kusht të dënuarin kur nga hetimet e kryera për sjelljen e të dënuarit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit mund të konstatoj se personi i dënuar nuk do të kryej vepër të re penale gjithashtu do të ketë parasysh edhe premtimin e të dënuarit se nuk do të kryej vepër të re penale.
- c) Në vendimin me të cilin gjyqi do të vendos për lirim me kusht të personit të dënuar, gjyqi mund të caktoj ose të specifikoj një ose më tepër masa për mbrojtje dhe ndihmë sociale derisa vlerëson se për një kohë të caktuar ato do të ndihmojnë që personi i dënuar të mos kryej vepër të re penale.
- d) Personi i dënuar që do ta shkel premtimin e dhënë se nuk do të kryej vepër të re penale për kohën dy herë më tepër nga periudha që është lëshuar para

³⁹ Krstanovski. M., Uslovnit otpust kako penoloski institut (studentski zbor), Shkup 1996, fq 35,36

kohe në liri, do të revokohet lirimi me kusht derisa ka kryer veprë të re penale për të cilën parashihet dënim me heqje lirie.

- e) Para matjes së dënimit me heqje lirie të veprës së re penale, gjyqi pjesën e mbetur nga dënimi i mëparshëm i dënimit me heqje lirie do ta llogarit si të vlefshme dhe do të caktoj që personi i dënuar ta vuaj edhe këtë pjesë të dënimit, panvarsishtë nga dënimi i veprës së re penale.
- f) Gjatë ekzekutimit të pjesës së mbetur nga dënimi personi i dënuar do të bartë shpenzimet e ekzekutimit të asaj pjese të dënimit.
- g) Kundër vendimit për lëshim të parakohëshëm nga vuajtja e dënimit ose refuzimit të kërkesës, palët në procedurë kanë të drejt ankese deri në gjykatën më të lartë sipas dispozitave për ankesë të vendimit.
- h) Me heqje lirie në kuptim të institutit të lirimit me kusht duhet kuptuar dënimi me burg, burgu për të mitur, dënimet dhe masat tjera sekondare , masat e sigurisë dhe masat edukuese të llojit të heqjes së lirisë.

Nga kjo kuptojmë, se personi i dënuar mund të lirohet me kusht nëse egziston baza e arsyeshme se ai nuk do të kryejë veprë tjetër penale si dhe konstatimi se sjelljet e tij, angazhimi në punë gjatë vuajtjes së dënimit është arritur qëllimi i riedukimit të tij me të cilin edhe është arritur efekti i dënimit pra, personi i dënuar lirohet me kusht që gjatë periudhës së kushtëzimit të mos kryej veprë tjetër penale. Lirimi me kusht është një institut bashkëkohor me rëndësi të madhe në lëmin penale, në politikën kriminale dhe në penologji. Është kështu nga shkaku se me anë të këtij instituti të dënuarit motivohen që më shpejt të përmirësohen dhe të aftësohen për jetë normale në liri dhe si i tillë shërben si nxitje dhe stimulim që të dënuarit të jenë më aktiv në trajtimin e risocializimit të tyre, jo vetëm në entin ndëshkues por edhe jashtë tij, dmth pas daljes në liri.

3. Kushtet për aplikimin e lirimit me kusht

Lirimi me kusht si institut i natyrës juridiko-penale, politiko-kriminale, kriminologjike e posaçërisht i natyrës penologjike, paraqitet si institut i panvarët por shpesh herë edhe i nvarët dhe i lidhur me institutet tjera e veçanarisht me dënimin me heqje lirie.

Për aplikimin e lirimit me kusht fillimisht është e nevojshme egzistimi i këtyre elementeve: *kryerësit të veprës penale, plotëfuqishmëria e vendimit të shqiptimit të dënimit me burgim, ekzekutimi i dënimit me burg në entin ndëshkues-përmirësues, mbajtja e pjesës së caktuar të dënimit, dhe arritja e rezultateve të caktuara për risocializim*. Megjithatë si për çdo institut edhe për këtë duhet të plotësohen kushtet e caktuara dhe në mënyr të caktuar. Deri te lirimi i personave të dënuar nga vuajtja e dënimit para skadimit të dënimit të shqiptuar me aktgjykim të caktuar gjyqësor arrihet në rast se, në mënyr precize plotësohen kushtet e parapara. Ato që janë përcaktuar në mënyr të qart nga ligdhënësi quhen kushte *formalo-juridike (objektive)* të cilat janë të lidhura me kohën e ekzekutimit të dënimit ndërsa, ato të tjerat quhen *matrialo-juridike (subjektive)* që i referohen sjelljeve personale të personit të dënuar. Është e rëndësishme se duhet që të dy kushtet të plotësohen në mënyr të plotë që të aplikohet ky institut.

Kriteret objektive janë një nga faktet që duhet të jenë të përmbushura nga personi i dënuar që të jetë i liruar me kusht.⁴⁰ Është e qartë se vetëm egzistimi i këtyre kriterëve nuk do të ishte e mjaftueshme për gjyqin që të miratoj vendim për lirim me kusht vetëm në bazë rekomandimeve dhe argumenteve të drejtorisë dhe personelit të burgut, kur paraprakisht nuk plotësohen kriteret *formale (objektive)*.

⁴⁰ Buzarovska G.L., Alternativi na zatvorot, Shkup 2003, fq 90.

Kriteret formale (objektive) janë : *kohëzgjatja e dënimit të shqiptuar me dënim me burg, pesha e veprës penale të kryer, kohëzgjatja e pjesës së mbajtur të dënimit dhe pjesës që duhet të mbahet.*

Në nenin 36 të Kodit Penal aktual të Maqedonisë janë potencuar kushtet formale (objektive) për lirin me kusht të personit të dënuar ku thuhet se : *me kusht mund të lirohet i dënuari i cili e ka mbajtur gjysmën e dënimit me burg. Në raste të veçanta me kusht mund të lirohet i dënuari që ka vuajtur 1/3 e dënimit me burg nëse rethanat e veçanta që i përkasin personalitetit të të dënuarit dukshëm tregojn se është arritur qëllimi i ndëshkimit.*⁴¹

Kushtet materiale-juridike (subjektive) të lirit me kusht janë të lidhura për personalitetit të të dënuarit, sjelljes dhe cilësive të personit të dënuar, sjelljet e tij derisa gjendet në entin ndëshkues-përmirësues, me parashikimet pozitive të sjelljeve të tij në pajtim me ligjin edhe pas lëshimit. Edhe këto kushte i hasim në dispozitat ligjore por jo në mënyrë të qartë dhe të detajuar si ato formalet (objektive). Nga këtu del se i dënuari mund të lirohet me kusht nëse gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit me burg është përmirësuar dhe prej tij pritet se edhe në liri do të sillet mirë, se nuk do të kryej përsëri vepra penale dhe se është risocializuar plotësisht. Mes tjerash duhet të merret parasysh edhe sjellja e të dënuarit gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, kryerja e obligimeve të punës duke pasur parasysh aftësitë e tij për punë, si dhe rethanat tjera që tregojn se është aritur qëllimi i dënimit.⁴²

Ajo çka është e rëndësishme për temën tonë nuk është sjellja kur i dënuari është atakuar me ligjin por është sjellja që ai ka treguar në mjedisin e burgut derisa ka vuajtur dënimin e shqiptuar. Kur personi i dënuar do të qëndroj në atë mjedis që është shumë më ndryshe nga mjedisi që ka qëndruar personi i dënuar para se të

⁴¹Osmani A., Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Shkup 2010, neni 36, alinea 2,3,4.

⁴²Arnaudovski L., Penologjia nauka za izvršivanje na krivičnite sankcii, Shkup 1998, fq 750.

kryej vepër penale, është patjetër që ai të krijoj një mënyr të re të sjelljes sepse atë e kërkon vetë ambienti i burgut që ai qëndron, mënyrën e jetesës në të, rregullat e rrepta që sundojn në ato ambiente të burgut. Në fakt që personi i dënuar ta meritoj atë që ne diskutojm apo të fitoj mundësin që të jetë i liruar me kusht, ai duhet me sjelljen e vet të tregoj se e ka merituar atë dhe se është i aftë për të jetuar në liri, se nuk është i dhunshëm ashtu si ka vepruar kur e ka kryer veprën penale. Ai me sjelljet e veta duhet të jetë shembullor dhe duhet që të lartësohet ndaj të burgosurve tjerë nga ana e shërbimit të burgut. Për t'a arritur këtë personi i dënuar patjetër duhet t'i kushtoj vëmendje sjelljeve dhe raporteve që krijon me rrethin e vetë ku gjendet duke u nisur nga personeli i burgut, nga të burgosurit tjerë, ndaj punës së vetë në burg, dhe shumë i rëndësishëm është raporti me të afërmit dhe familjen e tij që këto sjellje të tregojn se si mund të sillet me ta pas daljes nga enti. E gjithë kjo është që duhet ta respektoj nga momenti kur do të hynë në entin ndëshkues-përmirësues deri në ditën e daljes së tij në liri. Sigurisht se të nevojshme janë edhe shumë prova dhe fakte të rëndësishme që personi i dënuar pa dashjen e tij i'a ofron organit mbikëqyrës të burgut që të kontrolloj se i dënuari nuk kujdeset për këtë sjellje vetëm që të jetë para kohe i liruar nga vuajtja e dënimit, por nga analizat e kompletuara dhe nga disa supozime mjaft të forta mund të caktohet që personit të dënuar t'i jepet mundësia të kërkoj lirim me kusht. Këtu shihet qartë ndikimi i madh pozitiv që ka instituti i lirit me kusht në procesin e risocializimit dhe përmirësimit të personit të dënuar.

4. Arsyeshmëria e lirimit me kusht

Lirimi me kusht është një institucion i njohur dhe plotësisht i arsyeshëm i të drejtës penale. Tek i dënuari i cili me sjelljen e tij, angazhimin në punë, qëndrimin korrekt si ndaj të dënuarve, ashtu edhe ndaj stafit korrektues tregon shenja të mirëfillta se i dënuari e ka kuptuar peshën dhe rëndësinë e veprës. Mirëpo duke mos lënë anash edhe keqardhjen që i dënuari shfaq ndaj viktimës, kjo tregoni se ndaj tij ka shpresa të qarta se është arritur qëllimi përfundimtar i dënimit. Andaj është e rrugës që ndaj të dënuarve të tillë, shoqëria, shteti, duhet të kenë kujdes që qëndrimi i tillë në institucion edhe më tutje, është i dëmshëm dhe i paarsyeshëm. Pra, ata lirohen para kohe para se të mbajnë tërë dënimin e shqiptuar, me kusht që të sillen mirë dhe të mos përsëritin aktivitetin delikuent kriminal.⁴³

Lirimi me kusht ndikon pozitivisht te i dënuari sepse ai posa të dënohet e ka të qartë se nëse në të vërtetë do të përmirësohet, që atë duhet ta dëshmojë me angazhimin e tij, do të mund të lirohet para kohe. Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit nuk mund ta dijë saktësisht se kur personi i dënuar në rastin konkret do të jetë i gatshëm për t'u kthyer në liri, gjykata nuk mund ta dijë se me çfarë ritmi do të rrjedh procesi i risocializimit, andaj me të drejtë është vendosur se ekzekutimi i mëtejshëm i dënimit të shqyrtohet duke pasur parasysh ndryshimet që mund të kenë ndodhur në kryerësinë e veprës penale, në jetën e tij të brendshme dhe të jashtme.

Jeta e tij e brendshme – paraqet gjendjen e tij të brendshme psikike, pra të kuptuarit e tij për të kaluarën dhe pendimin për ato veprime. Kështu gjatë procesit të risocializimit me angazhimin e të gjithëve me një punë dhe angazhim të përkushtuar dhe të gjithmbarshëm, tani në brendin e tij shohin një person stabil të ekuilibruar dhe të sjellshëm.

⁴³ Halili R., Penologjia (E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale), Prishtinë 2010, fq 229.

Jeta e tij e jashtme – paraqet një tjetër personalitet që me sjelljen e tij në institucion duke paraqitur shenja pozitive dhe qasje të denjë në respektimin e rregullave, ku me punë dhe angazhim të mirëfilltë i qaset jetës duke e dëshmuar të tashmen krejt ndryshe nga e kaluara e tij kriminale.

Një numër i madh i të burgosurve pas dënimeve që marin në psiqikën e tyre kanë ndjenj të urrejtjes për organet shtetërore në përgjithësi. Mirëpo gjatë mbajtjes së dënimit shumë prej tyre i kuptojn se veprimet e tyre dhe bindjet e tyre kanë qenë të gabuara. Këta persona nëse lirohen para kohe , këtë e vlerësojn shumë lartë dhe e marin si një shenjë se shoqëria, shteti, janë duke u përkujdesur për të mirën e tyre. Ata tani e ndjejnë si obligim që besimi që u është dhënë duhet ta respektojn dhe në shumicën e rasteve sot kjo edhe ndodhë.

Të arsyeshëm lirimin me kusht e bën fakti se nga kjo, gjegjësisht një i dënuar i cili lirohet me kusht sjell të mira të shumanëshme, qoftë tek i dënuari, qoftë ajo që në familjen e tij pritet një lehtësim i madh sepse në shumicën e rasteve familjet janë të varura nga po ky i dënuar. Nuk duhet lënë anash edhe faktin se me lirim me kusht përfiton, qoftë institucioni, ashtu edhe shteti në përgjithësi. Dihet qart se sa e kushtueshme është kostoja që shteti ka me qëndrimin e tij të mëtutjeshëm në institucion, andaj në interesin e shoqërisë dhe të individit dhe përfitimin nga kjo e bën të arsyeshëm lirimin e tij të parakohshëm. Lirimi me kusht ofron një imazh njerëzor të shoqërisë.

Arsyeshmëria e liritimit me kusht mbështetet edhe në faktin se gjykata nuk ka mundësi që me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim të dijë saktësisht se çfarë kohëzgjatje e privimit nga liria do të nevojitet për përmirësimin e kryerësit të veprës penale. Në fund, lirimi me kusht shërben edhe si masë për shkurtimin e dënimeve veçanarisht të gjata të dënimit me burgim dhe njëherit shërben edhe për kufizimin

e ndikimit të dëmshëm të dënimit me privim nga liria me afatë të gjatë si ndaj të dënuarit, edhe ndaj familjes së tij dhe pozitës së tij sociale.

Arsyeshmëria e aplikimit të liritimit me kusht konsiston edhe në faktin se ky institut në instancën e fundit shërben edhe si masë e mbrojtjes së shoqëris nga kryerja e sërishme e veprave penale, ngase në praktik është konstatuar se personat të cilët janë liruar me kusht kryejnë më rall sërish vepra penale, në karahasim me personat të cilët e kanë mbajtur dënimin gjer në fund.⁴⁴

Mirëpo, çdo herë duhet shikuar edhe anën e kundërt të medaljes sepse ndodhë dhe e cila është evidente se nga lirimi i mëhershëm, për rethin ka një ndjenj të keqe, ndoshta pse vepra është si e tillë por edhe afati për të cilën ka kaluar në vuajtje është mjaft i shkurtër dhe si i tillë mund ta godasë viktimën dhe rethin e tij.

⁴⁴ Saliu I., E drejta penale (pjesa e përgjithshme), Prishtinë 2012, fq 538

5. Raporti i lirit me kusht me institutet e ngjashme me të

Raporti i lirit me kusht me institutet e ngjashme me të e ka tërhequr vëmendjen në teorinë e shkencave juridike në përgjithësi nga ajo se bëhet krahasimi i instituteve njëri me tjetrin, ngjashmërit dhe dallimet e njërit me tjetrin. Kjo nuk është aq e çuditëshme dhe e pakuptueshme duke pasur parasysh faktin se shumë institute në drejtësi, në ndonjë mënyrë janë të lidhura njëri me tjetrin ose shumë shpesh njëri rrjedh prej tjetrit. Edhe pse, sa do që të jenë të ngjashme njëri me tjetrin nuk do të egzistonin si të ndarë nëse nuk do të ishin në mënyrë të konsiderueshme të ndryshëm, edhe pse secili prej tyre nuk ka karakteristika që esencialisht do të ishin vetëm për atë dhe do t'a bënin si të veçant dhe unik. Në këtë krahasim nuk përfshihet instituti për të cilin bëjmë fjalë – lirimi me kusht.

Institutet që veçanarisht lidhen me lirim me kusht janë : *dënimi me kusht dhe vërejtja gjyqësore*. Në të vërtetë këtu bëhet fjalë për masa alternative të parashikuara në teorinë dhe legjislaturën tonë, këta të dy institutet e lartpërmendura kanë ngjashmëri terminologjike. Shqyrtimi i këtyre instituteve në lidhshmëri të afërt me lirim me kusht imponojnë nevojën e krijimit të një relacioni ndërmjet tyre dhe përcaktimin e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet tyre. Pikërisht në bazë të kësaj është vendosur nevoja për t'u parë dallimet dhe ngjashmërit e tyre, të përcaktohet natyra e tyre, dhe në bazë të kësaj të përcaktohet vendi i tyre, përkatësisht kontributi në realizimin e qëllimit të dënimit me burgim.

Edhe vetë ligjdhënësi në *nenin 48 të Kodit Penal* të Maqedonisë e paraqet shkakun dhe qëllimin kryesor të këtyre masave alternative që janë të lidhur me lirim me kusht ku thuhet se : *qëllimi i masave alternative është që ndaj kryerësit me përgjegjësi penale të mos zbatohet dënim për vepra më të vogla kur ajo nuk është e domosdoshme për shkak të mbrojtjes penale – juridike dhe kur mund të*

pritet se qëllimi i ndëshkimit mund të realizohet me paralajmërim, me kërcënim për dënim (lirim me kusht), vetëm me paralajmërim (vërejtje gjyqësore) ose me masa të ndihmës dhe mbikëqyrjes së sjelljes të kryerësit në liri.⁴⁵

Këtu në thelbë bëhet fjalë për masa me përpjekje të kundërta nga ajo përpjekje që është e pranueshëm te dënimi : realizimi i qëllimit të dënimit pa mos u merakosur për çfardo të keqe të kryerësit.⁴⁶

Dënimi me kusht sipas Kodit Penal të Maqedonisë paraqitet si masë alternative ku gjyqi e shqipton ndaj kryerësit të veprës penale krahas dënimit me burg në kohëzgjatje deri 2 vjet ose dënimit me të holla dhe njëkohësisht përcakton se dënimi nuk do të kryhet nëse kryerësi për kohën të cilën do ta caktoj gjyqi e cila nuk mund të jetë më e shkurt se 1 vjet ose me e gjatë se 5 vjet (koha e kontrollit) nuk kryen vepër të re penale. Përveç kësaj gjyqi mund të përcaktoj edhe obligimin e të dënuarit në afat të caktuar t'a kthej të mirën pasurore të fituar me vepër penale, ta kompenzoj dëmin që ka nxitur me vepër penale ose të kryej obligime tjera të përcaktuar me dispozita penalo – juridike.⁴⁷

Revokimi i dënimit me kusht do të thot - kërcënimi me dënim të kthehet në dënim efektiv, gjegjësisht dënimi i caktuar të shqiptohet dhe të realizohet. Dënimi me kusht tërhiqet gjithmonë kur në kohën e kontrollit i dënuari me kusht kryen një ose më shumë vepra penale për të cilat gjyqi i ka shqiptuar dënim me burg deri 2 vjet ose më gjatë. Nëse i dënuari me kusht në kohën e kontrollit kryen një ose më shumë vepra penale për të cilat i është shqiptuar dënimi me burg më pak se 2 vjet ose dënim me të holla, dënimi me kusht mund të revokohet më së voni në afat prej

⁴⁵ Osmani A., Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Shkup 2010, neni 48.

⁴⁶ Marjonoviq Gj., Krivicno pravo opst del, Shkup 1988, fq 427.

⁴⁷ Osmani A., Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Shkup 2010, neni 49.

1 viti nga dita e skadimit të kontrollit ose ta kompenzoj dëmin e nxitur me veprë penale.

Evidente janë ngjashmërit e dënimit me kusht dhe lirimit me kusht. Këto institute kanë më shumë ngjashmëri se sa dallime. Si ngjashmëri e parë dhe themelore është se te të dy institutet dënimi ndaj kryerësit zbatohet edhe jashtë institucionit dhe arrihet qëllimi i njejt i dënimit me burg. Ngjashmëria tjetër ndërmjet këtyre dy institutive qëndron në atë se të dy aplikohen ndaj kryerësit fajtor të veprës penale. Poashtu ngjashmëria ndërmjet këtyre instituteve është se personi i dënuar lirohet nga mbajtja e dënimit. Midis këtyre institutive egzistojn edhe dallime. Këto dallime shihen në faktin se te dënimi me kusht kryerësi i veprës penale nuk dërgohet në mbajtjen e dënimit por lihet në liri, pra lirimi nga dënimi te dënimi me kusht është i plotë. Ndërsa te lirimi me kusht kryerësi i veprës penale gjendet në vuajtjen e dënimit dhe lëshohet në liri pasi të mbaj një pjesë të dënimit me burg. Dallimi i dytë qëndron në atë se dënimi me kusht mund të aplikohet vetëm për lloj të caktuar të veprave penale që kohëzgjatja e dënimit është e caktuar, kurse dispozitat për lirimin me kusht kanë aplikim gjeneral veprojn ndaj të gjithë kryerësve të veprave penale me përjashtim të atyre që janë dënuar me burgim të përjetshëm dhe nuk kanë mundësi për ta shfrytëzuar institutin e lirimit me kusht derisa nuk i mbajn 15 vjet nga dënimi me burg.

Mas tjetër alternative që e parashikon legjislacioni ynë dhe që është e ngjashme me lirimin me kusht dhe mjaft e zbatuar me të është **vërejtja gjyqësore**.

Qëllimi është i njejtë si te dënimi me kusht që ndaj kryerësit të veprës penale të mos zbatohet dënimi kur ai nuk është i domosdoshëm dhe kur pritet se edhe vetëm me paralajmërim dukshëm do të ndikoj ndaj kryerësit që të mos kryej veprë

penale.⁴⁸ Sipas **nenit 59** të kodit penal vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për veprat penale për të cilat është caktuar burgim deri në 1 vit ose ndëshkim me gjobë, që janë kryer në rethana të tilla lehtësuese të cilat i bëjnë veçanarisht të lehta. Gjatë marrjes së vendimit se a do të shqiptoj vërejtje gjyqësore gjykata, duke mbajtur llogarit për qëllimin e vërejtjes gjyqësore posaçërisht do ta marr parasysh personalitetin e kryerësit, jetën e tij të mëparëshme, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rethanat të tjera në të cilat është kryer vepra.⁴⁹

Ngjashmërit e këtyre institutive qëndrojnë në atë se të dyja sillen në formë të vendimit dhe për qëllimin e njejtë që të eliminohet në ndonjë mënyrë dënimi me burgim për kryerësin fajtor, edhe atë të lirimi me kusht besohet se ai e ka arritur deri në atë masë të përmirësimit sa që nuk është e arsyeshme që mëtutje të mbaj dënimin me burg, kurse të vërejtja gjyqësore as nuk supozohet në asnjë mënyrë se kryerësi shkon në atë drejtim për t'u bërë kriminel, por vepra penale e kryer nga ai është rastësi në jetën e tij dhe nuk ka nevojë për një kërcënim me dënim e që më tepër me burg efektiv. Si institut juridiko – penal dhe kriminalo – politike të dy institutet fuqishëm mbështesin individualizimin e dënimit ndaj çdonjërit kryerës konkret të veprës penale. Përveç ngjashmërive dhe dallimeve të lartpërmendura të lirimit me kusht me institutet tjera në këtë lëmi, prap se prap është fakt se ai qëndron si i veçantë dhe me rëndësi të madhe në kornizat e të drejtës penale. Ngjashmërit ndërmjet tyre janë shprehje e rëndësisë së madhe që të menjahet dënimi me burg kur i njejtë nuk është i domosdoshëm të zbatohet, kur mendohet se qëllimi i njejtë mund të arrihet edhe nëpërmjet këtyre instituteve ose në ndonjë mënyrë tjetër ku legjislacioni ynë i parasheh si masa alternative.

⁴⁸ Marjonoviq Gj., Krivico pravo opst del, Shkup 1988, fq 445.

⁴⁹ Osmani A., Kodi Penal I Republikës së Maqedonisë – teksti integral, I përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Shkup 2010, neni 59.

6. Procedura e paraqitjes së kërkesës dhe vendimi për dhënien e lirit me kusht

Që nga fillimi i ekzekutimit të dënimit gjendja dhe pozita e kryerësve të veprave penale edhe më tepër përkeqësohej për nga mënyra e ekzekutimit të dënimit. Në atë kohë sistemi i rreptë i ekzekutimit të sanksioneve penale ka aplikuar një politikë ndryshe nga sot, qëllimi i ekzekutimit të sanksioneve penale ka qenë hakmarja ndaj kryerësit. Më vonë me ndryshimet dhe plotësimet që i pësoi sistemi i ekzekutimit të sanksioneve penale në kuptimin dhe qëllimin e dënimit filluan të modernizohen dhe gjithmonë insistonin në risocializimin e personit të dënuar e jo në hakmarjen ndaj tij apo degradimin e tij, duke vepruar me qëllimin e përmirësimit të personit të dënuar. Modernizimi i sistemit juridik dhe sistemit të ekzekutimit të dënimit me burg jepë mundësinë e zgjedhjes së mënyrës sa më të përshtatshme me të vetmin qëllim që personi i dënuar sa më lehtë të riedukohet dhe njëkohësisht t'i pëtshtatet jetës që e pret pasi të del nga enti ndëshkues-përmirësues, kjo na mundëson të kuptojmë se personi i dënuar duhet të jetë sa më afër jetës në liri, të ketë një komunikim permanent me botën e jashtme për të pasur inkuadrim sa më të lehtë në shoqëri. Edhe Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve në Maqedoni në **nenin 193** e parasheh mënyrën dhe procedurën për përgaditjen e personit të dënuar për të qenë i liruar nga enti ndëshkues – përmirësues pas një riedukimi gradual.⁵⁰ Normalizimi i jetës së të burgosurve në entet ndëshkimore – përmirësuese nuk do të thotë se kushtet e jetës në burg të jenë të barabarta me jetën jashtë burgut por mos ketë dallime drastike mes kushteve në entin ndëshkues – përmirësues dhe atyre të shoqërisë së lirë.

⁵⁰ Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale (Gazeta zyrtare e RM-së nr.2/2006, 57/2010, 170/2013)

Si të gjitha sistemet penale bashkëkohore edhe sistemi ynë pranon iden se me personin e dënuar që nga fillimi i dënimit duhet të punohet seriozisht nga ana e personelit të entit me qëllim që të përgaditet për lirim me kusht, duke u nisur nga idea se secilit të burgosurit duhet ti jepet mundësia t'a shfrytëzoj lirin me kusht. Sigurisht se gjatë procesit të përgaditjes njëkohësisht mblidhen dhe informata rreth të burgosurit dhe sjelljes së tij, duke e provuar se a i ka plotësuar kushtet *matriale* (*subjektive*) për shfrytëzimin e institutit të lirit me kusht. Në këtë fazë të procedurës së përgaditjes bëjnë pjesë këshillimet për mos përsëritjen e veprës penale, pasojat nga kryerja e veprave tjera penale, dalja e personit të dënuar nga enti ndëshkimor – përmirësues me qëllim të gjetjes së punës dhe strehimit, edhe investigimi i raportit të tij me rrethin e tij të ngusht duke e menduar në rend të parë familjen. Analiza e këtyre aspekteve është thelbi për dhënjen e lirit me kusht, sepse rrethi i ngusht dhe i gjërë i personit të dënuar mund të jenë faktor stabiliteti për personin e dënuar por mund të jenë edhe faktor kriminogjen. Siç treguam se faza e përgaditjes së personit të dënuar para lirit nga burgimi është fazë e domosdoshme dhe fazë që i paraprin edhe aplikimit të institutit të lirit me kusht, megjithëatë ajo që është me rëndësi të madhe për ne dhe është relevante që ta sqarojmë procedurën për paraqitjen e kërkesës për lirim me kusht që ka vend të merituar në të drejtën penale tek ne. Duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve do t'i theksojmë të gjitha faktet relevante në procedurë duke filluar nga ajo se kush ka të drejtë të paraqes kërkesën për lirim me kusht, kush e fillon procedurën, në cilën formë paraqitet kërkesa, dhe në fund kush është kompetent për të sjell vendimin për lirim të parakohshëm të personit të dënuar nga enti ndëshkimor – përmirësues dhe forma e vendimit. Lirimi me kusht te ne është i rregulluar me Kodin Penal të RM-së.⁵¹

⁵¹ Shih, nenin 36 të Kodit Penal të RM-së

Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të reja e regullon fazën e paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht e cila fillon me paraqitjen e **kërkesës** nga njëri prej subjekteve të procedurës të autorizuar sipas ligjit :⁵²

(1). *Lutje për lëshim në bazë të lirit me kusht në kushtet e përcaktuara me ligj, mund të paraqes personi i dënuar ose bashkshorti/-ja, i saj/ e tij, familjari nga gjinia e gjakut në vijë të parë, adoptuesi, i adoptuari, vëllai, motra dhe mbajtësi.*

(2). *Propozim për lëshimin e personit të dënuar në bazë të lirit me kusht, mund të paraqes edhe drejtori i institucionit.*

Nga dispozitat e nenit të lartpërmendur qartë përcaktohet se kush mund të paraqes kërkesën për lirim me kusht të personit të dënuar, gjithashtu hasim dy terme të ndryshme të kërkesës për lirim me kusht. Në fakt, në alinen e parë kërkesa cilësohet **si lutje**, ndërsa te aline e dytë që e paraqet drejtori i institucionit cilësohet **si propozim**. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për dallim terminologjik por egziston dallim thelbësor ndërmjet tyre. Dallimi ndërmjet tyre qëndron se subjektet nga alinea (1) ligji i vendos në rolin e lutësit që mund të kërkojn lirim me kusht të personit të dënuar nëse eventualisht janë plotësuar kushtet për lirim me kusht, ndërsa drejtori i institucionit duke u bazuar në fakte dhe argumente të sigurta dhe duke pasur një pasqyr më të qartë për jetën dhe sjelljen e të dënuarit brenda institucionit, pran organit kompetent paraqet aktin e propozimit si pjesë e procesit të risocializimit të të dënuarit për dhënien e lirit me kusht të të dënuarit në rastin konkret. Gjithashtu kërkesë në emër të të dënuarit mund të paraqes edhe mbrojtësi i tij i autorizuar paraprakisht.

⁵² Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale (Gazeta zyrtare e RM-së nr.2/2006, 57/2010, 170/2013),neni 200.

Subjektet e caktuar që kanë të drejt të paraqesin kërkes për lirim me kusht për të dënuarin e caktuar në këtë fazë të rëndësishme të kësaj procedure e bëjnë të qartë rëndësin dhe ndjeshmërin e këtij instituti.

Kërkesa dhe propozimi për lirim me kusht praqiten para gjykatës që e ka miratuar aktgjykimin në shkallë të parë. Gjyqi kompetent që e ka bërë matjen e dënimit para vendimmarrjes për lirim me kusht ndaj të dënuarit konkret, kërkon të dhëna për personin e dënuar nga institucioni ku e vuan dënimin. Institucioni është i obliguar të paraqes raport në të cilin përveç të dhënave të përgjithëshme nga vepra penale e kryer dhe nga shqiptimi i dënimit do të përmbaj edhe rrethanat që kanë të bëjnë me personalitetin e të dënuarit që janë vërejtur në burg, të gjitha aspektet në raport me sjelljen dhe disiplinimin e të dënuarit, a i është shqiptuar ndonjë mas dënimore dhe për çfarë, do të përmbaj edhe të dhëna mbi kryerjen me ndërgjegjshmëri të obligimeve të punës që i janë imponuar, a ka mësuar në ndonjë shkollë apo zanat, të dhëna mbi zbatimin e tretmanit të dënimit në burg, bashkëpunimi me personelin profesional të burgut, për rrethanat nga të cilat mund të përfundohet nëse është arritur qëllimi i dënimit e veçanarisht nëse personi i dënuar në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, etj. Pas potencimit të të gjitha rrethanave që mendohet se do t'i ndihmonin gjyqit para miratimit të vendimit përfundimtar se a do të lirohet me kusht ose jo, mund të merret në pyetje edhe i dënuari. Përkundër kërkesës, propozimit të drejtorit të institucionit bashkangjitur edhe mendimin, gjykatësi mund ta sheh të arsyeshme të dëgjoj ndonjë nga personat zyrtar të institucionit që e ka përpiluar raportin për ndonjë rrethan që është potencuar në raport.⁵³ Propozim për lëshim në bazë të lirit me kusht mund të paraqes edhe drejtori i entit.

⁵³Buzharovska G.L., Alternativi za zatvorot, Shkup 2003, fq 324.

Në rast kur është paraqitur propozimi nga drejtori i entit atë e përfaqëson dhe e arsyeton përfaqësuesi i institucionit në të cilin personi i dënuar vuan dënimin.⁵⁴ Mendoj se është e logjikshme se një vendim i këtij lloji do të ishte i drejt sepse gjyqi që e ka miratuar vendimin për veprën penale të kryer nga personi i dënuar, është i njohur mirë me personalitetin e të dënuarit dhe mënyrën e të menduarit të tij dhe nuk bazohet vetëm në të dhënat nga enti ndëshkimor. Gjithashtu mendoj se gjyqi është matës më i mirë për të sjell një vendim të drejt që një person të jetë i liruar parakohe nga enti ndëshkimor – përmirësues në bazë të liritimit me kusht për shkak se ai ka propabilitet më të madh për një vlerësim të drejt për sjelljet e mundëshme të personit të dënuarit që në të ardhmen nuk do të kryej vepër penale. Gjyqi për lëshimin me kusht të personit të dënuar vendos në shkallë të parë në këshill të përbër prej tre (3) gjyqtarve të cilët vendosin jashtë shqyrtimit kryesor, puna e këshillit është publike dhe e vërtetuar me ligjë. Karakteristik specifike e vendimit gjyqësor për lirim me kusht të personit të dënuar është se ky vendimi miratohet në formë të aktvendimit. Ky aktvendim nëse është pozitiv i dorëzohet personit të dënuar, anëtarve të familjes që kanë paraqitur kërkesën për lirim me kusht të familjarit të tyre, entit ndëshkues ku personi i dënuar e ka vuajtur dënimin, Prokurorisë Publike kompetente, njësis rajonale të Ministris së Punëve të Brendshme dhe Qendrës për Punë Sociale sipas vendbanimit dhe vendqëndrimit të personit të dënuar. Lutja përkatësisht propozimi për lirim me kusht mund të paraqitet sërish pas kalimit të 6 muajve për dënim me burg mbi 1 vit, përkatësisht 3 muajve për dënimin me burg nën 1 vit nga plotfuqishmëria e aktvendimit me të cilin është refuzuar lutja paraprake e personit të dënuar përkatësisht propozimi i drejtorit.⁵⁵

⁵⁴ Shih nenin 202 alinea 2, Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale të RM-së.

⁵⁵ Ibid, neni 203.

Duhet theksuar se parashtrimi i lutjes ose kërkesës është i kufizuar dhe personat e dënuar jo çdo herë mund të parashtrojnë kërkesë për shfrytëzimin e këtij instituti. Por procedura e lirimimit me kusht nuk përfundon këtu ngase me aktvendim të gjyqit me të cilin përcaktohet lirimi me kusht mundet që personit të liruar me kusht, t'i përcaktohet edhe mbikëqyrje mbrojtëse, e cila përbëhet nga disa masa të veçanta si : masa për ndihmë, për përkujdesje, mbikëqyrje ose mbrojtje që e zbaton organi social, etj. Palët të cilët janë të pakënaqura me aktvendimin e gjyqit për lirim me kusht, që mund të jetë personi i dënuar dhe Prokurori Publik kanë të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh deri tek gjykata më e lartë.⁵⁶

Përveç gjyqit si organ kompetent për institutin e lirimimit me kusht poashtu organ tjetër kompetent për lirim me kusht është edhe drejtori i institucionit ndëshkimor – korrektues, ku me këtë ligj janë përcaktuar kushtet kur drejtori mund t'i jep lirim me kusht personit të dënuar, nëse personi i dënuar: ***ka vuajtur së paku 3/4 e dënimit me burgim, edhe atë deri 30 ditë për dënim me burgim deri në 1 vit, deri më 90 ditë për dënim me burgim deri në 5 vite dhe deri 120 ditë për dënimin me burgim mbi 5 vite.*** Drejtori i drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve me akt të përgjithshëm përcakton kriteret për lirim e parakohshëm të personit të dënuar para skadimit të dënimit.⁵⁷ Kjo mundësi në asnjë mënyrë nuk mund të identifikohet me aktvendimin për lirim me kusht që është kompetent gjyqi në shkallë të parë. Kjo me të drejt mund të konsiderohet si një lloj shpërblimi që i mundësohet drejtorit të institucionit ndëshkimor që t'u jep personave të caktuar për shkak të sjelljes së tyre pozitive, respektivisht mund të jetë si një lloj lehtësime në suaza të lehtësimeve që mund t'u jepen personave të dënuar.

⁵⁶ Ibid , neni 205.

⁵⁷ Ibid , neni 206.

Precesi i risocializimit nuk përfundon me vuajtjen e dënimit nga ana e personit të dënuar, por mes të tjerash ai përfshin edhe masat që i ndërmerr institucioni pasi që personi i dënuar të vuan dënimin që do të thotë, ndihmën që mund t'ia jep pasi të del në liri. Kjo ndihmë në penologji njihet si ndima postpenale apo ndihma pas lirit të personit të dënuar e cila ndihmë përmban tërësi të masave dhe procedurave që zbatohen për përfshirjen e personave të dënuar të lëshuar në jetën e lirë, që përbëhet nga: sigurimi i vendosjes dhe ushqimit, sigurimi i mjekimit, këshilla për zgjedhjen e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin, harmonizimi i mardhënieve familjare, punësimi , plotësimi i aftësisë profesionale, ofrimi i ndihmës me para për mbulimin e nevojave më të domosdoshme, si dhe forma të tjera të ndihmës dhe përkrahjes që personi i dënuar t'i përshtatet jetës në liri.⁵⁸

⁵⁸ Ibid , neni 207

7. Revokimi i lirimit me kusht

Derisa lirimi me kusht nënkupton lirimin e personit të dënuar nga vuajtja e dënimit me burgim para mbajtjes së plotë të dënimit nën kushtet që vlejn deri në skadimin e afatit të dënimit të shqiptuar. Personi i dënuar i cili lirohet me kusht, është i obliguar të manifestoj sjellje të mira gjatë kohës në liri. Nëse i dënuari gjatë kohës së lirimit me kusht nuk u përmbahet obligimeve të caktuara ose kryen ndonjë veprë penale të re, lirimi me kusht mund të revokohet. Për revokimin e lirimit me kusht vendos gjykata pothuajse në të gjitha shtetet, mirëpo në disa shtete tjera, për këtë vendosin edhe institucionet korrektuese nga të cilat ai person është liruar me kusht.⁵⁹ Revokimi i lirimit me kusht konsiderohet si pasojë e mos përmbushjes së kushteve të përcaktuara me ligj që i mundësojnë personit të dënuar t'a arrijë lirimin me kusht. Revokimi i lirimit me kusht është një institucion shumë i rëndësishëm i të Drejtës Penale. Ky institucion ndikon shumë pozitivisht te personi i liruar, duke e shtyrë atë që të jetë më i kujdesëshëm dhe më i matur në veprimet e tij.

Sipas Kodit Penal të RM-së gjyqi mund të revokoj lirimin me kusht si më poshtë :⁶⁰

- (1) Gjyqi do ta revokoj lirimin me kusht nëse i dënuari derisa është në lirim me kusht kryen një ose më tepër vepra penale për të cilat i është shqiptuar burgim ose burgim për të mitur mbi 2 vjet.*
- (2) Gjyqi mund ta revokoj lirimin me kusht nëse i liruari me kusht kryen një apo më tepër vepra penale për të cilat është shqiptuar dënim me burgim apo burgimin për të mitur deri në 2 vjet, ose nëse pas dy*

⁵⁹ Ukaj B., Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë 2006, fq.318

⁶⁰ Shih nenin 37, të Kodit Penal të RM-së

vërejtjeve me shkrim nga ana e organit kompetentë nuk i plotëson obligimet e mbikqyrjes mbrojtëse (neni 36 p.5). Gjatë vlerësimit se a do ta revokojë lirimin me kusht , gjykata veçanarishtë do ta marrë parasysh ngjashmërinë e veprave të kryera penale, rëndësinë e tyre, motivet nga të cilat janë kryer dhe rrethat e tjera që tregojn arsyeshmërinë e revokimit të lirimit me kusht.

Nga dispozitat e lartëcituarra të këtij neni kuptojm se kur organi kompetent ose në këtë rast gjyqi është i obliguar ta revokoj lirimin me kusht dhe kur ai mund të vlerësoj se a do ta revokoj ose jo lirimin me kusht. Sipas **pikës (1)** të këtij neni gjyqi është i obliguar ta revokoj lirimin me kusht dhe nuk ka mundësi që të vlerësoj vetë mbi besimin që i është dhënë personit të dënuar për tu liruar me kusht, sepse dispozitat ligjore e urdhërojnë të veprojnë sipas tyre. Në këtë rast kemi të bëjm me **revokimin obligativ**.

Ndërsa në **pikën (2)** të këtij neni bëhet fjalë për një mundësi fakultative e gjyqit për ta revokuar lirimin e dhënë me kusht. Që të vij deri te **revokimi fakultativ** i lirimit me kusht personi i dënuar duhet të mos i ketë respektuar kushtet nën të cilat ka qenë i liruar me lirim me kusht, ai duhet të kryej vepër penale për të cilën i është shqiptuar dënimi me burg ose burg për të mitur deri 2 vjet dhe pas dy vërejtjeve me shkrim nga ana e organit kompetent (gjykatës) nese kryerësi nuk i plotëson kushtet e mbikqyrjes mbrojtëse.

Në rastin e revokimit fakultativ gjyqi do ta marr parasysh afërsinë e veprave të kryera, rëndësinë e tyre, ndjenjat ose motivet nga të cilat është kryer dhe rrethat e tjera që tregojnë arsyeshmërinë e revokimit të lirimit me kusht. Nëse i dënuari u përmbahet kushteve dhe lirimi me kusht nuk revokohet, llogaritet se dënimin e ka mbajtur deri në fund. Kur lirimi me kusht revokohet të dënuarit i shqiptohet dënimi i vetëm sipas rregullave të bashkimit e parashikuar në *nenin 44 dhe 46 p.2 të Kodit*

penal të RM-së, ku dënimi i shqiptuar më herët merret si i vërtetuar. Më pas pjesa e mbajtur e dënimit llogaritet në dënimin e ri të vetëm, kurse koha e kaluar në lirimin me kusht nuk llogaritet sipas *nenit 37 p.3 të Kodit penal*. Dispozitat për revokim të lirimit me kusht zbatohen edhe i liruari me kusht gjatë kohës së lirimit me kusht gjykohet për vepër penale që e ka kryer para se të lirohet me kusht e parapar në *nenin 37 p.4 të Kodit penal* që dotë thotë, nëse për atë vepër është shqiptuar dënim me burg mbi dy vjet, lirimi me kusht revokohet. Kur në rastin e revokimit fakultativ gjyqi do t'i shqiptoj të dënuarit dënim për veprën e re dhe nuk e revokon lirimin me kusht, lirimi me kusht vazhdohet për kohën që do ta kaloj në vuajtjen e dënimit të posashqiptuar me burg , gjegjësisht burg për të mitur sipas *nenit 37 p.5 të Kodit penal*.⁶¹

Në këtë lloj të revokimit gjyqit i jepet mundësia të vendos vet se a do duhet personit të dënuar ti revokohet lirimi me kusht ose do të vazhdoj që pjesën e mbetur të dënimit ta mbaj në liri.

⁶¹ Kambovski V.,E drejta penale- pjesa e përgjithshme, Shkup 2007, fq 484

Kapitulli III

1. Analiz komparative e lirit me kusht në Kodin Penal të Maqedonisë dhe në disa Kode Penale të Rajonit

Edhe në legjislacionin e Maqedonisë si në të gjitha legjislacionet bashkëkohore është parapar instituti i lirit me kusht. Sipas dispozitave themelore të Kodit Penal tek ne ky institut është parapa si institut juridiko-penal ndërsa Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve i RM-së e parasheh si institut penologjik.

Ashtu siç e cekëm se lirimi me kusht si institut juridiko-penal dhe penologjik është i paraparë në KP të RM-së në kreun për dënime në nenin 36 paraqitet *si mundësi që i dënuari që ka vuajtur gjysmën e dënimit në raste të veçanta edhe ai i cili ka vuajtur 1/3 e këtij dënimi, mund të lirohet nga vuajtja e pjesës së mbetur të dënimit me kusht, dhe të mos kryej vepra penale të reja*. Megjithatë ajo që e bënë të rëndësishëm këtë institut është sjellja e të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit. Në fakt nga sjellja e tij duhet të rezultoj se i dënuari është përmirësuar ashtu që thellësisht mund të pritët se në liri do të sillët mirë e veçanërisht se nuk do të kryej vepra penale, gjithashtu tregohet se është arritur qëllimi i dënimit. Në fakt i dënuari duke e ditur se nëse kryen vepër të re penale përsëri do të kthehet në mjedisin nga i cili u lirua me kusht, atëher ai më lehtë do të përmbahet nga sjelljet e tij të kundërligjshme dhe do të mundohet të bëhet anëtar i dobishëm për shoqërinë. Ajo që dua ta them është se lirimi me kusht i definuar në këtë mënyrë dhe kështu i pranuar dhe i aplikuar në praktik paraqet rrugë të suksesëshme drejt risocializimit të kryerësit të veprës penale. Dhe njëkohësisht me këtë institut sigurohet edhe një lloj paqeje në entet ndëshkuese me sjelljet shembullore të personave të dënuar.

Kodi Penal përmban vetëm dispozita themelore për institutin e lirit me kusht që do të thotë se e bënë përcaktimin bazik të këtij termi dhe e përcakton se për çfarë dënimesh lidhet ky institut. Kur bëhet fjalë për këtë duhet të theksohet se Kodi Penal lirim me kusht e lidh *me dënimin me burg, dënimin me burg për të mitur, masat e siguris dhe mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucionin shëndetësor*. Kur bëhet fjalë për të miturin që i është shqipëtuar dënimi me burg për të mitur, që ta fitoj mundësin e lirit me kusht **njejt duhet të vuaj 1/3 e dënimit të shqiptuar** por jo para se të kaloj **1 vit në shtëpinë ndëshkimore-korrektuese**. Edhe këtu vlej kushtet e njejt që i mituri duhet t'i plotësoj ashtu që nga suksesi i arritur në edukim dhe riedukim thellësisht mund të pritët se në liri do të sillet mirë, do ta vazhdoj shkollimin dhe punën dhe se nuk do të kryej vepra penale. Edhe këtu parashihet caktimi i mbikëqyrjes mbrojtëse nga ana e gjyqit. Para vendimmarjes për lirim në bazë të lirit me kusht **neni 63 i Kodit Penal** parasheh se gjykata posaçërisht do ta merr parasysh suksesin e mjekimit të të dënuarit, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në institucionin shëndetësor dhe pjesën e mbetur të dënimit që i dënuari nuk e ka vuajtur. Shumë i logjikshëm është përcaktimi i ligjvënësit që gjyqi ka obligim ta shqyrtoj nevojën nga mjekimi dhe ruajtja në institucionin shëndetësor çdo vit. E rëndësishme është të theksohet se ky institut nuk është i paraparë te masat edukuese.

Në sistemin juridik tek ne, lirimi me kusht parashihet si **mundësi** që gjykata si organ kompetent në bazë të vlerësimit të lirë vendos për lirim e personit të dënuar. Nga kjo shumë qart shprehet se personi i dënuar vetë duhet ta meritoj lirim e tij i cili egziston vetëm si një mundësi. Si karakteristik e njohur e lirit me kusht në sistemit tonë është se lirimi me kusht aplikohet ndaj të gjithë të dënuarve pa bërë dallim për nga natyra e rëndësis së veprës penale që e ka kryer i dënuari, për nga recidivizmi ku ceket në nenin 36 p.4 të Kodit Penal të RM-së.

Unë do të shprehi një mendim i cili mund të jetë kontradiktor nga përcaktimi i ligjdhënësit për qëllimin e aplikimit të lirit me kusht. Ky institut duhet të ketë kufizime, që do të thotë të mos aplikohet ndaj të gjithë personave të dënuar dhe për të gjitha llojet e veprave penale. Kur flasë për këtë lloj kufizimi e kam fjalën për veprat e rënda penale *kundër jetës dhe trupit të njeiut* siç janë vrasjet e kualifikuara (që kryhen në mënyr më çnjerëzore), dhe që shqiptohet dënim me burgim të përjetshëm dhe për personat recidivist. Duke e bazuar në këtë fakt se personat që kryejn vepra të rënda penale, dhe paraprakisht duke i ditur pasojat e veprës penale në asnjë mënyr nuk duhet ta meritojn lirimin e parakohshëm nga vuajtja e dënimit.

Përveç KP të RM-së lirimi me kusht gjenë vend edhe në dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve. Në nenin 192 nga Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve janë dhënë bazat për lirimin e personit të dënuar nga enti ndëshkimor, ku vend zë edhe lëshimi me aktvendim për lirim me kusht.

1.1. Lirimi me kusht dhe revokimi i lirit me kusht sipas Kodit Penal të Shqipërisë

Në Kodin Penal të Shqipërisë në Kreun VII, pikërisht në nenin 64 të këtij Kodi lirimi me kusht është parapar si alternativë e dënimit. Kjo dispozitë ka pësuar ndryshime në përmbajtjen e saj, ku në ndryshim nga alternativat tjera kjo alternativë mund të jepet në fazën e ekzekutimit të dënimit. Kjo do të thotë se nëse plotësohen kriteret ligjore të këtyre dispozitave shtetasit e dënuar mund t'i drejtohen gjykatës së vendit të vuajtjes së dënimit, me kërkesë, duke kërkuar sipas rastit lirim me kusht për pjesën e mbetur të dënimit.

Në përmbajtjen e tij neni 64 i Kodit Penal i emëruar *lirim me kusht* parashikon se :⁶² *I dënuari me burgim mund të lirohet me kusht nga vuajtja e dënimit vetëm për arsye të veçanta, nëse me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur i është arritur qëllimi për edukimin e tij, si dhe të ketë vuajtur :*

- *Jo më pak se gjysmën e dënimit të dhënë për kundërvajtje penale*
- *Jo më pak se 2/3 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi deri 5 vjet burgim*
- *Jo më pak se 3/4 e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga 5 deri 25 vjet burgim. Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje. Nuk lejohet lirim me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje. Lirimi me kusht revokohet nga gjykata, kur i dënuari për një vepër penale të kryer me dashje, gjatë kohës së kushtit, kryen një tjetër vepër penale me dashje, po aq të rëndë ose më të rëndë se e para, duke u zbatuar dispozitat për bashkimin e dënimeve.*

⁶² Elezi I., Kapuçi S., Haxhi M.R., Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e përgjithshme (aranzhuar e plotësuar me shtesat e ndryshimet e bëra në reformat ligjore të viteve 2001, 2003, 2004, 2007, 2008, 2012, 2013, 2014, si me praktikën gjyqësore), Tiranë 2014, fq.312

Përkufizimi i *arsyes së veçantë* nuk jepet nga Kodi Penal por është lënë në vlerësim të gjykatës. Është gjykata ajo dhe asnjë organ tjetër që vlerëson arsyet e paraqitura nga i dënuari nëse janë apo jo *arsye të veçanta* në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal. Praktika gjyqësore ka treguar se arsyet e veçanta nuk mund të jenë të njejta për të dënuar të ndryshëm. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë si *arsye të veçanta* mund të përmenden: gjendja e vështirë sociale dhe ekonomike e familjes së të dënuarit; gjendja e vështirë shëndetësore e familjarëve të të dënuarit dhe nevoja e tyre për ndihmë dhe asistencë mjekësore; vdekja apo ikja e familjarëve, nga të cilat lihen pa kujdes fëmijët e të dënuarit apo persona të tjerë që ai mund të ketë në ngarkim etj. Element tjetër i kërkuar nga kjo dispozitë është *sjellja e të dënuarit* që gjykata duhet të çmojë se nga konstatimi i të gjithë treguesëve të sjelljes a është arritur qëllimi për edukimin apo risocializimin e këtij të dënuari ose jo. Element tjetër i vlerësimit nga gjykata, i cili duhet të merret në konsideratë përveç parametrin të sjelljes është edhe parametri i *punës së të dënuarit*, e cila gjithashtu si sjellja duhet parë në funksion të arritjes së qëllimit për edukimin e të dënuarit. Ligjvënësi shqipëtar, si rregull, lejon lirin me kusht kur përmbushen të gjitha kushtet dhe kriteret e nenit 64 të Kodit Penal, vetëm për të dënuarit me burgim deri në 25 vjet, por nga ana tjetër parashikon edhe përjashtime nga rregulli. Kështu, në *nenin 65* të Kodit Penal parashikohet se: *Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm. Vetëm në raste të jashtëzakonshme i dënuari me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht kur: Ka vuajtur jo më pak se njëzet e pesë (25) vjet burgim dhe, gjatë vuajtjes së dënimit ka mbajtur sjellje shembullore dhe çmohet se është arritur qëllimi i dënimit për edukimin e tij.*

Qëllimi i ligjvënësit në këtë rast ka qenë vendosja e kriterëve ligjorë tepër të larta për lirin me kusht nisur nga rrezikshmëria e veprës penale dhe e të dënuarve, për shkak të të cilave këta shtetas janë dënuar me burgim të përjetshëm.

Përveç faktit që ligjvënësi kërkon vuajtjen e jo më pak se 25 vjet burgim kërkon gjithashtu se gjatë kësaj periudhe dinamika e sjelljes së tij të jetë e vlerësuar shembullore, çka kërkon një disiplinë dhe sjellje tepër pozitive për të dënuarit, të cilat e kategorizojnë rastin si të jashtëzakonshëm.⁶³

Në lidhje me aplikimin e nenit 64 dhe 65 të Kodit Penal, e vetmja dispozitë procedurale në Kodin e Procedurës Penale është neni 477 i këtij Kodi, i cili parashikon se : *Gjykata e vendit të ekzekutimit vendos për lirin me kusht dhe revokimin e vendimit të lirit me kusht, sipas kritereve të caktuara në Kodin Penal dhe kërkesa nuk mund të përsëritet para se të kenë kaluar gjashtë (6) muaj nga dita kur vendimi i rrëzimit të kërkesës ka marrë formë të prerë.* Kjo dispozitë procedurale parashikon si gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesave të lirit me kusht, gjykatën e vendit të ekzekutimit të dënimit. Por sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, në rast se gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës, një kërkesë e tillë me të njëjtin objekt mund të ngrihet vetëm pasi të kenë kaluar 6 muaj nga dita që vendimi të ketë marrë formë të prerë.

⁶³ Manual për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim në Shqipëri, 2010 (<http://www.osce.org/sq/albania/72037>)

1.2. Lirimi me kusht dhe revokimi i lirit me kusht sipas Kodit Penal të Kosovës.

Instituti i lirit me kusht të personave të dënuar në Kodin Penal të Kosovës parashihet në **nenin 94** i cili thotë se :⁶⁴

- *Personi i dënuar mund të lirohet me kusht në përputhje me këtë Kod dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nëse ka bazë të arsyeshme se ai nuk do të kryej veprë të re penale. Kur merret vendimi për lirim me kusht, duhet të merret parasysh sjellja e personit të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit.*
- *Personi i dënuar për veprë penale për të cilën është paraparë dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar. Për vepra tjera penale, personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar.*
- *Personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dyzet (40) vjet nga dënimi me burgim i shqiptuar. Periudha minimale e mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues do të jetë së paku pesë (5) vjet.*
- *Lirimi me kusht vendoset nga Paneli për Lirim me Kusht i themeluar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.*

Me rastin e vendosjes nëse një të dënuar do ta lirojë me kusht gjykata duhet t'i merr parasysh : *nëse i dënuari gjatë mbajtjes së dënimit, me sjelljet e tij tregon qartë se është përmirësuar dhe me arsye mund të pritët se në të ardhmen nuk do të*

⁶⁴ Salihu I., Zhitija H., Hasani F., Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë 2014, neni 94.

kryejë vepër të re penale. Për t'u konsideruar kjo masë adekuate gjykata me rastin e vendosjes për lirimin me kusht krahas këtyre kushteve duhet të merr parasysh edhe një sërë rrethanash tjera siç janë : *vepra penale për të cilën kryesi është dënuar, personaliteti i kryesit, suksesi i arritur në përmirësimin e tij dhe si do të reflektoj lirimi i tij te i dënuari, rrethanat e tij familjare, gjendjen e tij fizike dhe psikologjike dhe veçmas qëndrimin e tij ndaj veprës penale, viktimës dhe familjes së viktimës.* Përveç këtyre kushteve që duhet t'i plotësoj personi i dënuar që janë të lidhura me personalitetin e të dënuarit dhe me veprën penale që e ka kryer, ai duhet të mbaj edhe një pjesë nga dënimi i shqiptuar ku për veprën penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim së paku pesë vjet, i dënuari mund të lirohet me kusht pasi t'i ketë mbajtur 2/3 e dënimit të shqiptuar, për veprat tjera penale, personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur gjysmën e dënimit të shqiptuar dhe i dënuari të cilit gjykata i ka shqiptuar dënimin me burgim të përjetshëm, mund të lirohet me kusht nga mbajtja e mëtejme e dënimit nëse i ka mbajtur 40 vjet. Për lirimin me kusht sipas Kodit Penal të RK-së vendos **Paneli për lirim me kusht** i përbër prej 3 anëtarve, të cilin e themelon dhe e nxerr regulloren për punën e tij Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Paneli për lirim me kusht është organ i panvarur në shqiptimin e kërkesave të personave të dënuar. Ai merr vendim lidhur me aprovimin e kërkesës së personave të dënuar ose refuzimin e tyre për një periudh të caktuar. Kundër akvendimit të Panelit për lirim me kusht nuk lejohet ankesa dhe nuk mund të ngritet konflikt administrative.⁶⁵ Paneli merr vendime duke u bazuar në raporte profesionale që i siguron nga enti ndëshkues ku personi i dënuar është duke e vuajtur dënimin.

⁶⁵ Ligji nr.04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale (Gazeta zyrtare e RKS-së nr.31 / 28 gusht 2013 Prishtinë)

Revokimi i lirimit me kusht edhe në legjislacionin e Kosovës mund të jetë *obligativ dhe fakultativ*. Sipas Kodit Penal të Kosovës :⁶⁶ **Në mënyrë obligative** gjykata patjetër do ta revokojë lirimin me kusht nëse personi i dënuar, derisa gjendet në lirimin me kusht, kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat i është shqiptuar dënimi me burgim më tepër se një (1) vit, pa marrë parasysh se çfarë dënimi është paraparë në ligj për atë vepër. **Në mënyrë fakultative** gjykata mundet ta revokojë lirimin me kusht nëse personi i dënuar derisa gjendet në lirimin me kusht, kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat i është shqiptuar dënimi me burg deri në një (1) vit, duke e përfshirë edhe dënimin e shqiptuar në kohëzgjatje me një vitë dhe vendimi i gjykatës mbi revokimin e lirimit me kusht duhet të mbështetet në vlerësimin e gjithëmbarshtëm të të gjitha rrethanave të cilat e arsyetojnë revokimin, me ç'rast gjykata posaçërisht do të marrë parasysh ngjashmërinë e veprave penale, rëndësinë e tyre, motivet nga të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat e tjera të cilat tregojnë arsyeshmërinë e revokimit të lirimit me kusht. Në rastet kur gjykata revokon lirimin me kusht, qoftë në bazë të revokimit obligativ apo fakultativ, ia shqipton dënimin unik sipas dispozitave mbi matjen e dënimin për veprat penale në bashkim *neni 80* i Kodit Penal , me ç'rast dënimin e shqiptuar më parë e merr si të caktuar.

⁶⁶ Salihu I., Zhitija H., Hasani F., Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës , Prishtinë 2014, neni 95

Kapitulli IV

1. Aplikimi i lirit me kusht në R.Maqedonisë dhe në Gjykatën Themelore të Gostivarit gjatë periudhës kohore 2009-2013.

Sipas të dhënave nga Drejtoria mbi ekzekutimin e sanksioneve personat e dënuar me dënimin me burgim e shfrytëzojnë të drejtën të dorëzojnë lutje për lirim në bazë të lirit me kusht. Në fakt në vitin **2009** gjendja e aplikimit të lirit me kusht është e njëjtë me vitet e kaluara, respektivisht nuk ka rritje të numrit të propozimeve të paraqitura nga ana e drejtorëve të institucioneve ndëshkuese-përmirësuese për lirim me kusht të personave të dënuar, gjithashtu nuk është rritur edhe numri i lutjeve të paraqitura nga ana e personave të dënuar dhe që janë refuzuar nga ana e gjyqit.


Tabela nr 1: Paraqitja e lutjeve dhe propozimeve në vitin 2009.

Entet ndëshkuese përmirësuese	Nr.i lutjeve për lirim me kusht	Nr. i propozimeve për lirim me kusht	të miratuara		të refuzuara	
			Lutjet	Propozimet	Lutjet	Propozimet
ENP i Idrizovë	204	4	53	0	151	4
ENP Shtip	91	14	21	9	70	5
ENP i llojit të hapur në Strugë	42	1	11	0	31	1
Burgu i Shkupit	213	1	82	1	231	0
Burgu i Prilepit	31	3	18	2	13	1
Burgu Kumanovë/Kriva Pallank	24	0	17	0	7	0
Burgu i Manastirit	34	0	13	0	21	0
Burgu i Strumicës	71	2	18	2	53	0
Burgu i Gjevgjeliës	55	0	19	0	36	0
Burgu i Tetovës	61	1	20	0	41	1
Burgu i Ohrit	20	15	2	1	18	14
Gjithsejt	846	41	274	15	672	26

Bazuar në : Raportin vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2009, Shkup 2010, fq 30-31

Në tabelën nr.1 janë shfaqur numrat e lutjeve dhe propozime të paraqitura për lirin me kusht, gjithashtu edhe numrin e propozimeve dhe lutjeve që janë miratuar nga ana e gjyqit në vitin 2009.

Grafiku 1 : Numri i lutjeve dhe propozimeve të miratuara për personat e dënuar



Bazuar në : Raportin vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2009, Shkup 2010, fq 30-31

Nga gjithsejt **946** lutje të paraqitura për lirim me kusht në vitin 2009 vetëm **29%** prej tyre janë pranuar nga ana e gjyqit. Numri i propozimeve të paraqitura nga ana e drejtorëve të enteve ndëshkuese-përmirësuese ekskluzivisht është i vogël, nga gjithsejt **41** propozime të paraqitura më pak se gjysma **15 propozime** kanë qenë të pranuar.⁶⁷

⁶⁷ Raporti vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2009, Shkup 2010, fq 30-31

Në tabelën nr.2 do të pasqyrohet lartësia e dënimit të personave të dënuar të cilëve u është dhënë lirimi me kusht në vitin 2009.

Entet ndëshkuese përmirësuese	Lartësia e dënimit				
	deri 1 vit	nga 1- 3 vjet	nga 3- 5 vjet	nga 5- 7 vjet	mbi 7 vjet
ENP i Idrizovë	20	10	10	4	9
ENP Shtip	18	9	2	0	2
ENP i llojit të hapur në Strugë	7	1	1	1	1
Burgu i Shkupit	64	18	0	0	0
Burgu i Prilepit	6	10	4	0	0
Burgu Kumanovë/Kriva Pallank	13	4	0	0	0
Burgu i Manastirit	9	3	0	1	0
Burgu i Strumicës	15	4	0	0	1
Burgu i Gjevgjelisë	17	1	1	0	0
Burgu i Tetovës	19	1	0	0	0
Burgu i Ohrit	0	1	0	2	0
Gjithsejt	188	62	18	8	13

Bazuar në : Raportin vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2009, Shkup 2010, fq 32

Në vitin **2009** nga gjithsejt **289** persona të dënuar që kanë fituar lirim me kusht, **188** prej tyre që kanë fituar lirimin me kusht kanë qenë të dënuar me dënim me burg deri 1 vjet, **62** të dënuar kanë qenë të dënuar me dënim me burg nga 1-3 vjet, **18** prej tyre kanë qenë të dënuar me dënim me burg nga 3-5 vjet, **8** persona të dënuar kanë qenë të dënuar me dënim me burg nga 5-7 vjet, dhe **13** persona të dënuar që kanë fituar lirimin me kusht kanë qenë të dënuar me dënim me burg mbi 7 vjet.⁶⁸ Në të shumtën e rasteve lirimi me kusht jepet për dënime më të shkurta.

⁶⁸ Raporti vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2009, Shkup 2010, fq 32.

Në tabelën nr.3 do ta paraqesim gjatësin e lirit me kusht të miratuar në vitin 2009 ku do na mungojn të dhënat nga burgu i Kumanovës me repart të hapur në Kriva Pallank dhe nga burgu i Manastirit.

Entet ndëshkuese përmirësuese	Gjatësia e lirit me kusht ne vitin 2009						
	deri 3 muaj	nga 3-6 muaj	nga 6-9 muaj	nga 9 muaj deri 1 vit	deri 2 vjet	deri 3 vjet	deri 5 vjet
ENP Idrizovë	23	19	7	0	2	0	1
ENP Shtip	14	12	0	3	0	0	0
ENP i llojit të hapur në Strugë	9	1	0	0	1	0	0
Burgu i Shkupit	73	7	2	0	0	0	0
Burgu i Prilepit	17	3	0	0	0	0	0
Burgu Kumanovë/Kriva Pallank							
Burgu i Manastirit							
Burgu i Strumicës	11	5	1	0	2	0	0
Burgu i Gjevgjeliës	17	2	0	0	0	0	0
Burgu i Tetovës	17	2	1	0	0	0	0
Burgu i Ohrit	0	1	1	0	0	1	0
Gjithsejt	181	52	12	3	5	1	1

Bazuar në : Raportin vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2009, Shkup 2010, fq 32

Lirimi me kusht me shpesh është aplikuar për periudha të shkurtëra nga dënimi, përkatësisht në **181** raste ka qenë i miratuar deri **3 muaj**, ndërsa në **52** raste ka qenë i miratuar **nga 3-6 muaj**, kurse në **12** raste është aplikuar në periudhën kohore prej **6-9 muaj**, deri **1 vit** është aplikuar në **3** raste, **deri 2 vjet** janë liruar **5** të dënuar, kurse për periudhën **deri 5 vjet** është liruar me kusht vetëm **1** person dhe **deri 7 vjet** poashtu është liruar **1** person i dënuar.⁶⁹

⁶⁹ Raporti vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2009, Shkup 2010, fq 33.

Nga të dhënat e shënuara kuptojm se lirimi me kusht aplikohet me tepër për dënime të shkurtëra deri 3 muaj, për periudhat tjera mendohet se nuk është arritur qëllimi themelor i dënimit për aplikimin e lirit me kusht.

Nga të dhënat e *Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve të Maqedonisë* në vitin **2010** në të gjitha entet ndëshkuese-përmirësuese në R.Maqedonisë dënimin me burg e kanë vuajtur **2175** persona. Nga gjithsejt **1681** persona të liruar nga vuajtja e mëtutjehme e dënimit në vitin 2010, me lutje nga personi i dënuar apo me propozim të drejtorit të entit ndëshkues me mendim paraprak nga organi kompetent i entit ndëshkues dhe nga prokurori publik. Numri i personave e dënuar që u është mundësuar ndërprejra e dënimit me burg **deri 30 ditë** është **14 raste**, ndërsa numri personave të dënuar që u është mundësuar ndërprerja e dënimit me burg **mbi 30 ditë** është **16 raste**.⁷⁰

Sipas të dhënave nga *Drejtoria mbi ekzekutimin e sanksioneve të Maqedonisë* gjatë vitit **2011** dënim me burg kanë vuajtur **1895** persona, nga të cilët **1842 kanë qenë bura**, ndërsa **53 persona kanë qenë gra**. Numri i personave të dënuar deri në fund të vitit është rritur dhe ka arritur gjithsejt **2122 persona të dënuar**. Gjatë vitit 2011 numri i personave që janë liruar është **1386 persona të dënuar** nga të cilët **1354 kanë qenë bura** ndërsa **32 kanë qenë gra**. Numri i personave që u është lejuar ndërpretja e dënimit nga ana e Drejtoris mbi ekzekutimin e sanksioneve është **21 persona të dënuar**, ndërsa personat e dënuar që u është lejuar ndërprerja e dënimit me burg nga ana e gjyqit është **13 persona të dënuar**.⁷¹

⁷⁰ Raporti vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2010, Shkup Korrik 2011, fq 58.

⁷¹ Ibid, për vitin 2011, Shkup April 2012, fq 26,32.

Gjatë vitit **2012** dhe deri në fund të vitit më saktësisht nga 28.02.2012 deri 31.12.2012 numri i personave të dënuar është rritur dhe në vuajtje të dënimit kanë qenë **2188 persona të dënuar**. Poashtu gjatë vitit 2012 nga vuajtja e dënimit janë liruar gjithsejt **1232 persona të dënuar**, **699 persona të dënuar** janë liruar nga vuajtja e dënimit me vendim të Drejtorëve të enteve ndëshkuese pas mbajtjes së **3/4 të dënimit**, **213 persona të dënuar** me vendim për falje, ndërsa **289 persona të dënuar** janë liruar nga gjyqi në bazë të lirimit me kusht.⁷²

Tabela nr. 4 Numri i lirimit të personave të dënuar gjatë vitit 2013 nga entet ndëshkuese-përmirësuese.

Entet ndëshkuese përmirësuese	Mënyra në bazë së cilës janë liruar nga vuajtja e dënimit					
	Pas mbajtjes së plotë të dënimit	Lirimi me vendim të drejtorit të ENP	Të falur	Të amnestuar	Të liruar me kusht	Gjithsejt
ENP Idrizovë	27	278	2	0	39	346
ENP Shtip	12	35	3	0	17	67
ENP Strugë	0	53	0	1	9	63
Burgu në Shkup	64	110	5	2	80	261
Burgu në Kumanovë	0	2	1	0	0	3
Burgu Kriva Pallank	7	21	1	0	14	43
Burgu Manastir	19	31	10	1	20	81
Burgu në Prilep	7	18	0	0	29	54
Burgu Tetovë	19	58	6	2	18	103
Burgu Strumicë	21	89	4	0	32	146
Burgu Gjevgjeli	8	55	2	0	26	91
Burgu i Ohrit	7	2	0	0	3	12
Gjithsejt	191	752	34	6	287	1270

Raporti vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2013, Shkup, Mars 2014, fq 30,31.

⁷² Raporti vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2012, Shkup, April 2013, fq 22.

Gjatë vitit 2013 nga vuajtja e dënimit me burgim janë liruar gjithsejt **1270 persona** të dënuar. Numri më i madh i personave të dënuar ku **752 persona** të dënuar kanë qenë të liruar nga vuajtja e dënimit me burgim *në bazë të vendimit të Drejtorve të enteve ndëshkuese-përmirësuese në kohëzgjatje prej 30-120 ditë*, varësisht nga lartësia e dënimit, **191 persona** të dënuar janë liruar *pas mbajtjes së plot të dënimit*, në bazë të *faljes* janë liruar **31 persona** të dënuar, **6 persona** të dënuar janë *amnistuar*, ndërsa **287 persona** të dënuar janë liruar nga ana e gjyqit **në bazë të lirimit me kusht**, përkatësisht **22.5%** nga personat e dënuar janë liruar me kusht.⁷³

⁷³ Raporti vjetor të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2013, Shkup, Mars 2014, fq 30,31.

2. Aplikimi i lirit me kusht në territorin e Gjykatës Themelore të Gostivarit gjatë periudhës kohore 2009-2013.

Në këtë pjesë do të japim një pasqyrë rreth numrit të kërkesave dhe propozimeve të pranuar dhe të refuzuara që janë paraqitur në Gjykatën Themelore të Gostivarit sipas kategorisë së veprave penale si dhe sipas përkatësisë nacionale gjatë periudhës kohore 2009-2013.

Tabela 1. Pasqyra e lutjeve të paraqitura pranë Gjykatës Themelore të Gostivarit gjatë periudhës kohore 2009 – 2013.⁷⁴

Veprat penale kundër jetës dhe trupit	2009	2010	2011	2012	2013
Vrasja -neni 123	1	2	2	1	1
Vrasja nga motivet fisnike -neni 124					
Vrasja në çast -neni 125					
Vrasja nga pakujdesia -neni 126					
Vrasja e fëmijës gjatë lindjes -neni 127					
Shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje -neni 128					
Ndërprerja e kundërligjshme e shtatzënisë -neni 129					
Lëndimi trupor -neni 130	2	2	1		
Lëndimi i rëndë trupor -neni 131	1	1	3	2	1
Pjesëmarrja në rrahje -neni 132	2				
Kërcënimi me mjet i rrezikshëm gjatë rrahjes apo përleshjes -neni 133					
Vënja në rrezik -neni 134					
Braktisja e personit të paaftë -neni 135					
Mosdhënia e ndihmës -neni 136					
Gjithsejt	6	5	6	3	2

⁷⁴ Raporti i punës së Gjykatës Themelore të Gostivarit në periudhën kohore 2009 – 2013 .

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit	2009	2010	2011	2012	2013
Shkelja e barazisë së qytetarve -neni 137					
Shkelja e të drejtës së përdorimit të gjuhës dhe alfabetit-neni 138					
Detyrimi (shtrëngimi) -neni 139					
Privimi i kundërligjshëm nga liria -neni 140	1				
Rrëmbimi -neni 141	1	1	1		
Torturimi dhe të vepruarit e vrazhdë, jonjerëzor apo shtërngues dhe ndëshkimi -neni 142					
Keqtrajtimi gjatë kryerjes së detyrës -neni 143					
Rrezikimi i sigurisë -neni 144	1		1	1	
Shkelja e paprekshmërisë së banesës -neni 145					
Bastisja e kundërligjshme -neni 146					
Shkelja e fshehtësisë së shkresave ose të dërgesave tjera -neni 147					
Publikimi i paautorizuar i shënimeve personale -neni 148					
Keqpërdorimi i të dhënave personale - neni 149	1	1			1
Pengimi i qasjes në sistemin publik informatik -neni 149-a					
Zbulimi i paautorizuar i fshehtësisë -neni 150					
Përgjimi dhe inçizimi tonik i paautorizuar -neni 151					
Inçizimi i paautorizuar -neni 152					
Shkelja e të drejtës së paraqitjes së mjetit juridik -neni 153					
Pengimi i shtypjes dhe i shpërndarjes së materialeve të shtypura -neni 154					
Pengimi i tubimit publik -neni 155					
Shkelja e të drejtës së grevës -neni 156					
Shkelja e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqësuara-neni 157					
Shkelja e të drejtës së distributorit të sinjalit satelitor me mbrojtje të posaçme teknike -neni 157-a					
Pirateria e veprës audio-vizuele -neni 157-b					
Pirateria e fonogramit -neni 157-c					
Gjithsejt	4	2	2	1	1

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Veprat penale kundër zgjedhjeve dhe votimeve	2009	2010	2011	2012	2013
Pengimi i zgjedhjeve dhe i votimit -neni 158	1		1	1	2
Shkelja e të drejtës zgjedhore -neni 159					
Shkelja e lirisë së përcaktimit të zgjedhjeve -neni 160					
Keqpërdorimi i të drejtës zgjedhore -neni 161					
Korrupsioni gjatë zgjedhjeve dhe votimit -neni 162					
Cënimi i fshehtësisë së votimit -neni 163					
Shkatërrimi i dokumenteve zgjedhore -neni 164					
Mashtrimi zgjedhor -neni 165					
Keqpërdorimi i mjeteve për finansimin e fushatës zgjedhore -neni 165-a					
Shqiptimi obligativ i dënimit ndalim për kryerje të profesionit veprimtarisë apo detyrës -neni 165-b					
Gjithsejt	1	-	1	1	2

Veprat penale kundë lirisë dhe moralit gjinor	2009	2010	2011	2012	2013
Dhunimi -neni 186	1		3	1	
Kryerja e aktit seksual me person të paaftë -neni 187					
Sulmi seksual ndaj të miturit që nuk ka mbushur 14 vjet-neni 188		3	1		2
Kryerja e aktit seksual me keqpërdorim të pozitës -neni 189					
Kënaqja e epsheve seksuale para tjetërkujt – neni 190					
Ndërmjetësimi në ushtrimin e prostitucionit – neni 191	2	2	3	1	2
Shtirja dhe të mundësuarit e veprimeve seksuale – neni 192					
Ekspozimi i materialit pornografik të miturit –neni 193					
Prodhimi dhe distribuimi i pornografisë fëmijërore-neni 193-a					
Tërheqja në prostitucion apo në veprim tjetër seksual personin e mitur i cili nuk ka mbushur 14 vjet- neni 193-b					
Incesti – neni 194					
Gjithsejt	3	5	7	2	4

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Veprat penale kundër shëndetit të njeriut	2009	2010	2011	2012	2013
Bartja e sëmundjes ngjitëse – neni 205					
Mosveprimi siaps dispozitave shëndetësore gjatë kohës së epidemis – neni 206					
Mjekimi i pandërgjegjshëm i të sëmurëve – neni 207					
Mosdhënia e ndihmës mjekësore – neni 208					
Kuazimjekësia (pseudomjekësia) – neni 209					
Transplatimi i palejuar i pjesëve të trupit të njeriut- neni 210					
Ushtrimi i pandërgjegjshëm i veprimtaris farmaceutike-neni 211					
Prodhimi dhe lëshimi në qarkullim i mjeteve të dëmshme për mjekim – neni 212					
Prodhimi dhe lëshimi në qarkullim i produkteve të dëmshme ushqimore dhe produkteve tjera – neni 213					
Kryerja e pandërgjegjshme e kontrollit të mishit për ushqim- neni 214					
Prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike substancave psikotrope dhe prekurësorve- neni 215	2	2	6	12	8
Mundësimi i përdorimit të drogave narkotike					
Veprat e rënda kundër shëndetit të njerëzve – neni 217					
Gjithsejt	2	2	6	12	8

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Veprat penale kundër pasurisë	2009	2010	2011	2012	2013
Vjedhja –neni 235	3	1		1	1
Vjedhja e rëndë – neni 236	2	6	2	4	6
Grabitja – neni 237	4	2	3		1
Vjedhja grabitqare – neni 238					
Fshehja - neni 239					
Të shërbyerit (shërbimi) – neni 240					
Marja e sendeve të huaja – neni 241					
Marja e automjetit – neni 242					
Dëmtimi i sendeve të huaja – neni 243					
Dëmtimi i të drejtave të huaja – neni 244					
Ndërtimi i paligjshëm – neni 244-a					
Dëmtimi i ndëtesave banesore dhe afariste dhe i lokaleve- neni 245					
Të vendosurit (shpërngulja) e paligjshëm – neni 246					
Mashtrimi – neni 247	1		2		
Mashtrimi i blerësve – neni 248					
Mashtrimi gjatë marrjes së kredisë apo volisë tjetër – neni 249					
Mashtrimi në dëm të mjeteve të Bashkësisë Evropiane- neni 249-a					
Mashtrimi në sigurime – neni 250					
Dëmtimi dhe hyrja e paautorizuar në sistemin kompjuterik – neni 251					
Bërja (programimi) dhe futja e viruseve kompjuterike- neni 251-a					
Mashtimi kompjuterik –neni 251-b					
Keqpërdorimi i besimit – neni 252					
Pranimi i paautorizuar i dhuratave – neni 253					
Falementimi i rrejshëm – neni 254					
Shkaktimi i falementimit me punë të pandërgjegjshme – neni 255					
Keqpërdorimi i procedurës së falementimit – neni 256					
Dëmtimi apo favorizimi i kreditorëve – neni 257					
Shtrëngimi (detyrimi, shantazhi) – neni 258				1	
Shantazhi – neni 259	1				
Fajdexhillëku - neni 260					
Fshehja (të fshehurit, mbulimi) – neni 261					

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Pendimi i veprës së krijuar – neni 262					
Ndjekja për vepra në mes të afërmeve – neni 263					
Gjithsejt	11	9	7	6	8

Veprat penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë	2009	2010	2011	2012	2013
Falsifikimi i parave – neni 268	2	1		1	1
Falsifikimi i letrave me vlerë – neni 269					
Falsifikimi i shenjave me vlerë – neni 270					
Ndreqja, furnizimi apo tjetërsimi i mjeteve për falsifikim – neni 271					
Raste të veçanta të falsifikimit të parave, letrave me vlerë apo shenjave me vlerë – neni 271-a					
Falsifikimi i shenjave për shënimin e mallrave masave dhe rrugëve të peshores – neni 272					
Larja e parave dhe dobia tjetër e kundërligjshme e pasurisë – neni 273					
Lëshimi i çekut pa mbules dhe keqpërdorimi i kartelave pagesore – neni 274					
Lëshimi i urdhërit të akceptuar pa mbulesë – neni 274-a					
Përpunimi dhe përdorimi i kartelës së rrejshme pagesore -neni274-b					
Mashtrimi gjatë punës me letra me vlerë dhe me hise – neni 275					
Shkelja e të drejtave nga letra me vlerë – neni 275-a					
Veprimi joligjor i revizorit të paautorizuar – neni 275-b					
Keqpërdorimi i procedurës për thirrje publike, dhënja e kontratës për furnizim publik apo partneritet publik-privat – neni 275-c					
Prodhimi i palejuar – neni 276					
Tregtia e palejuar – neni 277					
Kontrabanda - neni 278	1				
Mashtrimi doganor- neni 278-a					
Fshehja e mallrave që janë lëndë e kontrabandës dhe mashtrimit doganor – neni 278-b					
Fshehja e tatamit - neni 279		1		1	

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Falsifikimi ose shkatërrimi i librave afariste – neni 280					
Dhënja dhe grumbullimi i paautorizuar i fshehtësisë afariste – neni 281					
Shkelja e barazisë gjatë kryerjes së veprimtarisë ekonomike – neni 282					
Pengimi , kufizimi apo prishja e konkurrencës – neni 283					
Konkurrenca jolojale lidhur me punën e qarkullimit të jashtëm tregtar – neni 284					
Shkelja e të drejtave nga prona industriale dhe përdorimi i paautorizuar i firmës së huaj – neni 285					
Shkelja e të drejtës nga zbulimi i paraqitur apo mbrojtjes dhe topografia e çarqeve integrale – neni 286					
Keqpërdorimi i autorizimit në ekonomi – neni 287					
Gjithsejt	3	2	-	2	1

Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëze dhe pasurisë	2009	2010	2011	2012	2013
Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm – neni 288					
Shkaktimi i rrezikut gjatë punëve ndërtimore – neni 289					
Dëmtimi i instalimeve mbrojtëse – neni 290					
Shkatërimi apo dëmtimi i instalimeve publike – neni 291					
Vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme – neni 292	1	1	2		1
Dëmtimi i pendëve – neni 293					
Mosmënjanimi i rrezikut – neni 294					
Prodhimi dhe qarkullimi i paautorizuar i materieve me rrezik të përgjithshëm – neni 295					
Mospjesëmarja në mënjanimin e rrezikut të përgjithshëm – neni 269					
Gjithsejt	1	1	2	-	1

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Veprat penale kundër sigurisë në komunikacion publik	2009	2010	2011	2012	2013
Rrezikimi i sigurisë në trafik – neni 297	1	2		1	
Rrezikimi i sigurisë së trafikut me veprim ose mjet të rrezikshëm – neni 298					
Të ushtruarit e pandërgjegjshëm të mbikëqyrjes së trafikut – neni 299					
Vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik – neni 300	6	3	9	3	5
Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësi trafiku – neni 301					
Rrëmbimi i fluturakes apo lundrueses – neni 302					
Rrezikimi i sigurisë në trafikun ajror – neni 303					
Prishja ose mënjanimi i shenjës që shërben për siguri në trafikun ajror – neni 304					
Gjithsejt	7	5	9	4	5

Veprat penale kundër qarkullimit juridik	2009	2010	2011	2012	2013
Falsifikimi i dokumenteve – neni 378	1	2			1
Rastet e veçanta të falsifikimit të dokumentave – neni 379					
Falsifikimi kompjuterik – neni 379-a					
Përdorimi i dokumentit me përmbajtje të pavërtetë – neni 380					
Dhënia dhe përdorimi i çertifikatës së rrejshme mjekësore ose veterinare – neni 381					
Kuazishkruesia (pseudoshkruesja) – neni 381-a					
Gjithsejt	1	2	-	-	1

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Veprat penale kundër detyrës zyrtare	2009	2010	2011	2012	2013
Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar – neni 353	1			1	2
Shkelja e ruajtjes së kufirit shtetëror – neni 353-a					
Moszbatimi i urdhrimit – neni 353-b					
Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës – neni 353-c					
Shpërdorimi i shërbimit – neni 354					
Mashtrimi gjatë shërbimit – neni 355					
Të shërbyerit gjatë detyrës – neni 356					
Marrja e ryshfetit – neni 357					1
Dhënia e ryshfetit – neni 358					
Ndërmjetësimi i kundërligjshëm – neni 359					
Fitimi i kundërligjshëm dhe pasuria e fshehur – neni 359-a					
Zbulimi i fshehtësisë zyrtare – neni 360					
Keqpërdorimi i fshehtësisë shtetërore, zyrtare apo ushtarake – neni 360-a					
Falsifikimi i dokumenteve zyrtare – neni 361					
Arkëtimi dhe pagesa kundërligjore – neni 362					
Ndjekja për veprat penale kundër detyrës zyrtare – neni 362-a					
Shqiptim objektiv i dënimit ndalim për të kryer profesion, veprimtari apo detyrë – neni 362-b					
Gjithsejt	1	-	-	1	3

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Veprat penale kundër rendit publik	2009	2010	2011	2012	2013
Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e veprimit zyrtar – neni 382					
Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së punëve të sigurimit – neni 383					
Pjesëmarrja në turmë që do të pengojë personin zyrtar në kryerje të veprimit zyrtar – neni 384					
Pjesëmarrja në turmë që do të kryejë veprë penale – neni 385					
Dhuna – neni 386	2				1
Organizimi i rezistencës – neni 387					
Ndryshimi kundërligjor i ndarjes territoriale të R.M.-së – neni 388					
Heqja ose demtimi i vulës apo i shenjës zyrtare – neni 389					
Marrja ose shkatërrimi i vulës apo shkresës – neni 390					
Prezentimi i rrejshëm – neni 391					
Vetëgjyqësia (arbitrarizmi) – neni 392					
Marveshja për kryerje të veprës penale – neni 393					
Bashkimi kriminal - neni 394					
Organizata terroriste – neni 394-a					
Terrorizmi – neni 394-b					
Finansimi i terrorizmit – neni 394-c					
Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik – neni 394-ç					
Përpunimi dhe furnizimi i armëve dhe i mjeteve të destinuara për kryerje të veprës penale – neni 395					
Përpunimi, mbajtja dhe tregtia e palejuar e armës apo materialeve shpërthyese – neni 396	4	3	8	4	2
Falsifikimi i armës së zjarrit – neni 396-a					
Keqpërdorimi i shenjës për ndihmë dhe rrezik – neni 397					
Bixhozi – neni 398					
Pengimi i ceremonisë fetare – neni 399					
Përdhosja (dhunimi) e varrit – neni 400					
Përdhosja e të vdekurit – neni 401					
Kalimi i palejuar i kufirit shtetëror – neni 402					
Gjithsejt	6	3	8	4	3

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare	2009	2010	2011	2012	2013
Gjenocidi – neni 403					
Krimet kundër njerëzimit – neni 403-a					
Krimet e luftës kundër popullatës civile – neni 404					
Krimet e luftës kundër të plagosurve dhe të sëmurëve – neni 405					
Krimet e luftës kundër robërve të luftës – neni 406					
Përdorimi i mjeteve të palejuara të luftës – neni 407					
Lejimi apo arsyetimi i gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës – neni 407-a					
Keqpërdorimi i armës kimike apo biologjike – neni 407-b					
Vrasja dhe palgosja e paligjshme e armikut – neni 409					
Marrja e kundërligjshme e sendeve nga të vrarit dhe të plagosurit në fushëbetejë – neni 410					
Lëndimi i parlamentarit – neni 411					
Të vepruarit në mënyr brutale me të plagosurit, të sëmurit dhe me robërit e luftës – neni 412					
Shtyrja e paarsyetuar e riatdhesimit të robërve të luftës – neni 413					
Shkatërrimi i të mirave apo trashigimisë kulturore që janë në mbrojtje të përkohshme – neni 414					
Nxitja e luftës agresive – neni 415					
Keqpërdorimi i shenjave ndërkombëtare – neni 416					
Organizimi i grupit dhe nxitja për kryerje gjenocid dhe krime të luftës – neni 416-a					
Përgjegjësia e komandantëve dhe eprorëve tjerë – neni 416-b					
Përgjegjësia e të nënshtruarit për veprën e kryer me urdhër të eprorit – neni 416-c					
Diskriminimi racor dhe diskriminimet tjera – neni 417					
Themelimi i raportit të robit dhe transport i personave që janë në raport të robit – nenin 418					
Tregtia me njerëz – neni 418-a		1	1	1	1
Kontrabanda me emigrant – nenim 418-b					

Lirimi me kusht me vështrim të veçant në Gjykatën Themelore të Gostivarit

Organizi i grupit dhe nxitje për kryerje të veprave tregti me njerëz, tregti me person të mitur dhe kontrabandë me emigrant – neni 418-c					
Tregtia me person të mitur – neni 418-ç					
Terrorizmi ndërkombëtar – neni 419					
Kërcënimi i personave që janë nën mbrojtje ndërkombëtare - neni 420					
Marrja e pengjeve – neni 421					
Pirateria – neni 422					
Gjithsejt	-	1	1	1	1

Tabela nr.2 Lutjet e pranuar dhe të refuzuara për lirim me kusht që janë parashtruar pranë Gjykatës Themelore të Gostivarit gjatë periudhës kohore 2009 – 2013.

Viti	Nr. lutjeve të paraqitura për lirim me kusht.	lutjet e pranuar	Përqindja	lutjet e refuzuara	Përqindja	lutjet e tërhequra	Përqindja
2009	51	11	21,57	37	72,55	3	5,88
2010	39	8	20,51	26	66,67	5	12,82
2011	44	6	13,64	32	72,73	6	13,64
2012	37	14	37,84	21	56,76	2	5,41
2013	31	6	19,35	24	77,42	1	3,23
Gjithsejt	202	45	22,28	140	69,31	17	8,42

Tabela nr.3 Lutjet për lirim me kusht në bazë të përkatësisë nacionale që janë parashtruar pranë Gjykatës Themelore të Gostivarit gjatë periudhës kohore 2009 – 2013.

Viti	Nr. i lutjeve të paraqitura për lirim me kusht	Shqipëtar	Përqindja	Maqedonas	Përqindja
2009	51	43	84,31	8	15,69
2010	39	22	56,41	17	43,59
2011	44	34	77,27	10	22,73
2012	37	33	89,19	4	10,81
2013	31	23	74,19	8	25,81
Gjithsejt	202	155	76,73	47	23,27

Lutjet e paraqitura sipas kategorisë të veprave penale në vitin 2009

Gjatë vitit 2009 në grupin e *veprave penale kundër jetës dhe trupit të njeriut* nga paraqitja e gjithsejt **6 lutje** për lirim me kusht, është paraqitur **1 lutje** për veprën penale *vrasje*, **2 lutje** për veprën penale *lëndime trupore*, **1 lutje** për veprën penale *lëndime të rënda trupore* si dhe **2 lutje** për veprën penale *pjesëmarje në rrahje*. Për grupin e *veprave penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit* janë paraqitur gjithsejt **4 lutje**, edhe atë **1 lutje** për veprën penale *privim i kundërligjshëm nga liria*, **1 lutje** për veprën penale *rrëmbim*, **1 lutje** për veprën penale *rrezikimi i sigurisë* dhe **1 lutje** për veprën penale *keqpërdorim i të dhënave personale*. Në grupin e *veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimeve* është paraqitur vetëm **1 lutje** edhe atë për veprën penale *pengim i zgjedhjeve dhe i votimit*. Ndërsa në grupin e *veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor* janë

paraqitur gjithsejt **3 lutje**, duke filluar me **1 lutje** për veprën penale *dhunim*, dhe **2 lutje** për veprën penale *ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit*. Për *veprat penale kundër shëndetit të njeriut* gjatë këtij viti janë paraqitur vetëm **2 lutje** edhe atë për veprën penale *prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekurësorve*. Grupi i *veprave penale kundër pasurisë* e bënë të dalluar këtë vit për nga numri i lutjeve të paraqitura edhe atë me **11 lutje** të paraqitura për lirim me kusht, në krahasim me vitet tjera, kështu që **3 lutje** janë paraqitur për veprën penale *të vjedhjes*, **2 lutje** për veprën penale *vjedhje të rëndë*, **4 lutje** për veprën penale *të grabitjes*, **1 lutje** për veprën penale *marshtrim*, si dhe **1 lutje** për veprën penale *shantazh*. Në kategorinë e *veprave penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë* janë paraqitur **3 lutje** edhe atë **2 lutje** për veprën penale *falsifikim i parave*, dhe **1 lutje** për veprën penale *kontraband*. Në grupin e *veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë* është paraqitur vetëm **1 lutje** edhe atë për veprën penale *vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme*. *Veprat penale kundër sigurisë në komunikacion publik* në këtë vit radhiten në rend të dyt për nga numri i lutjeve të paraqitura për lirim me kusht në krahasim me grupet e tjera të veprave penale edhe atë me **1 lutje** për veprën penale *rrezikimi i sigurisë në trafik*, dhe **6 lutje** për veprën penale *vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik*. Në grupin e *veprave penale kundër detyrës zyrtare*, është paraqitur vetëm **1 lutje** për lirim me kusht për veprën penale *keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar*, poashtu edhe në grupin e *veprave penale kundër qarkullimit juridik* është paraqitur **1 lutje** për lirim me kusht për veprën penale *falsifikim i dokumenteve*. Për grupin e *veprave penale kundër rendit publik* gjithsejt janë paraqitur **6 lutje** për lirim me kusht, edhe atë **2 lutje** për veprën penale *të dhunës*, dhe **4 lutje** për veprën penale *përpunimi, mbajtja dhe tregtia e palejuar e armës apo materialeve shpërthyes*.

Gjatë vitit 2009 gjithsejt janë paraqitur **51 lutje** për lirim me kusht *dhe është një nga vitet me numër më të madh të lutjeve të paraqitura* për lirim me kusht nga të cilat **11 lutje apo 21,57%** nga numri i përgjithshëm i lutjeve *janë pranuar*, **37 lutje apo 72,55%** nga numri i përgjithshëm i lutjeve *janë refuzuar* dhe **3 lutje apo 5,88%** nga numri i përgjithshëm i lutjeve *janë tërhequr* nga ana e personave të dënaur. Sa i përket *përkatësisë nacionale* nga gjithsejt **51 lutje** të paraqitura **43 lutje apo 84,31%** *janë shqipëtar* ndërsa **8 lutje apo 15,69%** *janë maqedonas*.

Lutjet e paraqitura sipas kategorisë të veprave penale në vitin 2010

Gjatë periudhës kohore të vitit 2010 vërehet ky numër i lutjeve të paraqitura për lirim me kusht duke filluar nga grupi i *veprave penale kundër jetës dhe trupit* që janë paraqitur gjithsejt **5 lutje** për lirim me kusht edhe atë **2 lutje** për veprën penale *të vrasjes*, **2 lutje** për veprën penale *lëndim trupor*, dhe **1 lutje** për veprën penale *lëndim i rëndë trupor*. Në grupin e *veprave penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit* janë paraqitur vetëm **2 lutje** edhe atë **1 lutje** për veprën penale *rrëmbim* dhe **1 lutje** për veprën penale *keqpërdorim i të dhënave personale*. Për *veprat penale kundër lirisë dhe moralit gjinor* janë paraqitur gjithsejt **5 lutje** nga të cilat **3 lutje** për lirim me kusht janë paraqitur për veprën penale *sulmi seksual ndaj të miturit që nuk ka mbushur 14 vjet*, si dhe **2 lutje** për veprën penale *ndërmjetësimi në ushtrimin e prostitucionit*. Në grupin e *veprave penale kundër shëndetit të njeriut* vërehen **2 lutje** të paraqitura për lirim me kusht për veprën penale *prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike substancave psikotrope dhe prekurësorve*. Ashtu si në vitin paraprak edhe në këtë vit grupi i *veprave penale kundër pasurisë radhitet e para* për nga numri i lutje të paraqitura për lirim me kusht me gjithsejt **9 lutje** kështu që tri nga veprat e këtij grupi përfaqësohen me: **1 lutje vejdhja**, **6 lutje vjedhja e rëndë** si dhe **2 lutje** vepra penale e *grabitjes*. *Veprat penale kundër financave publike*,

qarkullimit pagesor dhe ekonomisë pasqyrojn **2 lutje** për lirim me kusht, **1 lutje** për veprën penale *falsifikim i parave* dhe **1 lutje** për *fshehje të tatimit*. Grupi i *veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë* përfaqësohet me **1 lutje** për lirim me kusht edhe atë për veprën penale *vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme*. Me gjithsejt **5 lutje** për lirim me kusht përfaqësohet grupi i *veprave penale kundër sigurisë në komunikacionin publik* edhe atë *rrezikimi i sigurisë në trafik* me **2 lutje**, dhe *vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik* me **3 lutje**. Dy (**2**) **lutje** për lirim me kusht paraqiten për veprën penale *falsifikim i dokumentave* që bën pjesë në grupin e *veprave penale kundër qarkullimit juridik*. Në *veprat penale kundër rendit publik* janë paraqitur **3 lutje** për lirim me kusht për veprën e njëjtë që është *përpunimi, mbajtja dhe tregtia e palejuar e armës apo materialeve shpërthyes*. Poashtu ky vit karakterizohet edhe me paraqitjen e **1 lutjeje** për lirim me kusht për veprën penale *tregtia me njerëz* që radhitet në grupin e *veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare*.

Ky vit për nga numri i lutjeve të paraqitura për lirim me kusht radhitet *i treti* me **gjithsejt 39 lutje** të paraqitura, nga të cilat **8 lutje prej tyre ose 20,51% janë pranuar** nga gjykata, **26 lutje apo 66,67 janë refuzuar** nga gjykata dhe **5 apo 12,82% janë tërhequr** nga personat e dënuar. Nga ky numër **22 persona** që kanë paraqitur lutje për lirim me kusht pran gjykatës **janë shqipëtar apo 56,41%**, ndërsa **17 ose 43,59 %** nga gjithsejt **39 lutjet** e paraqitura **janë maqedonas**.

Lutjet e paraqitura sipas kategorisë të veprave penale në vitin 2011

Edhe në **vitin 2011** janë paraqitur lutje për lirim me kusht gati për shumicën e grupeve të veprave penale duke u nisur nga *veprat penale kundër jetës dhe trupit* ku gjithsejt janë paraqitur **6 lutje** për lirim me kusht edhe atë **2 lutje** për veprën penale *të vrasjes*, **1 lutje** për veprën penale *lëndim trupor* dhe **3 lutje** për veprën

penale *lëndimi i rëndë trupor*. Nga grupi i *veprave penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit* janë paraqitur **2 lutje** për lirim me kusht, ku **1 lutje** është paraqitur për veprën penale *të rrëmbimit* dhe **1 lutje** për veprën penale *rrezikimi i sigurisë*. Vetëm **1 lutje** për lirim me kusht është paraqitur për *veprën penale pengimi i zgjedhjeve dhe i votimit* që përfshihet në grupin e *veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimeve*. Gjatë këtij viti vepra penale *dhunimi* përfaqësohet me **3 lutje** për lirim me kusht, vepra penale *sulmi seksual ndaj të miturit që nuk ka mbushur 14 vjet* përfaqësohet me **1 lutje**, dhe vepra penale *ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit* me **3 lutje**, që të tri veprat penale që gjithsejt janë përfaqësuar me **7 lutje** janë pjesë e grupit të *veprave penale kundër moralit gjinor*. Edhe te *veprat penale kundër shëndetit të njeriut* janë paraqitur **6 lutje** për lirim me kusht për të njejtën vepër penale që është *prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve*. Si në vitet e kaluara edhe këtë vit në grupin e *veprave penale kundër pasurisë* janë paraqitur **7 lutje**, ku **2 lutje** janë paraqitur për veprën për veprën penale *vjedhje e rëndë*, **3 lutje** për veprën penale *grabitje*, si dhe **2 lutje** për veprën penale *marshtrimi*. Në grupin e *veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë* janë paraqitur **2 lutje** për lirim me kusht për të njejtën vepër penale që është *vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme*. Për këtë vit nuk mungojn edhe lutjet e paraqitura në grupin e *veprave penale kundër sigurisë në komunikacionin publik* që është kategoria me më shumë lutje për këtë vit me gjithsejt **9 lutje** për të njejtën vepër penale që është *vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik*. Vepra penale *përpunimi mbajtja dhe tregtia e palejuar e armës apo materialeve shpërthyesë* që bënë pjesë në grupin e *veprave penale kundër rendit publik* përfaqësohet me numër më të madh të lutjeve prej **8 lutje** për lirim me kusht në krahasim me vitet tjera sa i përket kësaj kategorie të veprave penale. Si në vitet tjera edhe këtë vit vepra penale

tregtia me njerëz në kuadër të *veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare* përfaqësohet me **1 lutje** për lirim me kusht.

Viti **2011** karakterizohet me **44 lutje** për lirim me kusht nga të cilat **6 lutje ose 13,64%** të lutjeve *janë pranuar* nga gjykata, **32 lutje ose 72,73%** të lutjeve *janë refuzuar* dhe **6 lutje ose 13,64%** të lutjeve *janë tërhequr*. Në bazë të përkatësisë nacionale nga **44 lutje** të paraqitura gjatë këtij viti **34 lutje ose 77,27%** të lutjeve *janë shqipëtar*, ndërsa **10 ose 22,73%** *janë maqedonas*.

Lutjet e paraqitura sipas kategorisë të veprave penale në vitin 2012

Edhe **viti 2012** nuk dallon shumë nga vitet tjera për sa i përket paraqitjes së lutjeve për lirim me kusht. Kështu që në grupin e *veprave penale kundër jetës dhe trupit* për këtë vit janë paraqitur gjithsejt **3 lutje** për lirim me kusht edhe atë **1 lutje** për *veprën penale vrasje* dhe **2 lutje** për *veprën penale lëndim i rëndë trupor*. Në grupin e *veprave penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit* është paraqitur vetëm **1 lutje** edhe atë për *veprën penale rrezikim i sigurisë*. Poashtu edhe për grupin e *veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimeve* është paraqitur vetëm **1 lutje** për lirim me kusht për *veprën penale pengimi i zgjedhjeve dhe i votimeve*. Gjatë këtij viti në grupin e *veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor* janë paraqitur gjithsejt **2 lutje** për lirim me kusht edhe atë nga **1 lutje** për *veprat penale të dhunimit dhe ndërmjetësimi në ushtrimin e prostitucionit*. Gjatë këtij viti nuk kanë munguar lutjet e paraqitura për grupin e *veprave penale kundër shëndetit të njeriut* që këtë vitë e radhitin në pedestal për lutjet e paraqitura për lirim me kusht, ku janë paraqitur **12 lutje** për të njejtën vepër penale siç është *prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave, substancave psikotrope dhe prekursorëve*. Ky vit përfaqësohet me **6 lutjet** e paraqitura për grupin e *veprave penale kundër pasurisë*, me **1 lutje** për *veprën penale të vjedhjes*, **4 lutje** për *veprën penale vjedhje të rëndë*, si dhe **1 lutje** për

veprën penale shtrëngim (detyrim shantazhi). Nga **1 lutje** për lirim me kusht është paraqitur për *veprat penale falsifikim i parave dhe fshehja e tatimit* që janë pjesë e grupit të *veprave penale kundër financave publike, qarkullimi pagesor dhe ekonomisë*. Për grupin e *veprave penale kundër sigurisë në komunikacion publik* janë paraqitur **4 lutje** për lirim me kusht edhe atë **1 lutje** për veprën penale *rrezikimi i sigurisë në trafik* dhe **3 lutje** për veprën penale *veprime të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik*. Për veprën penale *keqpërdorim i pozitës dhe i autorizimit zyrtar* që është pjesë e grupit të *veprave penale kundër detyrës zyrtare* është paraqitur **1 lutje** për lirim me kusht. **Katër (4) lutje** për lirim me kusht janë paraqitur për grupin e *veprave penale kundër rendit publik* edhe atë për veprën penale *përpunimi, mbajtja dhe tregtia e palejuar e armës apo materialeve shpërthyes*. Për këtë vit nuk ka mungur edhe paraqitja e **1 lutjeje** për lirim me kusht për veprën penale *tregtia me njerëz* nga grupi i *veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare*.

Gjatë vitit **2012** që janë paraqitur **37 lutje** për lirim me kusht, ky vit mban vendin e parë për nga numri i lutjeve të pranuar me **14 lutje ose 37,84%**, lutje të refuzuara janë **21 ose 56,76%** dhe të tërhequra nga të dënuarit është vetëm **2 lutje ose 5,41%**. Nga **37 lutjet** e paraqitura për këtë vit **33 lutje ose 89,19%** janë paraqitur nga persona me *përkatësi nacionale shqipëtare* dhe **8 lutje ose 10,81%** janë paraqitur nga personat me *përkatësi nacionale maqedonase*.

Lutjet e paraqitura sipas kategorisë të veprave penale në vitin 2013

Në vitin 2013 janë paraqitur **2 lutje** për kategorinë e *veprave penale kundër jetës dhe trupit* edhe atë **1 lutje** për veprën penale *vrasje* dhe **1 lutje** për veprën penale *lëndim i rëndë trupor*. Nga grupi i *veprave penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit* është paraqitur vetëm **1 lutje** për veprën penale *keqpërdorim i të dhënave personale*. Dy (**2**) **lutje** për lirim me kusht janë paraqitur për grupin e *veprave penale kundër zgjedhjeve dhe votimeve* pikërisht për veprën penale *pengimi i zgjedhjeve dhe i votimeve*. Të kategoria e *veprave penale kundër lirisë dhe moralit gjinor* janë paraqitur gjithsejt **4 lutje** edhe atë nga **2 lutje** për veprat penale *sulmi seksual ndaj të miturit që nuk i ka mbushur 14 vjet* dhe *ndërmjetësim në ushtrimin e prostitucionit*. Kategorinë e *veprave penale kundër shëndetit të njeriut* këtë vit e radhitin të dytin nga vitet e lartpërmendura sipas paraqitjes së lutjeve për lirim me kusht edhe atë me **8 lutje** për veprën penale *prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve*. Në grupin e *veprave penale kundër pasurisë* janë paraqitur **8 lutje** edhe atë **1 lutje** për veprën penale *vjedhje*, **6 lutje** për *vjedhje të rëndë* si dhe **1 lutje** për veprën penale *grabitje*. Vetëm **1 lutje** për lirim me kusht është paraqitur në grupin e *veprave penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë* edhe atë për veprën penale *falsifikim i parave*, por gjithashtu vetëm **1 lutje** është paraqitur për grupin e *veprave penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë* për veprën penale *vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme*. Me **5 lutje** për lirim me kusht përfaqësohet kategoria e *veprave penale kundër sigurisë në komunikacionin publik* edhe atë për veprën penale *vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik*. Nga *veprat penale kundër detyrës zyrtare* janë paraqitur **3 lutje** për lirim me kusht, **2 lutje** për veprën penale *keqpërdorim i pozitës dhe*

autorizimit zyrtar, dhe **1 lutje** për veprën penale *marrje ryshfeti*. Për veprën penale *falsifikim i dokumenteve* është paraqitur vetëm **1 lutje** për lirim me kusht që është pjesë e *veprave penale kundër qarkullimit juridik*. Në veprat *penale kundër rendit publik* janë paraqitur **3 lutje** për lirim me kusht edhe atë **1 lutje** për veprën penale *dhuna*, dhe **2 lutje** për veprën penale *përpunimi, mbajtja dhe tregtia e palejuar e armës apo materialeve shpërthyes*. Gjatë këtij viti vetëm **1 lutje** për lirim me kusht është paraqitur për veprën penale *tregtia me njerëz* në kuadër të *veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare*.

Në vitin **2013** janë paraqitur **31 lutje** për lirim me kusht nga të cilat **6 lutje ose 19,35% janë pranuar**, **24 lutje ose 77,42% janë refuzuar** dhe vetëm **1 lutje ose 3,23% është tërhequr**. Prej **31 lutje** të paraqitura këtë vit **23 lutje ose 74,19%** janë paraqitur nga persona me *përkatësi shqipëtare* dhe **8 lutje ose 25,81%** janë paraqitur nga personat me *përkatësi maqedonase*.

Gjatë periudhës kohore nga viti **2009 deri 2013** pranë Gjykatës Themelore të Gostivarit janë paraqitur gjithsejt **202 lutje** për lirim me kusht. Nga numri i përgjithshëm i *lutjeve të paraqitura janë pranuar* vetëm **45 ose 22,28%** që është një numër mjaft i vogël në karahasim me lutjet e praqitura, ndërsa **140 lutje ose 69,31% janë refuzuar** dhe **17 lutje ose 8,42% janë lutje që janë tërhequra** nga personat e dënuar. Sipas përkatësis nacionale nga gjithsejt **202 lutje** për lirim me kusht, ku **155 lutje ose 76,73%** janë paraqitura nga personat të *nacionalitetit shqipëtar*, dhe **47 lutje ose 23,27%** janë paraqitur nga persona të *nacionalitetit maqedonas*.

Kapitulli i V

1. Mbikëqyrja e personave të dënuar të liruar me kusht dhe pranimi i tyre në shoqëri pas lirimit nga dënimi me burgim.

1.1. Mbikëqyrja e personave të dënuar të liruar me kusht

Në sferën ndërkombëtare janë miratuar Konventa, Rekomandime dhe Rezoluta me të cilat parashihet lirimi me kusht. Kështu që, në vitin 1964 në Strazburg nga ana e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës është nënshkruar Konventa Evropiane për mbikëqyrje të personave të dënuar dhe personat e liruar me kusht.⁷⁵ Poashtu edhe në sferën kombëtare është parapar lirimi me kusht. Gjatë lirimit me kusht të personit të dënuar, atyre ju vendosen kushte dhe kufizime të caktuara ndaj të cilave ai duhet t'u përmbahet. Një prej atyre kushteve është vendosja e mbikëqyrjes ndaj personave të lëshuar me lirim me kusht. Personi i cili ka qenë në vuajtje të dënimit është i domosdoshëm që t'i përshtatet jetës së burgut dhe t'i respektoj kushtet që i imponohen në ambientet e burgut, dhe t'i adoptohet rendit dhe disiplinës së institucionit ndëshkues – përmirësues. Por pas lirimit me kusht ai duhet ti kthehet jetës në liri dhe tani ai vetë duhet ta organizoj jetën e tij në bazë të vetëkontrollit, dhe të ndërgjegjësohet për një jetë të ndershme. Zakonisht këtyre personave j'u caktohet mbikëqyrje e cila përbëhet nga ndihma , udhëzimet, këshilat etj., që duhet të aplikohen për një periudh të caktuar menjëher pas lëshimit. Mbikëqyrja e detyruar e ka arsyeshmërin e vetë duke u nisur nga fakti se personat e lëshuar nga enti ndëshkimor ballafaqohen me një sërë problemesh në jetën në liri në periudhën menjëher pas daljes nga enti, dhe ndjehet e nevojshme që këtyre t'u kushtohet vëmendje të veçant dhe mbështetje. Problemet mund të jenë të natyrë së

⁷⁵ Përmbledhje Konventash Rekomandime dhe Rezoluta në lidhje me çështjet penitensiare, Këshilli I Europës, Strazburg viti 2007, fq.13

ndryshme varësisht nga gjendja familjare, statusi martesor, kriza emocionale, etj. Natyra e mbikëqyrjes përcaktohet sipas intenzitetit të problemeve që e presin personin pas daljes nga enti ndëshkues, dhe prej kësaj nvarret edhe kohëzgjatja e periudhës së mbikëqyrjes.⁷⁶

Mbikëqyrjen mbi personat e liruar me kusht e regullon edhe Ligji për provën nëpërmjet Sektorit të Shërbimit të Provës i cili është kompetent në bazë të vendbanimit dhe vendqëndrimit të personit të dënuar të liruar me kusht, dhe që funksion në kuadër të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve.

Ligji për provën e regullon punën dhe procedurën e ekzekutimit të masave alternative siç është dënimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, puna me interes publik, burgu shtëpiak, lirin me kusht i shqiptuar me vendim gjyqësor, si dhe pozitën e personave në procedurën e ekzekutimit të masave alternative dhe obligimet gjatë mbikëqyrjes.⁷⁷ Vlerat në themel të Shërbimit të Provës janë rehabilitimi shoqëror i shkelësve të ligjit, respekti për dinjitetin njerëzor, është edhe mbrojtja e komunitetit dhe parandalimi i recidivizmit, konsultimi dhe asistimi për risocializim dhe riintegrimin me sukses në shoqëri të personave të dënuar duke j'u ndihmuar që nëpërmjet metodave bashkëkohore në tejkalimin e vështirësive në riintegrimin e tyre shoqëror dhe ndryshimet pozitive të sjelljes së tyre në shoqëri.

Vendimin gjyqësor për lirim me kusht gjyqi në afat prej 3 ditësh i'a dorëzon zyrës kompetente të Shërbimit të Provës në nivel lokal sipas vendbanimit apo vendqëndrimit të personit të dënuar. Gjyqi në vendim do të përcaktoj se ndaj personit të dënuar a duhet të aplikohet mbikëqyrje elektronike⁷⁸ që të garantohet zbatimi efektiv i vendimit gjyqësor nëpërmjet përcaktimit në kohë reale vendndodhjen e personit, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura

⁷⁶ Buzharovska G.L., Alternativi za zatvorot, Shkup 2003, fq.89

⁷⁷ Zakon za probacija (publikuar në Gazetën zyrtare të RM-së nr. 226 në 25.12.2015)

⁷⁸ Ibid, neni 34 p.1 dhe 3

në trupin e tij. Ky mjet elektronik duhet të ketë përmasa të vogla në mënyr që të mbulohet lehtësisht nga veshjet dhe të mos vërehet nga të tjerët.

Gjatë ekzekutimit të obligimeve të përcaktuara me vendimin për lirim me kusht Sektori i Shërbimit të Provës në nilevel lokal i kryen këto punë : ⁷⁹

- Mban kontakte të vazhdueshme me personin e dënuar ose të mbikëqyrurin dhe e thirr në bised.
- Bën kontrollimin e dokumentacionit të personit të dënuar (siç janë: vendimi gjyqësor, udhëzimet dhe mendimet e mjekëve, raportin nga Qendra për Punë Sociale etj.) si dhe mbledh edhe të dhëna tjera të nevojshme nga institucionet tjera.
- E paralajmëron personin e lëshuar me kusht për pasojat nga mosplotësimi i obligime të përcaktuara
- Bën mbikëqyrje mbi ekzekutimin e obligimeve dhe i ofron ndihmë personit të dënuar
- Harton raport për ekzekutimin e obligimeve dhe i'a paraqet gjyqit që ka miratuar vendimin në shkall të parë, si dhe kryen punë në pajtim me ligjin.

Nëse personi i dënuar nuk i plotëson ose në mënyr jo të regullt i plotëson obligimet që i janë përcaktuar, Zyra e Shërbimit të Provës në nilevel lokal menjëher e informon gjyqin kompetent. Nëse edhe pas vërejtjes me shkrim personi i dënuar nuk i plotëson obligimet e përcaktuara dhe nuk i nënshtrohet programit individual të tretmanit, Zyra kompetente e Shërbimit të Provës në afat prej 3 ditë e informon gjyqin që ka miratuar vendimin në shkall të parë dhe i propozon që ta revokoj lirim me kusht.

⁷⁹ Ibid neni 35 p.1

2. Obligimet gjatë mbikëqyrjes së personave të liruar me kusht dhe pranimit tyre në shoqëri pas lirimit nga dënimi me burg.

Për riedukimin e plotë të personave të dënuar dhe të liruar me kusht dhe për menjanimin e recidivizmit, procesi i risocializimit nuk përfundon me vuajtjen e dënimit nga ana e tij, por personave të dënuar dhe të liruar me kusht duhet përveç ndihmës për rikthim të suksesëshëm në shoqëri, në ambientin familjar, dhe në punësim pas lirimit atyre u caktohet edhe mbikëqyrje mbrojtëse. Për këtë qëllim organet kompetente (si p.sh. shërbimi social dhe personeli i specializuar si psikologu, sociologu, përfaqësuesin shoqëror të burgut) duhet të ndërmarin veprime të caktuara dhe t'i orientojn personat e liruar me kusht drejt kurseve dhe projekteve të nevojshme.

Gjyqi gjatë shqiptimit të mbikëqyrjes mbrojtëse personave të liruar mund të u caktoj edhe disa obligime vijuese :⁸⁰

- Aftësim, profesionalizim e rikualifikim që të mundet i dënuari ta mbajë vendin e punës që e zë ose të krijohet prezumime për punësim
- Pranim të punësimit që i përgjigjet aftësive dhe prirjes së të dënuarit
- Realizim i obligimeve për mirëmbajtjen e familjes, ngritje të fëmijëve dhe të obligimeve të tjera familjare
- Mosvizitimi i disa llojeve të lokaleve apo të vendeve të tjera ku toçitet pije alkoolike ose luhen lojra fati
- Ndalim të përdorimit të pijeve alkoolike, të drogave, dhe të supstancave të tjera psikotrope
- Shfrytëzimi i kohës së lirë sipas vlerësimit të organit social

⁸⁰ Shih neni 56 p.1 vepra e A.Osmani., Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë – teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Shkup 2010,

- Shmangia dhe mos shoqërimi me persona që ndikojn negativisht ndaj të dënuarit, dhe
- Nënshtrim të mjekimit dhe rehabilitimit social në institucione të specializuara përkatëse.

Gjykata vendos për këto obligime në bazë të moshës, nevojës së të dënuarit, shkallës së arsimimit, gjendjes familjare, etj.

Njohurit dhe rrethanat për mos pranimin në shoqëri të personave të dënuar dhe të liruar pas vuajtjes së dënimit apo nga vuajtja e dënimit e ka detyruar ligjdhënësin bashkëkohor që në mënyr të posaçme ta regulloj raportin e shoqërisë dhe të këtyre personave duke i inkuadruar personat e liruar nga dënimi në programe dhe tretmane të ndryshme që do t'u ndihmonin në procesin e risocializimit dhe të pranim të tyre në shoqëri. Këtu në thelbë tentohet pranimi i personave të liruar nga mbajtja e dënimit me burgim si qytetar i barabart dhe sipas gjendjes në të cilën ai gjendet të kuptohet dhe të pranohet nga shoqëria deri në atë masë që është e nevojshme që ai të mundet vetë t'i zgjedh problet e tij jetësore. Padyshim pranimi i këtill i personave të dënuar të liruar nga dënimi, nga ana e shoqërisë j'u mundëson këtyre personave t'i përjetojn dhe t'i gëzojn të drejtat e njejta si qytetarët tjerë. Ky pranim i personave të dënuar kontribon dhe parandalon kriminalitetin e tyre.

Me pranim të personave të liruar nga vuajtja e dënimit me burgim nënkuptojm një lidhje apo një raport të barabart ndërmjet këtyre personave dhe anëtarëve të tjerë të shoqërisë.⁸¹

⁸¹ Shurbanovski N., Po zatvorot kade?, Shkup 1993, fq 53

Pranimi i personave të liruar nga vuajtja e dënimit në shoqëri bëhet në disa forma :

a) Inkuadrimi në procesin e punës

Inkuadrimi i personave të liruar nga vuajtja e dënimit në procesin e punës lind si nevojë e plotësimit të nevojave të njerëzve. Mënyra e kyçjes në procesin e punës që vlen për anëtarët e tjerë duhet të vlej edhe për personat e liruar nga dënimi, të cilët insistojnë ta aplikojnë punësimin si e drejtë themelore për jetesë. Me realizimin e të drejtës për punësim personat e liruar nga dënimi me burgim më lehtë i zgjedhin problemet e tyre sociale dhe familjare. Me angazhimin permanent për punësim të personave të liruar nga vuajtja e dënimit në bazë të aftësive personale për punë menjaherë mundësi e recidivizmit. Në procesin e punës personat e liruar nga dënimi mund të kyçen edhe me ushtrimin e ndonjë veprimtarie profesionale, zanat apo ndonjë profesion tjetër si bujqësia, blektoria etje.

b) Sigurimi i ndihmës materiale shoqërore të personave që nuk janë të kyçur në procesin e punës

Kjo ndihmë u jepet personave të liruar nga dënimi që nuk janë të aftë për punë p.sh. janë të sëmur ose pleq, por u jepet edhe personave që janë të aftë për të punuar por pas lirimit nga vuajtja e dënimit shoqëria nuk është në gjendje që ta kyç në procesin e punës. Kjo ndihmë u jepet të gjithë personave të liruar nga vuajtja e dënimit për plotësimin e nevojave më elementare të tij deri kur ai të angazhohet në punë dhe të përshtatet në shoqëri.

c) Ndihma shoqërore për vazhdimin e procesit të riedukimit të personave të dënuar te të cilët nuk ka përfunduar ky proces

Shoqëria duhet t'u mundësoj kushte personave të liruar nga dënimi që të mund të vazhdojn procesin e risocializimit edhe në liri duke u siguruar edhe ndihmë morale dhe materiale sipas nevojës. Detyra themelore e ekzekutimit të dënimit me burgim është që personi i dënuar të arrij edukimin dhe risocializimin deri në atë masë sa që të arrihet qëllimi i dënimit me burgim. Pas lirimit nga dënimi personi i dënuar të kthehet në shoqëri si person i edukuar, të jetojë dhe të veproj në pajtim me regullat pozitive ligjore, me pak fjalë të bëhet anëtar i dobishëm i shoqërisë dhe të mos kryej vepra penale në të ardhmen. Kjo formë e pranimit të personave të liruar nga dënimi paraqet një ndikim shoqëror për riedukim kur personi i dënuar gjatë kohës së vuajtjes së dënimit në entin ndëshkues nuk e ka arritur nivelin e duhur për riedukim.

d) Krijimi i një atmosfere besimi ndaj personave të liruar nga dënimi

Padyshim përveç formave të tjera të pranimit të personit të liruar nga dënimi në shoqëri edhe kjo formë paraqet një shprehje të besimit ndaj këtyre personave. Kjo formë është e nevojshme për adaptimin dhe pranimin e plotë të tyre në shoqëri sepse ndaj tyre dhe rreth tyre krijohet një atmosferë që tregon se është arritur pranimi i plotë i tyre në shoqëri. Rrethi i tij i mëhershëm si p.sh. familja, farefisi, shokët, bashkëpunëtorët në punë etj., në jetën e përditshme dhe në punë nuk duhet ta cilësojn si kriminel dhe nuk duhet të largohen prej tij, duke shprehur qortim moral ndaj tij për veprën penale të kryer dhe dyshimin se mund të kryej përsëri vepra penale. Me fjalë të tjera krijimi i atmosferës së tillë shoqërore dhe miqësore në përditshmërin jetësore dhe organizatat e ndryshme të punës i mundësojn më lehtë personit të liruar nga dënimi inkuadrim dhe përshtatje në shoqëri apo në mjedisin ku ka jetuar.

3. Roli i lirimimit me kusht në procesin e risocializimit të personave të dënuar

Lirimi me kusht është një masë bashkëkohore penologjike me rëndësi të madhe edhe në lëmin e të drejtës penale dhe të politikës kriminale, sepse me anë të këtij instituti personat e dënuar motivohen që më shpejtë përmirësohen dhe të aftësohen për jetë normale në liri. Përkatësisht bërja me dije personave të dënuar, se nëse përmirësohen do mund të lirohen nga vuajtja e dënimit me burg, edhe para se ta kryejnë në tërësi dënimin shërben si nxitje dhe stimulim i madh që të dënuarit të jenë më aktiv në trajtimin e risocializimit të tyre, jo vetëm në entin ndëshkues por edhe jashtë tij, në liri.⁸² Siç kemi cekur më herët instituti i lirimimit me kusht në rend të parë i mbron lirit dhe të drejtat e njeriut, gjë që parashihet edhe me akte ndërkombëtare si p.sh., Rekomandimi (2003) 22 të Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës, në lidhje me lirimin me kusht. Rekomandimi poashtu potencon se lirimi me kusht është një mekanizëm që në mënyrë efektive parandalon recidivizmin duke i mundur personave të burgosur integrim të planifikuar, të arsimuar dhe të mbikëqyrur në shoqëri.

Por efikasiteti i këtij instituti varet shumë nga përshtatja me kushtet individuale të personit të dënuar dhe në përputhje me parimet e një procesi të rregullt dhe të drejtë ligjor. Duke pasur parasysh se personi i dënuar i cili është në vuajtje të dënimit, ai për tu liruar me kusht duhet të plotësojë kushtin e tij që të jetë i vetëdijshëm për veprimet e tij të mëhershme dhe gjatë vuajtjes së dënimit të përmirësohet në sjelljet dhe veprimet e tij gjatë vuajtjes së dënimit ashtu edhe pas

⁸² Salihu I., E drejta penale, pjesa e përgjithëshme, Prishtinë 2005, fq 543

lirimit të tij me kusht, duhet të ndryshoj sjelljen e tij dhe ti përshtatet kushteve dhe ambientit në të cilin jeton d.m.th., duhet të riintegrohet në shoqëri.⁸³

Termi risocializim dhe riintegrim konsiston në kthimin e personit të dënuar në ambientet shoqërore, si dhe aftësimi i tij që të jetoj në harmoni me dispozitat shoqërore dhe me vetëkontribut të siguroj egzistencën e tij dhe familjes së tij si dhe të kryej punë të nderëshme.

Ai tani pas arritjes së riintegrimit dhe riedukimit nuk do të përsëris krime dhe sjellje tjera delikvente por me bindje të plotë vërtetohet se në të ardhmen do të sillet në pajtim me ligjin. Kjo sjellje e tij, tani nuk vjen nga frika dhe kërcënimi nga ndëshkimi por nga bindja dhe vet zgjedhja e tij, se kjo mënyr është më e mira dhe në interes të jetës dhe mirëqenies së tij. Risocializimi i personit të dënuar që bëhet gjatë kohës së mbajtjes së dënimit, është edhe njëri ndër kushtet që duhet të plotësoj i dënuari për të bërë kërkesën për tu liruar.⁸⁴

Pas lirimit me kusht institucioni që merret me risocializimin dhe riintegrimin e personave të liruar me kusht është Sektori i Shërbimit të Provës,⁸⁵ i cili funksionon në kuadër të Drejtorisë mbi ekzekutimin e sanksioneve të Maqedonisë. Ky Sektor mirret me mbikëqyrjen, risocializimin, rehabilitimin integrimin e personave të dënuar që kanë kryer vepra që sipas ligjeve pozitive të Maqedonisë janë parashikur si vepra të kundërligjshme. Sektori i Provës ka një rol të rëndësishëm pasi që personave të liruar me kusht ju ofron mbikëqyrje dhe ndihmë që pa vështirësi të kyçen në jetë në liri. Personat e liruar me kusht gjatë qëndrimit në entet ndëshkuese ndodh që ti humbin kontaktet me botën e jashtme në liri, mund

⁸³ Rekomandimi (2003) 22, komitetit i Ministrave i shteteve Anëtare të OKB-së në lidhje me lirimin me kusht Tiranë 2010 , fq 79. (<https://www.osce.org/sq/albania/72037?download=true>)

⁸⁴ Halili R., Penologjia, Prishtinë, 2010 fq 146

⁸⁵ Zakon za probacija (publikuar në Gazetën zyrtare të RM-së nr. 226 në 25.12.2015)

të ndërpresin mardhëniet familjare, lidhjet farefisnore etj., dhe mund të mos ketë kush të kujdeset për punësimin shërimin eventual të tyre.

Gjithashtu lirimi me kusht ka rëndësi të madhe edhe në zbrazjen e burgjeve dhe me këtë kursehet buxheti i shtetit, sepse shpenzimet në këtë drejtim janë të mëdhaja. Fenomeni i mbipopullimit të burgjeve është një problem jo vetëm në Maqedoni por edhe në shtetet tjera në mbarë botën. Mbiipopullimi është një çështje që shkakton shumë probleme administrative dhe shpesh herë ka ndikuar negativisht në sjelljen, shëndetin dhe moralin e të burgosurve.

Në Maqedoni përveç lirimimit me kusht janë përdorur edhe instituti i amnistisë dhe i faljes për lirimimin e personave të dënuar nga burgu me qëllim që të ulët mbiipopullimi nëpër burgje. Instituti i amnistisë dhe i faljes janë masa efektive vetëm për një periudhë të shkurtër kohore, pasi që edhe praktika ka treguar se personat e liruar nga falja dhe amnistia përsëri janë kthyer në burgje për shkak se në këto institute nuk është aplikuar mbikëqyrja dhe ndihma sociale e ofruar nga organet kompetente pas lirimimit nga dënimi. Përkrahja pas lirimimit është thelbësore për gjetjen e strehimit, punës, përshtatjes në jetën pas burgut dhe rivendosjen e lidhjeve familjare.

Përfundimi dhe Rekomandime

Dënimi me burgim apo (heqje lirie) mundëson dhe ndikon në uljen e kriminalitetit dhe në kryerjen e veprave penale. Të dhënat nga praktika gjyqësore tregojnë se dënimi me burgim është masa që aplikohet më së shpeshti si në të drejtën penale tek ne ashtu edhe në mbar botën për tu arritur qëllimi i dënimit. Nga ajo që e kemi shtjelluar në këtë punim kuptuam se instituti i lirit me kusht është i lidhur me shumë institute, gjithashtu ngusht është i lidhur me dënimin me burgim, kështu që lirimi me kusht nuk mund të egzistoj si institut i vetëm. Nuk do isha i mendimit se mund të aplikohet ndonjë masë tjetër e ngjashme me dënimin me burgim për ta arritur qëllimin e dënimit.

Në këtë punim kërkimor të masterit jam përpjekur që në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale ta trajtoj lirin me kusht si temë kryesore të këtij punimi. Duke u nisur që nga paraqitjet e para të institutit të lirit me kusht e deri më sot, nga e cila kuptojmë se edhe në sistemin tonë të drejtësisë lirit me kusht duhet ti kushtohet një vëmendje dhe rëndësi të veçantë si në teori ashtu edhe në praktik.

Sipas mendimit tim këtij institut duhet ti qasen me një seriozitet të madh edhe ligjdhënësi gjatë përpilimit të akteve ligjore, por edhe gjykata gjatë miratimit të vendimit për lirim me kusht apo aplikimit të tij në praktik. Rëndësia që e paraqet lirim me kusht në sistemin tonë të drejtësisë por edhe në sistemet e vendeve të tjera nuk është vetëm juridike por është edhe ekonomike, sepse me aplikimin në mënyrë adekuate dhe të drejtë të tretmaneve ndaj personave të burgosur dhe aplikimin e drejtë të këtij instituti në bazë të kushteve dhe kapaciteteve ekonomike dhe juridike të institucioneve penitensiare zvogëlohet mbipopullimi i panevojshëm nëpër institucionet penitensiare. Gjithashtu edhe vëmendja e opinionit të gjërë

duhet orientuar drejt këtij instituti, sepse personat që janë dënuar me dënimin me burgim dhe qëndrojnë në institucionet penitensiare nëpërmjet këtij instituti motivohen që sa më shpejt të përmirësohen dhe të aftësohen për jetë normale në liri.

Të gjitha shtetet bashkëkohore me zhvillim të lartë tentojnë që me zbatimin e institutit të lirimit me kusht në praktik në mënyrë humane të respektojnë liritë dhe të drejtat e personave të burgosur dhe gjithashtu ky institut u mundëson që personave të dënuar ta gëzojnë të drejtën themelore dhe vitale siç është e drejta të jesh i lirë.

Lirimi me kusht gjatë periudhës konkrete në këtë punim është treguar i suksesshëm në risocializimin e personave të dënuar edhe përkundër faktit se gjykata në territorin tonë me një përqindje shumë të vogël e ka trajtuar këtë institut gjatë miratimit të vendimeve për dhënien e lirimit me kusht. Në shumicën e rasteve personat e liruar me kusht i kanë përmbushur kushtet e parapara formale (objektive) dhe materiale (subjektive) dhe e kanë shfrytëzuar me mirëbesim këtë mundësi që i'u është dhënë që ata të kthehen më herët jetës në liri.

Lirimi me kusht paraqet një modifikim të dënimit me burg, por përkundër këtij modifikimi personi i liruar me kusht gjendet në mbajtje të dënimit por nën kushte në liri. Gjithashtu gjykata gjatë miratimit të vendimit të lirimit me kusht duhet të jetë sa më objektive, e paanëshme, transparente gjatë punës së saj, në mënyrë që të evitohen keqpërdorimet e mundëshme dhe vendimet jomeritore, sepse është në pyetje liria dhe e drejta themelore e njeriut. Rol të rëndësishëm për aplikim të suksesshëm të institutit të lirimit me kusht tek ne luan edhe Sektori i Shërbimit të Provës që ka një bashkëpunim pothuajse të mjaftueshëm me Gjyqin kompetent, me Qendrën për punë sociale, me Entin për punësim dhe me të dënuarin. Sektori i Shërbimit të Provës duhet të ketë buxhet financiar të konsiderueshëm që për çdo rast të kyçen edhe specialist të fushave përkatëse dhe

organizata joqeveritare, duke marrë masa të rëndësishme institucionale dhe operacionale për të mbështetur riintegrimin e personave të dënuarve në shoqëri për të ulur normat e recidivizmit kështu që mbikëqyrja të jetë sa më cilësore dhe ky bashkëpunim në të ardhmen të kryhet në mënyr permanente më i kordinuar dhe sa më cilësor për risocializim dhe inkuadrim më të lehtë të personave të dënuar në jetën në liri dhe në shoqëri.

Gjithashtu, perspektivat pesimiste në lidhje me punësimin dhe të ardhurat e ulëta të personave të liruar me kusht mund të rrisin më tej nivelin e stresit tek këta persona, dhe të bëhen një shtytës i fuqishëm drejt ripërfshirjes në krim. Për këtë arsye rekomandohet krijimi i një mjedisi miqësor bashkëpunimi me agjenci dhe organizata lokale për të lehtësuar punësimin e personave të dënuar, dhe nëse është e mundur, të ofrohen edhe stimule financiare për ata punëdhënës që punësojnë një ish të dënuar.

Sipas mendimit tim ky institut në kohën e fundit paraqitet me një vëmendje dhe rëndësi të madhe në teorinë dhe praktikën e sistemit penal të Maqedonisë. Për shkak të rëndësisë së madhe që e paraqet ky institut, nevojës së aplikimit të tij, rolit të tij gjatë vuajtjes së dënimit me burgim, dhe aq më tepër rëndësinë që ka në risocializimin dhe riedukimin e të dënuarit, ligjdhënësi ynë këtë institut duhet ta trajtoj *në një kapitull të veçant dhe në mënyrë precize*. Është në interes të institucioneve ndëshkuese, të të dënuarve dhe mbarë shoqërisë që lirimi me kusht të vazhdoj punën edhe në të ardhmen gjithnjë duke u mbështetur në ligj, akte nënligjore, në urdhëresa dhe rekomandime administrative që e rregullojnë punën e tij.

Literatura e shfrytëzuar

Salihu Ismet, E Drejta penale, Pjesa e përgjithëshme, Prishtinë 2005

Salihu Ismet, E Drejta penale, Pjesa e posaçme, Prishtinë 2006

Gashi Rexhep, Lirimi me kusht i personave të dënuar në legjislacionin dhe praktikën Kosovare, E drejta, Revist për çështje juridike dhe shoqërore ,Prishtinë 2004.

Gashi Rexhep, Ekzekutimi i dënimit me burg në Shqipëri, Prishtinë 2001

Gashi Rexhep, Ekzekutimi i dënimeve alternative, Prishtinë 2013

Latifi Vesel, Kriminalistika, Prishtinë 2011

Halili Ragip, Penologjia, Shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë 2010

Halili Ragip, Kriminologjia, Prishtinë 2011

Ukaj Bajram, Dënimet në të drejtën penale të Shqipëris, Prishtinë 2006

Luarasi Aleks, Të drejtat e të burgosurve, Tiranë 2000

OSCE, Manual për aplikimin e alternativave të dënimit me burgim, Tiranë 2010

Kambovki Vllado, E Drejta Penale- pjesa e përgjithëshme, Shkup 2007

Arnaudovski Lupço., Drakulevski G Aleksandra, Penologjia- nauka za izvrshvanje na sankciite so izvrshno kazнено pravo na RM, (prv del), Shkup 2013

Arnaudovski Lupço., Drakulevski G Aleksandra, Penologjia- nauka za izvrshvanje na sankciite so izvrshno kazнено pravo na RM, (vtor del), Shkup 2013

Krlev Todor, Zatvor, studentski zbor, Shkup 2001

Buzharovska Lazhetiq Gordana, Alternativi za Zatvorot, Shkup 2003

Marjanoviq Gjorgji, Kanevçev Metodi, Makedonsko krivično parvo, opst del, Skopje 2010

Miladin.Krstanovski.,Uslovniot otpust kako penoloski institut (stdentski zbor), Shkup 1996

Ligji për ekzekutiminn e sanksioneve (Gazeta zyrtare e RM-së nr.2/2006,57/2010,170/2013)

Kodi Penal i RM-së (Gazeta zyrtare e RM-së nr.37/1996, 80/1999, 4/2002, 114/2009, 51/2011, 142/2012, 82/2013,)

Sulejmanov Zoran, Penologija, Shkup 2005

Beqiri Mitasin,Organizimi dhe gjendja e institucioneve penitensiare në Republikën e Maqedonisë, Tetovë 2007

Pravilnik za utvrduvanje na kriteriumite za predvremeno otpustanje na osudenoto lice pred istek na kaznata (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.123/2007)

Arnaudovski Lupço,Drakulevski G Aleksandra,Zakon za izvrsuvanje na sankciite, (integralen tekst so predgovor, kratki objasnuvanja i registar na poimite), Shkup 2011

Upatsvtvo za vidovite i nacinite na tretman na osudenite lica, (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.123/2007)

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë

Sulejmanov Zoran, Penitenciarnite ustanovi vo Makedonija, Shkup 2003

Sulejmanov Zoran, Klasifikacija na osudenite lica, Mgisterski trud, Shkup 1982

Sulejmanov Zoran, Krivicno parvo- opst del, Shkup 2005

Ligji për amnesti (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.6/99,18/02)

Ligji për falje, (Gazeta zyrtare e RM-së nr.20/1993, 39/1993, 136/06, 98/2008, 12/2009, 170/2010, 103/2011, 182/2012, 85/2012, 90/2012, 95/2012)

Pravilnik za utvrduvanje na kriteriumite za predvremeno otpustanje na osudenoto lice pred istek na kaznata (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.123/2007)

Osmani Afrim, Kodi Penal I Republikës së Maqedonisë – teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Shkup 2010

Arnaudovski Lupço, Çaçeva Violeta, Zatvoreničko opshtestvo, Shkup 2000

Osmani Afrim, Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, Shkup 2013

Shurbanovski Naum, Po zatvorot kade?, Shkup 1993

Penoloshki Temi, Spisanie za penologija i izvrshuvanje na sankciite, Shkup 1997

Morris T, Morris P, Pentoville, A sociological study of an English Prison, Roytlendge and Regan Paul, London 1963

Kambovski Vllado, Nauçen i praktiçen komentar na kriviçniot zakonik na RM (integralen tekst – vtoro Izmeneto izdanie), Shkup 2011

Rekomandimi (2003) 22 për lirimin me kusht

Përmbledhje Rekomandimesh, Konventash, dhe Rezoluta në lidhje me çështjet Penitensiare, Strazburg 2007

Standart minimum rules for the treatment of prisoners OOH 1997

Elezi Ismet, Kapuçi Skënder, Haxhi Maksim, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipëris, Pjesa e përgjithshme (aranzhuar e plotësuar me shtesat e ndryshimet e bëra në reformat ligjore të viteve 2001, 2003, 2004, 2007, 2008, 2012, 2013, 2014, si me praktikën gjyqësore), Tiranë 2014

Salihu Ismet, Zhitija Hilmi, Hasani Fejzullah, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Prishtinë 2014

Raporti vjetor të Drejtoris mbi ekzekutimin e sanksioneve për punën dhe gjendjen e në entet ndëshkuese-përmirësuese dhe entet edukuese-përmirësuese në R.Maqedonisë për vitin 2009 2010 2011 2012 2013, Shkup 2010,2011,2012,2013,2014.

Zakon za probacija (publikuar në Gazetën zyrtare të RM-së nr. 226 në 25.12.2015)

Raporti i punës së Gjyqit Themelor të Gostivarit për vitin 2009-2013